FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 3

Tiranë – E premte, 8 janar 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 145/2020, datë 3.12.2020	Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe.....	339
Ligj nr. 155/2020, datë 17.12.2020	Për ndryshimet klimatike.....	343
Dekret i Presidentit nr. 11893, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	362
Ligj nr. 156/2020, datë 17.12.2020	Për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar në kriteret e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.11.2016.....	362
Dekret i Presidentit nr. 11894, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	363
Ligj nr. 157/2020, datë 17.12.2020	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent për huamarrësin, dhe Bashkimit Evropian, si huadhënës, për ndihmën makrofinanciare për Shqipërinë.....	363
Dekret i Presidentit nr. 11895, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	376
Ligj nr. 161/2020, datë 23.12.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 33, datë 11.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, 'Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar.....	377

Dekret i Presidentit nr. 11899, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	377
Ligj nr. 164/2020, datë 23.12.2020	Për disa ndryshime në ligjin nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", të ndryshuar.....	377
Dekret i Presidentit nr. 11900, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	378
Ligj nr. 165/2020, datë 23.12.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar.....	378
Dekret i Presidentit nr. 11901, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	379
Ligj nr. 167/2020, datë 23.12.2020	Për faljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, që ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfituar, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar.....	379
Dekret i Presidentit nr. 11902, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	380
Ligj nr. 169/2020, datë 23.12.2020	Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore.....	380
Dekret i Presidentit nr. 11903, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	381
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1103, datë 24.12.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Muzeu Hebraik Shqiptar në Vlorë".....	381
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1119, datë 29.12.2020	Për lirim nga detyra.....	384
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1124, datë 30.12.2020	Për monitorimin shkencor pasvaksinal të kafshëve të vaksinuara, në kuadër të projektit IPA 2017, "Kontrolli dhe çrrënjosja e sëmundjes së tërbimit – faza III"	384
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1127, datë 30.12.2020	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2020.....	387

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1131, datë 24.12.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore"	387
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1142, datë 24.12.2020	Për përcaktimin e kritereve bazë, të masës së përfitimit dhe mënyrës së përdorimit të fondit për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë, për vitin 2021.....	388
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1146, datë 24.12.2020	Për dhënien e miratimit për fillimin e procedurave të privatizimit për pasurinë nr. 109, me emërtim "Sh.a. Riparim artilerie", e përbërë nga disa sipërfaqe, truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43 169 m^2, dhënë me kontratë me çmimin 1 euro/kontrata fondacionit "Fundjavë ndryshe"	391
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 210, datë 15.12.2020	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Energija DOO Veternik" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	391
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 211, datë 15.12.2020	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Energija DOO Veternik" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	393
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 212, datë 15.12.2020	Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018.....	394
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 213, datë 15.12.2020	Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 199, datë 12.12.2019.....	395
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 214, datë 15.12.2020	Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 200, datë 12.12.2019.....	397
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 215, datë 15.12.2020	Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a.", për vitin 2021.....	398
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 216, datë 15.12.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, "Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, të shoqërisë OST sh.a."	399
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 217, datë 15.12.2020	Mbi rishikimin e "Planit të masave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike 'OSHEE' sh.a., për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 3.9.2018.....	401
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 218, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit.....	407

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 220, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 93, seria PV10K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010, të ndryshuar.....	409
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 221, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 265, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 11.2.2015.....	411
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 222, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 130, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011, të ndryshuar.....	413
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 223, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 267, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 19, datë 11.2.2015.....	415
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 224, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 348, seria T16, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Nordic Invest Group" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 21.7.2016.....	417
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 225, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "HEC Treska" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 27.4.2013.....	419
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 226, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 209, seria T13, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Shutina Energji" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 1.10.2013.....	421
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 227, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 405, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia Solar 1" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 30.4.2018.....	423
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 228, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 406, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia Solar 2" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 30.4.2018.....	425
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 229, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Malsia Solar 3" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 107, datë 30.4.2018.....	427

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 230, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Blac Energy" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018.....	429
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 231, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 398, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 12.3.2018.....	431
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 232, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 413, seria F18, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 4.6.2018.....	432
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 233, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 359, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "ENPI" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 6.3.2017.....	434
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 234, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Energy to Energy" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.9.2017.....	436
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 235, datë 15.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë "CGC" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017.....	438
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Muharem Rucaj.....	440

LIGJ
Nr. 145/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.12.2020.

MARRËVESHJE
MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë (në vijim e referuar si "QSH") dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe (në vijim të referuara si "EBA") (bashkërisht të referuara si 'Palët'),

me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet midis dy kombeve, në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe normat e përcaktuara nga e drejta ndërkombëtare dhe marrëveshjet e mëparshme dypalëshe ndërmjet dy vendeve, për të forcuar marrëdhëniet e respektueshme dypalëshe midis dy popujve, për të nxitur sipërmarrjen dhe bashkëpunimin në fushat me interes të përbashkët dhe bashkëpunimin sipas kësaj Marrëveshjeje (në vijim i referuar si "Bashkëpunim");

bazuar në besimin e përbashkët të të dyja qeverive në parimet e bashkëjetesës paqësore midis popujve të botës dhe në nevojën e bashkëpunimit të përbashkët midis vendeve për të arritur paqen dhe sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin ndërkombëtar;

në bazë të aspiratës së sinqertë për ta bërë këtë Marrëveshje një kuadër ligjor për avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe, që mbulojnë fusha bashkëpunimi të përcaktuara bashkërisht, siç specifikohet, duke përfshirë Marrëveshjen për Nxitjen dhe Mbrojtjen e Investimeve, të nënshkruar në Tiranë, në datën 15.10.2015, dhe veçanërisht për të promovuar interesat dhe mirëqenien e popujve të tyre, Palët,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët do të inkurajojnë dhe nxisin bashkëpunimin midis dy vendeve, në bazë të parimeve të miqësisë, respektimit të plotë të sovranitetit të të dyja vendeve dhe interesave të përbashkët në përputhje me legjislacionet përkatëse kombëtare, ligjet dhe statutet ndërkombëtare dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Palët do të inkurajojnë veçanërisht bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar dhe partneritetet strategjike, në sektorë të veçantë dhe fusha me interes, në bazë të barazisë dhe përfitimeve të ndërsjella, në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuar në këtë Marrëveshje dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në marrëveshje të veçanta, memorandume mirëkuptimi dhe protokolle të lidhura për zbatimin e projekteve dhe të programeve konkrete të parashikuara në fushat e bashkëpunimit ndërmjet Palëve dhe/ose ndërmjet njërës prej Palëve dhe sektorit privat, ose midis sektorit privat të të dyja Palëve, dhe/ose organeve ose autoriteteve kompetente të Palëve që zbatojnë një projekt ose program konkret.

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin midis autoriteteve, subjekteve tregtare dhe subjekteve të

tjera publike ose private të të dyja vendeve, si dhe përfshirjen e qytetarëve, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve.

Neni 2

Palët do të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme ekonomike:

1. Bashkëpunim në fushën industriale:

Kryerja e konsultimeve të nevojshme midis të dyja Palëve që do të përfitojnë nga ekspertiza dhe përvoja e tyre përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat e mëposhtme:

a) krijimi i fushave të specializuara teknike dhe ekonomike të lidhura me eksportet;

b) krijimi i sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme industriale dhe bashkëpunim midis ndërmarrjeve nga të dyja Palët;

c) kalimi në ekonominë e njohurive;

d) gjetja e mënyrave dhe mekanizmave ndërmjet autoriteteve kompetente të të dyja vendeve, për të krijuar industri të përbashkëta arabe-shqiptare, që kombinojnë njohuritë e avancuara industriale të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe avantazhe të ngjashme të disponueshme në ekonominë shqiptare

2. Bashkëpunim në tregti dhe fushat tregtare:

a) zhvillimi dhe rishikimi i masave të nevojshme për rritjen e tregtisë midis dy vendeve dhe përmirësimi i ndërsjellë i aksesit në treg;

b) shkëmbimi i ekspertizës dhe i përvojës në fushën e rieksportit dhe i projekteve, dhe i investimeve të orientuara nga eksporti;

c) shkëmbimi i informacionit ekonomik dhe tregtar, legjislacioni ekonomik dhe drejtoritë tregtare për të promovuar dhe për të zhvilluar bashkëpunimin ekonomik dhe për të avancuar shkëmbimin tregtar midis dy vendeve;

d) bashkëpunim në ndarjen dhe shkëmbimin e ekspertizës midis sektorëve privatë të të dyja Palëve.

3. Bashkëpunim në fushën e investimeve:

a) shkëmbimi i informacionit mbi sistemet e ndryshme të investimeve dhe stimujt e tij përkatës stimulues;

b) puna për shkëmbimin e lehtësive administrative, ligjore dhe financiare dhe të të gjitha procedurave të nevojshme për bashkëpunim në fushën e krijimit të sipërmarrjeve të përbashkëta të investimeve në të dyja vendet, sipërmarrjeve të përbashkëta të investimeve në vendet e palëve të treta dhe sipërmarrjeve private të investimeve për secilën Palë për Palën tjetër;

c) puna për nënshkrimin e marrëveshjeve ekonomike dhe marrëveshjeve të tjera mbi nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, duke lehtësuar bashkëpunimin e biznesit dhe/ose ndonjë marrëveshje të mëtejshme që do të bihet dakord midis dy Palëve, që do të ndikojë pozitivisht në investime dhe klimën e biznesit.

4. Bashkëpunim në fushën e turizmit, në logjistikë dhe në infrastrukturën e ngjashme:

1. Ky bashkëpunim do të përfshijë fushat e mëposhtme:

a) shkëmbimi i përvojës dhe i njohurive në fushën e turizmit dhe të industrive, dhe të shërbimeve përkatëse, nga grupet e interesit të sektorit publik dhe privat;

b) bashkëpunimi për projekte specifike të zhvillimit strategjik në turizëm dhe industri të ngjashme;

c) forcimi i bashkëpunimit në fushat e transportit detar, duke përfshirë turizmin detar, shërbimet dhe mirëmbajtjen e anijeve dhe shërbimet e ngjashme;

d) përfitimi nga mundësitë dhe përvojat në fushën e kuadrit rregullator të transportit detar.

5. Bashkëpunim në fushën e pronave/ aseteve / objekteve të paluajtshme:

1. Ky bashkëpunim përfshin fushat e mëposhtme:

a) blerjen e aseteve të paluajtshme në pronësi shtetërore, në përputhje me kornizën ligjore përkatëse të vendeve përkatëse; dhe/ose

b) investime të përbashkëta në projekte që përfshijnë zhvillimin e pronave në pronësi shtetërore.

2. Për të zbatuar aktivitetet në këtë fushë bashkëpunimi, Palët bien dakord që, kur është e nevojshme, të sigurohen investime në disa objekte dhe asete të paluajtshme (të lidhura me fushat e këtij bashkëpunimi) në pronësinë shtetërore, në Republikën e Shqipërisë, kur njihet interesi i ndërsjellë, Qeveria e Shqipërisë do të angazhohet me subjektet e Emirateve të Bashkuara Arabe, për të zhvilluar ose për të investuar me ta bashkërisht, të gjitha nën termat dhe kushtet e rënë dakord nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose secila Palë dhe sektori privat, ose sektori privat i të dyja Palëve, që

do të rregullohen individualisht me marrëveshje të veçanta të nevojshme.

6. Bashkëpunim në fushën e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore:

1. Ky bashkëpunim përfshin fushat e mëposhtme:

a) shkëmbimi i informacionit dhe i njohurive në kulturat dhe proceset bujqësore;

b) investimet në zhvillimin dhe në zgjerimin e prodhimit bujqësor;

c) investim në sistemet e ujitjes dhe të drenazhimit, duke përfshirë blerjen dhe modernizimin e pajisjeve dhe të infrastrukturës bujqësore;

d) krijimi i qendrave të përbashkëta të eksperimentimit dhe të kërkimit në bujqësi, pylltari dhe mbrojtjen e mjedisit;

e) bashkëpunimi për projektet bujqësore dhe programet e sigurisë ushqimore.

2. Me qëllim garantimin e zbatimit të kësaj pjese të Marrëveshjes, Qeveria e Shqipërisë është e hapur për të bashkëpunuar në prezantimin ndaj shoqërive tregtare drejtuese bujqësore nga Emiratet e Bashkuara Arabe, asetet në ndërmarrjet shtetërore, qiradhëniet afatgjata të tokës bujqësore për bashkëpunim tregtar, të gjitha nën termat dhe kushtet e rëna dakord nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose secila Palë dhe sektori privat, ose sektorët përkatës privatë të të dyja Palëve, që do të rregullohen nga marrëveshje/kontrata të veçanta që mund të jenë të nevojshme dhe të zbatueshme në përputhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të ndalojë Palët që të bashkëpunojnë në fusha të tjera, të cilat nuk janë të mbuluara me këtë Marrëveshje.

Neni 4

Palët do të punojnë për aktivizimin e kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet lidhjes së Marrëveshjes/eve, Memorandumeve të Mirëkuptimit dhe Protokolleve përkatëse midis sektorit qeveritar dhe privat të të dyja Palëve dhe intensifikimit të vizitave zyrtare midis zyrtarëve ose delegacioneve përkatëse.

Neni 5

Të gjitha masat e investimeve dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë, që janë përfshirë në fushat e bashkëpunimit, në përputhje me nenin 2 dhe nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen dhe do të bien dakord nën termat dhe kushtet e rënë dakord nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose secila Palë dhe sektori privat, ose sektori privat i të dyja Palëve, të gjitha të rregulluara nga marrëveshje/kontrata të veçanta (shitblerja, qiraja afatgjatë, koncesionet BOT "ndërto-vepro-transfero", shitja e kapitalit dhe/ose aseteve në shoqëritë tregtare ekzistuese, bashkëpunimi tregtar etj.).

Neni 6

Pas diskutimit bashkërisht mbi prioritetet e zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies së qytetarëve të tyre, të dyja Palët kanë rënë dakord për një listë të projekteve specifike, që konsiderohen të një natyre strategjike në përmbushjen e objektivave të kësaj marrëveshjeje dhe marrëveshjeve të mëparshme ekonomike, dhe të bashkëpunimit midis dy Palëve, siç identifikohet bashkërisht, është si më poshtë:

1. Rizhvillimi i Portit të Durrësit;

2. Mundësitë e investimeve në industrinë e turizmit, bujqësisë dhe logjistikës në Vlorë, Sarandë dhe Ksamil;

3. Investimet në fushën e turizmit në zonën e Përmetit.

Bazuar në këtë listë të hartuar bashkërisht të projekteve me rëndësi strategjike për zhvillimin ekonomik të të dyja Palëve, dhe në zbatim të realizueshmërisë dhe të zbatimit të projekteve, Palët do të propozojnë subjekte specifike nga sfera publike dhe private, që do të bashkëpunojnë për të garantuar zbatimin e suksesshëm të projekteve të renditura më sipër, disa ose të gjitha, siç janë rënë dakord nga Palët

Për qëllimet e përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje, në përputhje të plotë me nenin 8 të Marrëveshjes për Nxitjen dhe Mbrojtjen e Investimeve, të nënshkruar midis Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, në datën 15 tetor 2015, kontratat, programet dhe projektet strategjike të rëna dakord, në përputhje me këtë Marrëveshje, nuk do të jenë në asnjë prej Palëve që u

nënshtrohen prokurimit publik, tenderit publik, procedurës konkurruese publike ose ndonjë procedure tjetër të përcaktuar në legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë ose të Emirateve të Bashkuara Arabe pas ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje. Procedurat specifike do të bien dakord nga palët, duke përfshirë dhe duke mos u kufizuar në zbatimin e instrumenteve ligjore të rëndësishme për investimet strategjike të aplikuara në të dyja ose secilën nga palët, nëse gjykohet e nevojshme.

Neni 7

Në lidhje me Marrëveshjen ndërmjet Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me taksat mbi të ardhurat, e cila u nënshkrua në datën 13 mars 2014, do të zbatohet edhe për subjektet qeveritare të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe filialet e tyre.

Neni 8

1. Palët do të krijojnë një komitet të përbashkët ose nënkomitete për të punuar mbi temat e mbuluara nga kjo Marrëveshje ose ndonjë temë tjetër për të cilën do të bihet dakord midis Palëve.

2. Kryesuesit e komitetit/ve referuar në nenin 8 (1) do të hartohen në kohën e duhur përmes kanaleve zyrtare të identifikuara nga Palët.

3. Komiteti do të rekomandojë për çështjet e mëposhtme:

a) një rishikim të përgjithshëm të kësaj marrëveshjeje, me qëllim të avancimit të objektivave të saj;

b) të diskutojë dhe të rishikojë zbatimin dhe funksionimin e kësaj marrëveshjeje;

c) të shqyrtojë çdo çështje të ngritur nga secila Palë, në lidhje me marrëveshjet e investimeve;

d) të rishikojë mundësinë e lehtësimit të mëtejshëm të investimit ndërmjet palëve;

e) vlerësimi i rezultateve të marra nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe shqyrtimi i çdo çështjeje apo çështjeje tjetër në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje; dhe

4. Komiteti, me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, mund të ftojë përfaqësues të subjekteve përkatëse të ndryshme nga Qeveritë e Palëve, me ekspertizën e nevojshme, në lidhje me çështjet që do të diskutohen dhe të zhvillojë takime të përbashkëta me sektorët privatë.

5. Komiteti mund të krijojë komitete dhe nënkomitete dhe t'u delegojë detyra specifike nënkomiteteve të tilla.

6. Komiteti do të mblidhet periodikisht për të diskutuar dhe për të rishikuar progresin e bërë në çështjet e mësipërme rregullisht dhe për të identifikuar dhe për të shqyrtuar masat e mëtejshme për të përmirësuar bashkëpunimin e tyre dhe për të avancuar më tej marrëdhëniet midis shteteve.

7. Ministritë kompetente të linjës të të dyja vendeve janë të autorizuara që të veprojnë si autoritete përkatëse, të cilave u është besuar koordinimi, ndjekja dhe përgatitja për takimet e të dyja Palëve dhe nënkomiteteve të tyre dhe të raportojnë te Palët në lidhje me progresin.

Neni 9

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me ratifikimin nga Parlamenti, për të cilin Palët do të njoftohen me kanale diplomatike për përfundimin e procedurave kushtetuese të nevojshme për ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje. Dhe, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit të fundit, se pala e fundit ka përfunduar procedurat kushtetuese të nevojshme për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh, nëse nuk përfundon në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni.

Çdo Palë ka të drejtë të përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke informuar Palën tjetër për këtë në formë të shkruar, nëpërmjet kanaleve diplomatike; ky përfundim do të jetë i vlefshëm pas gjashtë muajsh nga data e njoftimit.

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në përmbushjen e angazhimeve, zotimeve, programeve të punës, kontratave dhe marrëveshjeve tashmë të iniciuara, përveç nëse bihet dakord ndryshe me shkrim nga të dyja Palët.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqim të ndërsjellë në çdo kohë, me shkëmbim të notave midis tyre nëpërmjet kanaleve diplomatike; ky ndryshim do të zbatohet në përputhje me procedurat e lartpërmendura në paragrafin 1.

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave midis dy Palëve, me kanale diplomatike.

Nënshkruar në qytetin Abu Dhabi, në datën 26 nëntor 2020, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndryshimeve në interpretimin e Marrëveshjes, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Kryeministri dhe ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme
Edi Rama

PËR QEVERINË E EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE
Ministri i Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar
Abdullah Bin Zayed Al Nahyan

LIGJ
Nr. 155/2020

PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

a) të kontribuojë në uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë;

b) të përshpejtojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, me synim zbutjen e efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike;

c) të kontribuojë në përpjekjet globale ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet plotësimit të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë ndaj Konventës;

ç) të krijojë një kuadër gjithëpërfshirës ligjor dhe ndërinstitucional për ndërmarrjen e veprimeve ndaj klimës në nivel kombëtar në përputhje me legjislacionin e BE-së për ndryshimet klimatike.

d) t'u bashkohet shteteve që njohin emergjencën klimatike, sipas vendimit të Parlamentit Evropian të 28 nëntorit 2019.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj përcakton:

a) kuadrin e përgjithshëm të politikës kombëtare për veprime ndaj ndryshimeve klimatike;

b) kushtet e shkarkimeve të gazeve serrë nga burimet e palëvizshme e të lëvizshme, nga produktet dhe substancat;

c) kushtet e kapjes dhe të depozitimit gjeologjik të dyoksidit të karbonit;

ç) kuadrin e masave për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazit me efekt serrë në nivelin e sektorëve/burimeve dhe në nivel kombëtar në përputhje me angazhimet kombëtare, financimet e brendshme dhe ndërkombëtare;

d) kuadrin për pjesëmarrje në veprime ndërkombëtare të klimës;

dh) ngritjen e sistemit institucional për ndërmarrjen e veprimeve ndaj ndryshimeve klimatike.

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2003/87/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 tetor 2003, "Për krijimin e një skeme për tregtinë e lejeve për shkarkimet e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit dhe që ndryshon Direktivën e Këshilllit 96/61/KE", e ndryshuar. Numri CELEX 32003L0887, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 275, datë 25.10.2003, f. 32–46.

- Rregulloren (BE) nr. 525/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 maj 2013, "Mbi mekanizmin e monitorimit dhe raportimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe për raportimin e informacioneve të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar dhe të Bashkimit Evropian, që shfuqizon vendimin nr. 280/2004/KE", të ndryshuar", Numri CELEX 32013R0525, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 165, datë 18.6.2013, f. 13–40.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Efekte të dëmshme të ndryshimeve klimatike" janë ndryshimet në mjedisin fizik apo biotë që rezultojnë nga ndryshimet klimatike, të cilat kanë efekte të rëndësishme negative mbi përbërjen, aftësinë vetëpërtëritëse, produktivitetin e ekosistemeve natyrore apo të menaxhuara, funksionimin e sistemeve social-ekonomike apo mbi shëndetin dhe mirëqenien e njeriut e të kafshëve blegtorale, si: gjedh, të imta, derra dhe njëthundrakë.

2. "Ndryshim klimatik" është një ndryshim i klimës, që i atribuohet direkt apo indirekt aktivitetit të njeriut, i cili ndryshon përbërjen e atmosferës globale dhe që i shtohet ndryshueshmërisë natyrore të klimës, që vërehet në periudha kohe të krahasueshme.

3. "Sistem i klimës" është tërësia e atmosferës, hidrosferës, biosferës e gjeosferës dhe ndërveprimeve të tyre.

4. "Shkarkime" janë çlirimet nga aktivitetet antropogjene të GES-it dhe/ose prekursorëve të tyre në atmosferë, në një sipërfaqe dhe periudhë kohe të caktuar.

5. "Rezervuar" është një përbërës apo përbërësit e sistemit të klimës ku depozitohet një GES apo një prekursor i GES-it.

6. "Përthithës" është çdo proces, aktivitet apo mekanizëm, që largon një GES, një aerosol ose një prekursor të GES-it nga atmosfera.

7. "Burim" është çdo proces apo aktivitet që çliron një GES, një aerosol apo një prekursor të GES-it nga atmosfera.

8. "Konventa" është Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, miratuar në Nju Jork më 9 maj 1992, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 1995 dhe ku Republika e Shqipërisë është palë jo e shtojcës I.

9. "Protokolli i Kiotos" është Protokolli i Kiotos i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuar për Ndryshimet Klimatike, miratuar në Kioto më 11 dhjetor 1997, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 30 qershor 2005.

10."Kapja dhe depozitimi gjeologjik i dyoksidit të karbonit (CO2)" është një teknologji e ndërmjetme/lidhëse, që synon të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Ajo konsiston në kapjen e CO2 nga instalimet industriale, transportin e tij në një vend depozitimi dhe injektimin në një formacion gjeologjik të përshtatshëm nën tokë, me qëllim ruajtjen e përhershme.

11."Gaz me efekt serrë (GES)" janë gazet që gjenden në atmosferë në gjendje natyrale dhe të shkaktuara nga aktivitetet antropogjene, të cilat përthithin dhe riemetojnë rrezatimin infra të kuq. Lista e GES-it të shkarkuar nga aktivitetet antropogjene, që mbulohen nga ky ligj, është në shtojcën I.

12."Leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES-it" janë lejet e mjedisit të tipave A dhe B, që përmbajnë edhe kushte për GES-in dhe që lëshohen në përputhje me kërkesat e ligjit për lejet e mjedisit dhe të kreut III të seksionit I të këtij ligji.

13."Instalim" është një njësi teknike e palëvizshme, ku kryhen një apo më shumë aktivitete që bëjnë pjesë në shtojcën II, pjesa A e këtij ligji, dhe çdo aktivitet tjetër shoqërues që ka lidhje teknike me aktivitetet e kryera në atë vendndodhje dhe që mund të ketë ndonjë efekt mbi shkarkimet dhe ndotjen;

14."Ton ekuivalent dyoksid karboni" është një ton metrik dyoksid karboni (CO2) ose një sasi e çfarëdo GES-i tjetër të listës në shtojcën I, që ka potencial ekuivalent për ngrohje globale.

15."Djegie" është oksidimi i lëndës djegëse, pavarësisht mënyrës sesi përdoret nxehtësia, energjia elektrike apo mekanike e prodhuar nga ky proces, dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet drejtpërdrejt me të, përfshirë pastrimin e mbetjeve të gazta;

16."Politika dhe masa" janë të gjitha instrumentet që synojnë të zbatojnë angazhimet që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike, duke kufizuar shkarkimet antropogjene të GES-it dhe mbrojtjen e shtimin e përthithësve e të rezervuarëve dhe që mund të përfshijnë edhe ato që nuk kanë si objektiv parësor kufizimin dhe reduktimin e shkarkimeve të GES-it.

17."Investime miqësore ndaj klimës" janë investimet në teknologji, që shkarkojnë pak karbon ose që çojnë në ripërtëritjen e klimës, drejt një ekonomie me pak karbon, që e kufizon ngrohjen globale në 2°C.

18."Transferim i teknologjisë" është një tërësi procesesh që mbulojnë transferimin e njohurive

teknike *(know - how)* të eksperiencës dhe pajisjeve për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre ndërmjet aktorëve të ndryshëm, si: qeveritë, entet private, institucionet financiare, OJQ-të dhe institucionet kërkimore/arsimore.

19."Integrim" është integrimi i objektivave, strategjive, politikave, masave apo operacioneve të zbutjes dhe/ose të përshtatjes, në mënyrë të tillë që ato të bëhen pjesë e politikave, të proceseve dhe buxheteve të zhvillimit rajonal e kombëtar në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat.

20."Përshtatje" janë rregullimet e bëra nga njeriu në sistemet ekologjike, sociale, ekonomike ose proceset politike, në përgjigje të ndryshimeve aktuale apo të pritshme të klimës, efekteve apo ndikimeve të tyre.

21."Zbutje" janë të gjitha përpjekjet e bëra për të reduktuar apo parandaluar shkarkimet e GES-it, përfshirë përdorimin e teknologjive të reja dhe energjive të rinovueshme, që i bëjnë pajisjet e vjetra më eficiente ndaj konsumit të energjisë, që ndryshojnë praktikat e menaxhimit apo sjelljen e konsumatorit.

22."Operator" është sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar.

23."Operator avioni" është personi që operon një avion në kohën kur ai kryen një aktivitet aviacioni sipas përcaktimit të këtij ligji, me përjashtim të operacioneve të listuara në pjesën B të shtojcës II, ose, kur ky person është i panjohur ose i paidentifikuar nga pronari i avionit, vetë pronari i avionit.

24."Operator i transportit ajror tregtar" është sipas përkufizimit në ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

25."Person" është çdo person fizik ose juridik.

26."Publik" është një ose janë më shumë persona dhe, në përputhje me legjislacionin apo praktikën në fuqi, shoqata, organizata ose grupe personash.

27."Ministri" është ministri përgjegjës për mjedisin.

28."Ministria" është ministria përgjegjëse për mjedisin.

29."AKM" është Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

30."NDC" është dokumenti i kontributit tonë kombëtar të synuar, në linjë me përpjekjet globale për reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë (GES).

31."Mekanizmi i zhvillimit të pastër (MZHP)" është një mekanizëm i bazuar në projekte, që buron nga Protokolli i Kiotos dhe që nxit partnershipin midis vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim të Konventës për arritjen e objektivit final të saj, stabilizimin e GES-it në atmosferë.

32."Sistemi i inventarit kombëtar" është sistemi i rregullimeve institucionale, ligjore dhe procedurale të bëra në Republikën e Shqipërisë për vlerësimin e shkarkimeve antropogjene nga burimet dhe përthithjen e tyre nga përthithësit e GES-it, të listuara në shtojcën I, si dhe për raportimin dhe arkivimin e informacionit të këtij inventari.

33."Inventari i GES-it" është inventari i shkarkimeve, që përfshin shkarkimet e GES-it nga kategoritë e burimeve, si dhe përthithjen e tyre nga përthithësit e karbonit.

34."IGJEUM" është Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

35."Konventa e Aarhusit" është konventa për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000.

36."Njësitë që përdorin ekskluzivisht biomasën" janë njësitë që përdorin lëndë djegëse fosile gjatë ndezjes apo fikjes së njësisë.

37."Emergjencë klimatike" është një situatë në të cilën kërkohet veprim urgjent për të zvogëluar ose ndalur ndryshimet klimatike dhe për të shmangur dëmet e mundshme të pakthyeshme mjedisore që rezultojnë prej saj.

KREU II
POLITIKA KOMBËTARE PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Neni 4
Objektivat dhe parimet

1. Me synimin për të zvogëluar efektet e dëmshme të ndryshimeve klimatike dhe për të kontribuar në përgjigjen globale ndaj tyre, objektivat kombëtarë për ndryshimet klimatike në Republikën e Shqipërisë janë:

a) zvogëlimi i shkarkimeve antropogjene të gazeve me efekt serrë në nivel kombëtar, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare;

b) rritja e aftësisë për t'u përshtatur ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike, në nivel kombëtar, qendror e vendor;

c) ruajtja dhe rritja e përthithësve dhe rezervuarëve të gazeve me efekt serrë;

ç) nxitja e zhvillimit ekonomik nëpërmjet krijimit të vendeve të punës dhe konkurrencës, duke përfshirë edhe diversifikimin ekonomik dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;

d) pjesëmarrja graduale në zbatimin e politikës së ndryshimeve klimatike të Bashkimit Evropian.

2. Objektivat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohen në funksion të parimeve të mëposhtme:

a) parimi i përgjegjësive të përbashkëta, por të diferencuara, sipas të cilit të gjitha palët e Konventës, pavarësisht nëse janë vende në zhvillim apo të zhvilluara, marrin përgjegjësi për reduktimin e gazeve me efekt serrë sipas kushteve të secilit vend dhe brenda situatës së re ekonomike dhe politike të krijuar;

b) parimi i kujdesit paraprak, sipas të cilit masat duhen marrë, në radhë të parë, për të parashikuar, parandaluar apo minimizuar shkaqet e ndryshimeve klimatike dhe për të zbutur efektet e tyre të dëmshme;

c) parimi i eficiencës, sipas të cilit politikat dhe masat që merren për ndryshimet klimatike duhet të jenë me kosto efektive, në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfitime globale me kostot më të ulëta të mundshme;

ç) parimi i integrimit, sipas të cilit politikat dhe masat që merren për të mbrojtur sistemin e ndryshimit të klimës nga faktorët antropogjenë, si dhe përshtatja ndaj këtyre ndryshimeve duhet të përfshijnë të gjithë sektorët ekonomikë dhe të mbulojnë të gjitha burimet, përthithësit e rezervuarët e GES-it. Integrimi i ndryshimeve klimatike duhet bërë në të gjitha politikat dhe praktikat ekzistuese e të ardhshme sektoriale e ndërsektoriale;

d) parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, sipas të cilit masat për mbrojtjen e sistemit të klimës nga ndryshimet antropogjene të integruara në politikën dhe programet e zhvillimit kombëtar duhet të çojnë në rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit;

dh) parimi i bashkëpunimit dhe financimit kombëtar dhe ndërkombëtar, sipas të cilit përpjekjet për të trajtuar ndryshimet klimatike mund të bëhen bashkërisht dhe në koordinim me vende të tjera të interesuara dhe, përveç buxhetit të shtetit, të mbështeten edhe nga burime financimi ndërkombëtare apo dypalëshe.

Neni 5

Dokumenti Strategjik dhe planet kombëtare për ndryshimet klimatike

1. Dokumenti Strategjik për Ndryshimet Klimatike krijon kuadrin e përgjithshëm kombëtar për veprim ndaj ndryshimeve klimatike dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

2. Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) janë pjesë përbërëse e dokumentit strategjik, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) përcakton masat kombëtare për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe shtimin e përthithësve të GES-it në sektorët përkatës.

4. Plani Kombëtar për Përshtatje krijon kuadrin për një proces të vazhdueshëm të përshtatjes në vend dhe përcakton objektivat për përshtatjen, nxit integrimin e përshtatjes në politikat sektoriale të ministrive të linjës, përcakton masat prioritare dhe organizon përgjegjësitë dhe mekanizmat e bashkëpunimit brenda proceseve të përshtatjes.

5. Krahas kërkesave të tjera për formulimin e strategjive e të planeve, dokumenti strategjik dhe planet për ndryshimet klimatike përfshijnë çështjet nga lista joshteruese sipas shtojcës III-A bashkëlidhur këtij ligji.

6. Ministria nëpërmjet grupit ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike monitoron dhe vlerëson çdo 4 vjet progresin për zbatimin e dokumentit strategjik për ndryshimet klimatike dhe harton raportin, i cili përmban informacionin për:

a) vlerësimin e progresit në reduktimin e shkarkimeve dhe të përthithjes nga rezervuarët e GES-it, në raport me Kontributin Kombëtar të Përcaktuar (NDC);

b) vlerësimin e progresit në zbatimin e Planit Kombëtar të Zbutjes së Gazeve me Efekt Serrë;

c) zbatimin e Planit Kombëtar për Përshtatje ndaj Ndryshimeve Klimatike, që përfshin: gjetjet e reja dhe vulnerabilitetin mbi ndryshimet klimatike; aktivitetet e kryera gjatë procesit të NAP-it; progresin dhe vështirësitë në integrimin e përshtatjes në sektorët e tjerë; progresin dhe vështirësitë në arritjen e objektivave e të indikatorëve; rekomandimet për masat në të ardhmen.

7. Dokumenti Strategjik, Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) rishikohen çdo 4 vjet.

Neni 6
Integrimi i ndryshimeve klimatike në strategjitë sektoriale

1. Për të arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, duke ndjekur njëkohësisht një rrugë me përdorim më pak intensiv të karbonit, ministritë e linjës dhe NJVQV-të me përgjegjësi shtetërore në fusha që kanë ndikim mbi/apo nga ndryshimet klimatike, kanë detyrimin:

a) të integrojnë çështjet e zbutjes e të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në legjislacionin, strategjitë, planet, programet dhe projektet e tyre të zhvillimit, veçanërisht në sektorët e transportit, të energjisë, ujërave, bujqësisë dhe zhvillimit rural, zhvillimit urban dhe menaxhimit të fatkeqësive, si edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

b) të bashkëpunojnë për zbatimin e legjislacionit, të strategjive, planeve, programeve dhe projekteve që trajtojnë ndryshimet klimatike;

c) të bashkëpunojnë për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e zbatimit të strategjive, planeve, programeve dhe projekteve që trajtojnë ndryshimet klimatike.

2. Masat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kanë si qëllim të kontribuojnë në:

a) arritjen e angazhimit afatgjatë të vendit për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe rritjen e përthithjes nga përthithësit në të gjithë sektorët, sipas objektivit të caktuar në NDC, në mënyrë sa më eficiente;

b) identifikimin e masave të përshtatshme për uljen e vulnerabilitetit dhe rritjen e aftësive ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike të sektorëve përkatës dhe zbatimin e tyre;

c) monitorimin transparent dhe konsistent të progresit aktual dhe atij të planifikuar për të plotësuar angazhimet e vendit në Konventë.

3. Krahas kërkesave të tjera lidhur me formulimin e strategjive, procesi i integrimit të ndryshimeve klimatike në strategjitë sektoriale përfshin çështje nga lista joshteruese, sipas shtojcës III-B bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 7
Kontributi Kombëtar i Përcaktuar (NDC)

1. Dokumenti i NDC-së përcakton kontributin kombëtar për reduktimin e gazeve me efekt serrë përkundrejt arritjes së objektivit global të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, për mbajtjen e temperaturave në 2°C, duke kufizuar rrezikun e ardhshëm dhe kostot e përshtatjes ndaj ndryshimeve të klimës.

2. Kontributi Kombëtar i Përcaktuar rishikohet çdo 4 vjet dhe, nëse është e mundur, përditësohet me synimin për ta rritur objektivin e reduktimit të gazeve me efekt serrë në atë masë që lejojnë kushtet e vendit.

3. Ministria koordinon me grupin ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike dhe, sipas rastit, edhe me aktorë të tjerë punën për zbatimin dhe rishikimin e dokumentit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Metodologjia për hartimin dhe procesin e përgatitjes së dokumentit të NDC-së miratohet me udhëzim të ministrit, sipas modelit të miratuar ose të rekomanduar nga Konventa, në përputhje me kushtet e vendit.

5. Dokumenti "Përcaktimi i Kontributit Kombëtar" miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit dhe dorëzohet në sekretariatin e Konventës.

KREU III
SHKARKIMET E GES-it NGA BURIMET E LËVIZSHME E TË PALËVIZSHME, PRODUKTET DHE SUBSTANCAT

SEKSIONI I
SHKARKIMET E GES-it NGA BURIMET E PALËVIZSHME

Neni 8
Monitorimi, raportimi dhe verifikimi i shkarkimeve të GES-it nga instalimet

1. Operatori i një instalimi, që kryen cilindo nga aktivitetet e listuara në shtojcën II-A bashkëlidhur këtij ligji, monitoron shkarkimet që kryhen nga instalimi gjatë një viti kalendarik dhe harton raportin e të dhënave të monitorimit të GES-it, të cilin e dorëzon pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit brenda muajit shkurt të vitit pasardhës, në përputhje me rregulloren e parashikuar në pikën 2 të këtij neni. AKM-ja pranon raportin e monitorimit të shkarkimeve të GES-it vetëm nëse raporti është verifikuar nga një verifikues i akredituar.

2. Rregullorja për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të CO_2 dhe gazeve të tjera me efekte serrë nga aktivitetet industriale të listuara në shtojcën II-A të këtij ligji miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit.

Neni 9
Kriteret për përfshirjen e shkarkimeve GES në lejen e mjedisit

1. Operatori i një instalimi të ri, sipas listës në shtojcën II-A të këtij ligji, në aplikimin e tij për leje mjedisi, krahas formularit informues sipas legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit, dorëzon edhe formatin që përfshin informacionin për shkarkimin e GES-it, në përputhje me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.

2. Operatori i një instalimi ekzistues, sipas listës në shtojcën II-A të këtij ligji, paraqet kërkesën për rishikimin e kushteve të lejes së mjedisit, duke e shoqëruar atë me formatin që përfshin informacionin për shkarkimin e GES-it, në përputhje me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.

3. AKM-ja lëshon lejen e mjedisit që përfshin shkarkimet e GES-it për të gjithë apo për një pjesë të instalimit nëse operatori është në gjendje të demonstrojë se ka marrë masat e nevojshme që të monitorojë e të raportojë shkarkimet e GES-it sipas kërkesave të rregullores, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.

Neni 10
Aplikimi për leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES-it

1. Operatori i një instalimi, sipas nenit 9 të këtij ligji, i cili aplikon për leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES-it, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dorëzon formatin e aplikimit që përmban informacionin për:

a) instalimin dhe aktivitetet e tij, përfshirë përshkrimin rreth teknologjisë më të mirë të mundshme të përdorur, që ndihmon në uljen e shkarkimeve të GES-it;

b) lëndët e para dhe materialet ndihmëse, përdorimi i të cilave mund të çojë në shkarkime të GES-it, të listuara në shtojcën I;

c) burimet e shkarkimeve të GES-it nga instalimet e listuara në shtojcën II-A;

ç) masat e planifikuara prej tij për të monitoruar e raportuar shkarkimet e GES-it në përputhje me rregulloren e parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.

2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përfshihet në formatin e aplikimit për lejen e mjedisit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit në fuqi për lejet e mjedisit.

3. Kur operatori zotëron një ose më shumë instalime në të njëjtën vendndodhje, AKM-ja lëshon vetëm një leje mjedisi, që përfshin shkarkimet e GES-it me kërkesa për këto instalime.

Neni 11
Kushtet që duhet të përmbajë leja e mjedisit për shkarkimet e GES-it

1. Kushtet që duhet të plotësojë një instalim për shkarkimet GES lidhen vetëm me monitorimin dhe raportimin e tyre në përputhje me rregulloren e përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji dhe jo me vendosjen e vlerave kufi për shkarkimet e GES-it apo reduktimin e tyre.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit vendos kushtet që lidhen me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES-it në aktin e miratimit për lejen e mjedisit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit në fuqi për lejet e mjedisit.

Neni 12
Ndryshime të instalimeve

1. Operatori duhet të informojë AKM-në për çdo ndryshim që planifikon të bëjë në natyrën apo funksionimin e instalimit ose çdo zgjerim a reduktim të rëndësishëm të kapacitetit të vet, për të cilin mund të nevojitet përditësimi i kushteve të lejes së mjedisit lidhur me shkarkimin e GES-it.

2. Ndryshimi i rëndësishëm i kapacitetit, siç referohet në pikën 1 të këtij neni, nënkupton një ndryshim në funksionim, i cili, sipas gjykimit të AKM-së, arrin pragun e kapacitetit prodhues ose sasinë e prodhimit të një instalimi të listuar në shtojcën II-A të këtij ligji.

3. AKM-ja njofton operatorin kur e sheh të nevojshme përditësimin e kushteve që lidhen me shkarkimet e GES-it. Procedura e përditësimit të kushteve që lidhen me shkarkimet GES është e njëjtë me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit.

SEKSIONI II

Neni 13
Shkarkimet e GES-it nga burimet e lëvizshme

1. Automjetet e reja për pasagjerë dhe automjetet e reja të lehta tregtare vendosen në treg vetëm nëse janë në përputhje me kërkesat e performancës së emetimeve të CO_2, të specifikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat e detajuara të performancës së emetimeve të CO_2 nga automjetet e reja për pasagjerë dhe automjetet e reja të lehta tregtare, të cilat përfshijnë:

a) monitorimin dhe raportimin e të dhënave për regjistrimin e automjeteve të reja për pasagjerë për vlerësimin e reduktimit të shkarkimeve të CO_2 nga automjetet e lehta;

b) monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO_2 nga automjetet e reja për pasagjerë dhe nga automjetet e reja të lehta tregtare.

3. Automjetet e reja për pasagjerë dhe automjetet e reja të lehta tregtare mund të shiten ose të jepen me qira vetëm nëse janë të shoqëruara me informacionin e duhur për konsumatorin për ekonominë e karburantit dhe emetimet e CO_2.

4. Masat për sigurimin e informacionit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO_2 gjatë marketingut të automjeteve të reja, sipas pikës 3 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin.

5. Shkarkimet e CO_2 të lëshuara nga anijet që transportojnë mallra apo pasagjerë për qëllime tregtare, nga porti i tyre më i fundit në një port të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga një port i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë në portin e tyre të ardhshëm, si dhe në portet që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, u nënshtrohen monitorimit, raportimit dhe verifikimit në përputhje me vendimin e parashikuar në pikën 8 të këtij neni.

6. Çdo operator avioni, i pajisur me licencë nga ministria përgjegjëse për transportin, për fluturimet që nisen nga apo arrijnë në një aeroport që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë ose midis aeroporteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të atyre që listohen në shtojcën II-B të këtij ligji, është subjekt i monitorimit, raportimit dhe verifikimit të shkarkimeve të CO_2.

7. Operatorët dorëzojnë në AKM planin e monitorimit, i cili përcakton masat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO_2, si dhe të dhënat ton-kilometër në përputhje me kërkesat e rregullores të parashikuar në pikën 8 të këtij neni.

8. Rregullorja për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të CO2 nga anijet dhe avionët miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

SEKSIONI III
SHKARKIMET E GES-it NGA SEKTORË TË TJERË

Neni 14
Sektori i energjisë

1. Ministritë përgjegjëse për energjinë, ekonominë, zhvillimin urban dhe mjedisin nxitin zbatimin e masave për prodhimin e energjive nga burimet e rinovueshme pa karbon, të masave për ruajtjen e eficiencës së energjisë në të gjithë sektorët ekonomikë, përfshirë performancën e energjisë në ndërtesa, masat për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Masa të tilla rregullohen nga legjislacioni për eficiencën e energjisë, për burimet e energjisë së rinovueshme, si dhe nga legjislacioni tjetër i posaçëm.

2. Zhvillimi i strategjive dhe planeve afatgjata, që integrojnë energjinë dhe ndryshimet klimatike, rregullohet nëpërmjet krijimit të një mekanizmi qeverisës, që miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

3. Strategjitë dhe planet afatgjata të energjisë dhe klimës përfshijnë objektiva dhe masa për periudhat deri në vitet 2030 dhe 2050, që lidhen me sigurinë energjetike, tregun e brendshëm të energjisë, eficiencën e energjisë, burimet e rinovueshme të energjisë, dekarbonizimin, kërkimin, inovacionin dhe konkurrueshmërinë, si dhe raportimin e progresit të tyre.

4. Plani kombëtar i energjisë dhe klimës për periudhën 2021-2030 miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

SEKSIONI IV
SHKARKIMET E GES-it NGA PRODUKTET DHE SUBSTANCAT

Neni 15
Shkarkimet nga lëndët djegëse

1. Furnizuesit e lëndëve djegëse të lëngëta, përfshirë biokarburantet, monitorojnë dhe raportojnë shkarkimet e gazeve me efekt serrë për njësi të energjisë nga lëndët djegëse gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre. Raportet e shkarkimeve janë subjekt i verifikimit përpara dorëzimit të tyre në AKM.

2. Rregullat e detajuara, që lidhen me mekanizmin e monitorimit e të reduktimit të shkarkimeve të GES-it nga lëndët djegëse të lëngëta, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 16
Substancat ozonholluese (ODS)

1. Masat për mbrojtjen e shtresës së ozonit përfshijnë nxjerrjen jashtë përdorimit të substancave ozonholluese dhe zëvendësimin e tyre nga substanca dhe produkte alternative, që janë miqësore ndaj shtresës së ozonit.

2. Për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca zbatohen rregullat e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të ligjit nr. 26/2016, "Për menaxhimin e kimikateve".

Neni 17
Gazet e florinuara

1. Gazet e florinuara janë përdorur si substanca alternative për të zëvendësuar substancat ozonholluese, por ato janë gaze me efekt serrë të fuqishme. Masat për parandalimin, kufizimin, përdorimin, rikuperimin dhe shkatërrimin e gazeve serrë të fluorinuara, si edhe të kushteve për hedhjen në treg të produkteve dhe pajisjeve specifike që i përmbajnë ose funksionimi i të cilave bazohet në gazet serrë të fluorinuara, çojnë në reduktimin e gazeve me efekt serrë.

2. Masat për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara miratohen me ligj të veçantë.

SEKSIONI V
PËRTHITHJA, KAPJA DHE DEPOZITIMI I SHKARKIMEVE TË GES-it

Neni 18
Përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet (LULUCF)

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe/ose bashkitë projektojnë dhe zhvillojnë politika dhe masa për zbutjen e ndryshimeve klimatike në fushën e pyjeve e të bujqësisë, duke synuar reduktimin e shkarkimeve dhe përthithjen e karbonit nga sektorët e bujqësisë, të pyjeve, përdorimeve të tjera të tokës dhe ruajtjes së ekosistemeve. Në mënyrë të veçantë, bazuar edhe në të dhënat e sistemit të monitorimit të pyjeve, ato angazhohen për:

a) luftën kundër shpyllëzimeve dhe degradimit të ekosistemeve pyjore për t'i rikthyer ato në gjendjen e mëparshme, për të zgjeruar sipërfaqet e tokës me bimësi dhe me përmbajtje karboni organik, duke zbatuar praktika të menaxhimit të qëndrueshëm në zonat bujqësore;

b) ruajtjen, zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe shtimin e rezervave të karbonit në pyje;

c) zhvillimin e programeve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe restaurimin e ekosistemeve pyjore, ligatinore e bregdetare-detare;

ç) përfshirjen e sa më shumë ekosistemeve në planet e ruajtjes *(conservation plans)*;

d) forcimin e luftës kundër zjarreve në pyje;

dh) projektimin dhe sigurimin e iniciativave ekonomike për përthithjen e karbonit dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura.

2. Bashkitë informojnë çdo vit ministrinë për shpyllëzimet dhe degradimin e pyjeve, që kanë ndodhur në territorin administrativ nën juridiksionin e tyre.

3. Ministria regjistron të dhënat për zonat që kanë pësuar shpyllëzim dhe degradim për shkak të zgjerimit të tokave bujqësore, të kthimit në kullota, të zhvillimit infrastrukturor, të prerjeve të paligjshme dhe zjarreve.

4. Rregullat e përllogaritjes së shkarkimeve të GES-it dhe të përthithjes së tyre, që rezultojnë nga aktivitetet që lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimin e përdorimit të tokës e pyjeve, si dhe për informacione të tjera që lidhen me këto aktivitete, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 19
Kapja dhe depozitimi gjeologjik i dyoksidit të karbonit

1. Operatori i një instalimi të listuar në shtojcën II-A të këtij ligji, që shkarkon CO_2, mund të zgjedhë t'i zbusë këto shkarkime nëpërmjet mënyrave të ndryshme të kapjes dhe depozitimit të tij, si, për shembull, në formacione gjeologjike nën tokë ose përmes veprimeve të tjera që çojnë në këtë rezultat, sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

2. Rregullat e kapjes dhe të depozitimit gjeologjik të dyoksidit të karbonit apo në mënyra të tjera miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për minierat dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

SEKSIONI VI
MATJA, RAPORTIMI DHE VERIFIKIMI I SHKARKIMEVE TË GES-it

Neni 20
Matja, raportimi dhe verifikimi (MRV)

1. MRV-ja nënkupton matjen apo vlerësimin e bërë në Republikën e Shqipërisë, raportimin si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, verifikimin (sigurimin dhe kontrollin e cilësisë) QA/QC në nivel kombëtar, si dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare të shkarkimeve/përthithjes ose të dhënave të tjera, që matin performancën, të përcaktuara në:

a) Raportin Kombëtar të Inventarit të GES-it;

b) komunikimet kombëtare, raportet e përditësuara dyvjeçare, raportin e NDC-së;

c) raportet e monitorimit të shkarkimeve të GES-it nga operatorët që kanë këtë detyrim;

ç) analizën e efekteve të zbatimit të dokumenteve strategjike për ndryshimet klimatike;

d) projeksionet e emetimeve antropogjene të gazeve serrë dhe përthithjen e tyre;

dh) investimet dhe mbështetjen financiare për ndryshimet klimatike.

2. Sistemi MRV ngrihet për të rritur transparencën për përpjekjet që bëhen për zbutjen e ndryshimeve klimatike. MRV-ja synon:

a) të masë si përpjekjet për zbutjen e ndryshimeve klimatike, ashtu edhe ndikimin e zbatimit të masave të përshtatshme kombëtare, nivelin e shkarkimeve të GES-it dhe tërheqjen e tyre nga përthithësit, reduktimin e shkarkimeve;

b) të raportojë informacionin e matur në mënyrë transparente dhe të standardizuar nëpërmjet komunikimeve kombëtare, raporteve të përditësuara dyvjeçare (BUR), raporteve të zbatimit të NDC-së, siç parashikohet në nenin 22;

c) të verifikojë e të vlerësojë saktësinë, plotësinë, konsistencën dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar nëpërmjet një procesi të pavarur.

3. MRV-ja në Republikën e Shqipërisë do të funksionojë si një sistem me qasje nga poshtë-lart, me të dhëna që monitorohen fillimisht nga operatorët, operatorët e avionëve dhe të anijeve, që janë subjekt i këtij ligji, përfshirë institucionet e varësisë, sipas rastit, të cilat u raportohen ministrive përkatëse të linjës dhe AKM-së, siç përcaktohet në aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj. Sistemi MRV do të trajtojë njëkohësisht edhe kërkesat ndërkombëtare.

Neni 21

Monitorimi, raportimi i shkarkimeve të GES-it dhe informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregulloren për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të GES-it dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar.

2. Vendimi, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, krijon:

a) Sistemin Kombëtar të Inventarit të GES-it, duke përcaktuar procedurat kombëtare për grumbullimin, përpunimin, raportimin, verifikimin dhe arkivimin e të dhënave e të informacionit të kërkuar, i cili duhet të jetë funksional, mbi baza të qëndrueshme e të vazhdueshme, si dhe përcakton organet kompetente;

b) Sistemin e Monitorimit dhe të Vlerësimit (M&V) të masave kombëtare për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike. Nëpërmjet M&V-së synohet ndjekja e progresit në zbatimin e politikave, të planeve adaptuese, ndërhyrjeve e investimeve të përshtatjes dhe/ose sesi këto ndërhyrje po reduktojnë vulnerabilitetin, duke përmirësuar kapacitetin adaptues dhe duke mbështetur mirëqenien e përgjithshme të popullsisë së prekur nga ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Neni 22

Raportimet kundrejt Konventës

1. Format kryesore të raportimit të Republikës së Shqipërisë në Konventë janë:

a) komunikimet kombëtare;

b) raportet e përditësimit dyvjeçar (BUR);

c) raporti i zbatimit të NDC-së;

ç) raporti i inventarit kombëtar të shkarkimeve të GES-it.

2. Kërkesat për përgatitjen e tyre përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave sipas nenit 21, pika 1, të këtij ligji.

KREU IV

AUTORITETET KOMPETENTE

Neni 23

Kuadri institucional dhe koordinimi ndërministror

1. Për të lehtësuar koordinimin efektiv midis të gjithë aktorëve të sektorit publik e privat, për të siguruar një monitorim, raportim e verifikim (MRV) me cilësi të lartë në vazhdimësi dhe në kohë të raportimeve kundrejt Konventës dhe për të trajtuar çdo masë tjetër për ndryshimet klimatike bëhen rregullimet institucionale si më poshtë:

a) ministria është pika qendrore kombëtare e Konventës dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e sistemit MRV, përfshirë koordinimin e procesit të përgatitjes së komunikimit kombëtar, të raporteve të përditësimit dyvjeçar (BUR) dhe raportit të zbatimit të NDC-së;

b) AKM-ja është autoriteti kompetent kombëtar për të gjitha aktivitetet që lidhen me ngritjen dhe mbajtjen e Sistemit Kombëtar të Inventarit, si pjesë e sistemit të informacionit mjedisor;

c) ministritë e linjës, kompetencat e të cilave bien në fushat e përgjegjësisë shtetërore që ndikojnë apo ndikohen nga ndryshimet klimatike, sipas rastit, grumbullojnë dhe mbajnë të dhëna për aktivitete, tregues specifikë/tematikë të grupuar dhe informacion që lidhet me klimën e i ofrojnë

ministrisë kontributin e tyre me shkrim në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave të parashikuar në nenin 21 të këtij ligji. Ato marrin pjesë në përgatitjen dhe deri në finalizimin e miratimin e të gjitha dokumenteve, si dhe në raportimet, sipas nenit 22 të këtij ligji, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

ç) INSTAT-i ka detyrimin t'i ofrojë ministrisë të gjitha të dhënat social-ekonomike të popullsisë dhe të tjera që lidhen me to;

d) operatorët, që janë subjekt i këtij ligji, dhe institucionet publike, aktivitetet e të cilave bien në fushat e përgjegjësisë shtetërore që jepen në pikën 2 të këtij neni, grumbullojnë, organizojnë dhe mbajnë, sipas rastit, të dhënat e tyre për klimën, bashkë me raportet përkatëse, dhe i vënë në dispozicion të ministrisë përkatëse;

dh) ministritë e tjera të linjës dhe institucionet publike/private, aktivitetet e të cilave nuk bien në fushat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, kontribuojnë, sipas rastit, me kërkesën e ministrisë;

e) IGJEUM-i, institutet e tjera kërkimore-shkencore, si dhe universitetet publike ose private, që kryejnë matje, kërkime apo studime për klimën, i vënë këto në dispozicion të ministrisë/AKM-së, duke iu njohur e drejta e autorit sipas legjislacionit në fuqi;

ë) bashkitë, për territorin nën juridiksionin e vet, grumbullojnë, organizojnë dhe mbajnë të dhënat e tyre për klimën së bashku me raportet për masat e marra ose të planifikuara për zbutjen dhe adaptimin e i vendosin këto në dispozicion të ministrisë;

f) ministria, bazuar në dokumentet më të fundit të promovuara nga Konventa dhe në rrethanat specifike social-ekonomike të vendit, harton metodologjitë kombëtare për përgatitjen e komunikimit kombëtar të BUR-it, NDC-së dhe metodologji të tjera, që nevojiten për zbatimin e këtij ligji, me mbështetjen teknike dhe shkencore të institucioneve që parashikohen në këtë nen. Metodologjitë miratohen me udhëzim të ministrit.

2. Fushat e përgjegjësisë shtetërore, të parashikuara në shkronjat "c" dhe "d" të pikës 1 të këtij neni, përfshijnë: industrinë energjetike, industritë prodhuese, të ndërtimit, të lëndëve djegëse, të minierave dhe gjeologjisë, të pyjeve, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura, të bujqësisë e blegtorisë, menaxhimit të ujit, mbetjeve, shëndetit, transportit e infrastrukturës (përfshirë atë rrugore e hekurudhore, portet dhe aeroportet, tubacionet, digat, ujin dhe ujërat e zeza), planifikimin urban, menaxhimin e tokës, turizmin, arsimin, emergjencat civile dhe në menaxhimin e fatkeqësive.

3. Me qëllim bashkërendimin e detyrave të ministrive dhe institucioneve publike/private, në përputhje me detyrimet e vendit ndaj Konventës dhe Marrëveshjes së Parisit, ngrihet dhe funksionon grupi ndërministror i punës (Komiteti Kombëtar për Ndryshimet Klimatike) për ndryshimet klimatike, me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

Neni 24
Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Republika e Shqipërisë merr pjesë në skemën ndërkombëtare të tregtimit të shkarkimeve të GES-it, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, që përshtat mekanizmat ndërkombëtarë të ndryshimeve klimatike dhe udhëzuesit ndërkombëtarë që zbatohen për këtë qëllim.

2. Republika e Shqipërisë merr pjesë në projektet e mekanizmit të zhvillimit të pastër, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, që përshtat mekanizmat ndërkombëtarë të ndryshimeve klimatike dhe udhëzuesit ndërkombëtarë që zbatohen për këtë qëllim.

3. Kontributi Kombëtar i Përcaktuar, sipas nenit 7 të këtij ligji, i komunikohet Konventës deri në fund të vitit të pestë kalendarik pas komunikimit të parë.

4. Dokumenti Strategjik, Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) i komunikohen Konventës në afatet e përcaktuara në vendimet për zbatimin e Marrëveshjes së Parisit.

5. Republika e Shqipërisë përfaqësohet në negociatat ndërkombëtare në kuadër të Konventës dhe integrimit evropian nga ministria, në cilësinë e *focal point* të Konventës dhe institucionit përgjegjës për fushën e ndryshimeve klimatike, në bashkëpunim me ministritë e linjës.

6. Ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji , bashkëpunojnë me komunitetin ndërkombëtar për zbatimin e Konventës dhe inkurajojnë iniciativat dypalëshe e shumëpalëshe, që synojnë shkëmbimin dhe ndarjen e informacionit për eksperiencat që lidhen me

hartimin e politikave e të praktikave të mira ekzistuese, që kontribuojnë për zhvillimin e ekonomive me pak karbon dhe për të mbështetur e përhapur masat që lidhen me klimën.

KREU V
NGRITJA E KAPACITETEVE, EDUKIMI, TRAJNIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT

Neni 25
Ngritja e kapaciteteve

Ministritë e linjës bashkëpunojnë në mënyrë efektive, eficiente, të integruar e të programuar për ngritjen e kapaciteteve të tyre, të bashkive, të institucioneve financiare, të sektorit privat e të organizatave jofitimprurëse (OJF-ve) për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

Neni 26
Edukimi dhe trajnimi

1. Ministria bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për arsimin për hartimin dhe zbatimin e programeve në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike për të gjitha nivelet e arsimit.

2. Ministria bashkëpunon sa herë që i kërkohet nga ministria përgjegjëse për arsimin lidhur me përmbajtjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera didaktike dhe nxit pjesëmarrjen e institucioneve arsimore të të gjitha niveleve në iniciativa për kërkime shkencore, edukim dhe trajnim në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punën bashkëpunojnë për hartimin dhe zbatimin e programeve të edukimit në vazhdim dhe trajnimet në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike.

Neni 27
Informacioni dhe ndërgjegjësimi publik

1. Ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, brenda fushave të kompetencave shtetërore përkatëse ndërmarrin fushata informimi për të sensibilizuar e ndërgjegjësuar popullatën për efektet negative të ndryshimeve klimatike, për masat konkrete që mund të marrin për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në zbatim të kërkesave të këtij ligji dhe objektivave strategjikë të vendit në këtë fushë.

2. Fushatat e ndërgjegjësimit i kushtojnë vëmendje të veçantë rolit dhe përfshirjes së grave në përpjekjet për përshtatjen dhe zbutjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe grupeve në nevojë apo komuniteteve të prekura.

3. Ministria harton udhëzuesin për integrimin e çështjeve gjinore në programet e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

Neni 28
Pjesëmarrja publike

1. Ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, gjatë përgatitjes apo përditësimit të legjislacionit dhe strategjive të tyre në lidhje me klimën, garantojnë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesuar, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore, sektorin privat dhe publikun, sipas përcaktimeve të Konventës së Aarhusit dhe legjislacionit përkatës kombëtar.

2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për mjedisin përcaktohet në akte ligjore të posaçme.

KREU VI
INVESTIMET DHE FINANCIMET E GJELBËRTA

Neni 29
Nxitja e investimeve miqësore ndaj mjedisit/klimës

1. Ministritë e linjës dhe bashkitë, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, hartojnë politika që nxisin sektorin publik dhe privat për investime të konsiderueshme që shkarkojnë pak GES, janë transparente, kanë rezultate të parashikueshme, janë pak të ndikueshme nga ndryshimet klimatike dhe inkurajojnë ndërmarrjet, institucionet, grupet sociale dhe individët për të ndjekur dhe për t'iu përshtatur progresit dhe inovacionit teknologjik, zbatimit të rezultateve të shkencës e teknologjisë, zhvillimit të arsimit dhe industrisë, në zbatim të kërkesave të këtij ligji.

2. Ministritë e linjës dhe bashkitë, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, përditësojnë politikat/dokumentet kombëtare, në mënyrë që të nxisin investimet për projekte miqësore ndaj klimës, mbështesin kërkimin shkencor dhe nxisin praktikën më të mirë në fushat prioritare, si më poshtë:

a) në fushën e prodhimit të energjisë: investimet për energjitë e rinovueshme, shpërndarjen, menaxhimin e shpërndarjes, ruajtjen e energjisë, produktet/teknologjitë që mbështesin sistemet energjetike inteligjente, qendrat e të dhënave për përdorimin e energjive të rinovueshme;

b) në fushën e eficiencës së energjisë: investimet për ndërtesat tregtare të gjelbërta, kreditë për banesa të gjelbërta, teknologjitë dhe produktet me përdorim eficient të energjisë, përmirësimet e teknologjisë;

c) në fushën e transportit: investimet për transportin publik, infrastrukturën për automjete elektrike, skema të qiradhënies së biçikletave, automjete me shkarkime të pakta;

ç) në fushën e ujërave: investimet për përshtatjen ndaj ujërave të shirave/stuhive, investimet për grumbullimin e ujërave të shirave, të trajtimit dhe riciklimit të ujërave, përshtatja e rrugëve ujore; riciklimi i ujërave të përdorura në fermat blegtorale të rritjes dhe mbarështimit të gjedhëve, të imtave dele/dhi, shpendarisë, rritjes dhe mbarështimit të derrave, fabrikat e regjjes dhe përpunimit të lëkurëve;

d) në fushën e menaxhimit të mbetjeve: investimet për kapjen e metanit, shndërrimin e mbetjeve në lëndë djegëse;

dh) në fushën e përdorimit të tokës: investimet për pyjet dhe zinxhirët e furnizimit të qëndrueshëm, bujqësia e qëndrueshme;

e) në fushën e përshtatjes së infrastrukturës: investimet për përshtatjen e infrastrukturës ndaj rritjes së temperaturave, rizhvillimin e porteve për të trajtuar rritjen e nivelit të detit, mbrojtjen nga stuhitë;

ë) në fushën e mbrojtjes së natyrës: praktikat e menaxhimit të përshtatjes për zonat e mbrojtura, vlerësimin e rëndësisë së biodiversitetit në lidhje me kapacitetet e ekosistemeve për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike, duke siguruar, në të njëjtën kohë, nivelin e shërbimeve të ekosistemeve, nga të cilat varet shoqëria njerëzore, vlerësimi dhe analiza e ndikimeve të adaptimit të ndryshimeve klimatike dhe masave zbutëse në biodiversitet.

Neni 30
Transferimi i teknologjive/teknologjitë me pak karbon

1. Ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, dhe autoritetet e tjera kompetente, të përcaktuara në kreun IV të këtij ligji, në fushat e tyre të përgjegjësisë shtetërore:

a) dekurajojnë transferimin e teknologjive të vjetra, inkurajojnë kërkime në shkencë e teknologji, si dhe zhvillimin, transferimin dhe përdorimin e teknologjive, pajisjeve dhe proceseve për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen, me qëllim uljen e vulnerabilitetit ndaj ndryshimeve klimatike, për përmirësimin e performancës mjedisore dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm;

b) inkurajojnë vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, që synon dhënien e ndihmës për transferimin e njohurive teknike, të aftësive teknike e menaxheriale për zhvillimin e institucioneve dhe rrjeteve të nevojshme, për sigurimin e pjesëmarrjes së aktorëve privatë dhe publikë;

c) përshtatin standardet e duhura dhe nxisin marrëveshjet vullnetare ndërmjet trupave dhe organizatave që përfaqësojnë interesa të caktuara, grupe operatorësh e operatorë të veçantë dhe autoritetet përkatëse për të nxitur zhvillimin e teknologjive eficiente.

2. Projektet për kërkim, zhvillim, novacion dhe transferim të teknologjive, sipas pikës 1 të këtij neni, do të jenë në përputhje me prioritetet dhe nevojat e përcaktuara në strategjitë sektoriale të zhvillimit me karbon të ulët, në planin kombëtar për zbutje të GES-it dhe programet për mjedisin e klimën.

Neni 31
Përfshirja e sektorit privat

Për të arritur objektivat e reduktimit të shkarkimeve kombëtare të GES-it, të përcaktuara në NDC, ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, nxisin përfshirjen e sektorit privat dhe partneritetin me të, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon partneritetin publik privat.

Neni 32
Mekanizmat financiarë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për ndryshimet klimatike

1. Të gjitha autoritetet kompetente, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, nxisin zhvillimin e projekteve e të programeve lokale dhe kombëtare, pjesëmarrjen në projekte, programe rajonale dhe ndërkombëtare, që synojnë arritjen e objektivave për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

2. Ministria përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së huaj bashkëpunon me ministrinë dhe ministritë e linjës për të siguruar integrimin e çështjeve të klimës edhe në projekte e programe të tjera, në mënyrë që vendi të përfitojë nga fondet ndërkombëtare respektive.

3. Fondi i mjedisit, sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit, përdoret për të mbështetur zbatimin e masave për zbutje dhe përshtatje, sipas kërkesave të këtij ligji, dhe për të mbështetur prioritetet e dokumenteve politike, kombëtare për ndryshimet klimatike.

4. Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër (CDM) i Protokollit të Kiotos mund të përdoret si një kuadër për zbatimin e aktiviteteve të projekteve që synojnë të zbutin shkarkimet antropogjene në Republikën e Shqipërisë.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton vendimin për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër (CDM) në kuadër të Protokollit të Kiotos.

Neni 33
Fondi i Gjelbër për Klimën (GCF)

1. Fondi i Gjelbër për Klimën (GCF) është një mekanizëm financimi ndërkombëtar, i krijuar nga Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike për të mbështetur investimet për reduktimin e gazeve me efekt serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si një kontribut i rëndësishëm dhe ambicioz për të luftuar ndryshimet klimatike.

2. Qasja ndaj Fondit të Gjelbër së Klimës sigurohet nëpërmjet Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar (NDA), si institucioni ndërmjetës midis Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Gjelbër për Klimën.

3. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar udhëheq procesin e përgatitjes së programit kombëtar për ndryshimet klimatike dhe i komunikon Fondit të Gjelbër për Klimën prioritetet kombëtare për të mundësuar financimin e projekteve për reduktimin e gazeve me efekt serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

4. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (NDA), struktura dhe funksionimi i tij përcaktohen me vendim të Këshilli të Ministrave, me propozimin e ministrit.

KREU VII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34
Kundërvajtjet

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) zhvillimi i një aktiviteti pa leje mjedisi, që përfshin shkarkimet e GES-it sipas kërkesave të nenit 10 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë, duke u shtuar me vlerën 2 për qind të masës së gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërputhjes;

b) mospërmbushja e detyrimit nga cilido operator për monitorimin e shkarkimeve të GES-it dhe raportimin e tyre në AKM, sipas kërkesave të neneve 8, pika 1, dhe 13, pikat 6 e 7, të këtij ligji ose akteve të tij nënligjore, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë, duke u shtuar me vlerën 2 për qind të masës të gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërputhjes;

c) mosnjoftimi në AKM i ndryshimeve të parashikuara në pikën 1 të nenit 12 të këtij ligji, për të cilin mund të nevojitet një përditësim i lejes së mjedisit, që përfshin shkarkimet e GES-it lidhur me shkarkimin e këtyre, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë, duke u shtuar me vlerën 2 për qind të masës të gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërputhjes.

2. Të drejtën e gjobës për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen e ka inspektorati përgjegjës për mjedisin.

3. Subjekti ndaj të cilit vendoset masa administrative ka të drejtën e ankimit te titullari i strukturës përgjegjëse, sipas afateve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi.

4. Gjoba paguhet brenda një periudhe prej 10 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për vënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi.

5. Ministri, me propozimin e inspektoratit përgjegjës për mjedisin, në rastet kur gjoba nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar, vendos pezullimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj deri në pagesën e gjobës, dhe vendimi i pezullimit publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

6. Subjekti ndaj të cilit merret masa e pezullimit ka të drejtën e ankimit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 35
Menaxhimi i informacionit

1. AKM-ja publikon listën e instalimeve të shtojcës II-A, që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ministria përgjegjëse për transportin publikon listën e operatorëve të avionëve/operatorëve të lundrimit, të licencuar prej saj gjatë vitit të mëparshëm kalendarik dhe që kanë kryer aktivitete aviacioni/lundrimi që mbulohen nga ky ligj, brenda datës 1 shkurt të çdo viti në vazhdim dhe e përditëson këtë listë.

3. AKM-ja mban dhe përditëson regjistrin kombëtar të të dhënave, i cili përmban:

a) listën e operatorëve sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni;

b) vendimet dhe raportet për rezultatet e monitorimit, raportimit e verifikimit të shkarkimeve të GES-it nga operatorët që e kanë këtë detyrim;

c) Raportin Kombëtar të Inventarit të GES-it;

ç) komunikimet kombëtare, raportet e përditësuara dyvjeçare, raportin e NDC-së;

d) analizën e efekteve të zbatimit të dokumenteve strategjike për ndryshimet klimatike;

dh) projeksionet e emetimeve antropogjene të gazeve serrë dhe përthithjen e tyre;

e) investimet dhe mbështetjen financiare për ndryshimet klimatike.

4. Regjistri kombëtar i të dhënave është pjesë e sistemit të informacionit mjedisor.

5. Raportet e shkarkimeve të GES-it, që kërkohen nga leja e mjedisit dhe që mbahen nga AKM-ja, bëhen menjëherë të disponueshme për publikun dhe përditësohen rregullisht duke siguruar akses për të gjithë, në përputhje me vendimin nr. 16, datë 4.1.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor".

6. Pjesa e të dhënave të parashikuara në këtë nen, që sipas legjislacionit në fuqi klasifikohen si sekret shtetëror apo janë subjekt i legjislacionit në fuqi për të dhënat personale, profesionale e tregtare, trajtohen sipas atij legjislacioni.

Neni 36
Raportimi

1. AKM-ja përgatit raportin për zbatimin e kërkesave për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES-it, që kërkohen nga ky ligj dhe aktet e tij nënligjore, çdo vit, pas datës së hyrjes në fuqi të rregullores së parashikuar në pikën 2 të nenit 8 të këtij ligji.

2. Raporti i parë përgatitet pas një viti nga data e hyrjes në fuqi të rregullores së parashikuar në pikën 2 të nenit 8 të këtij ligji, sipas formatit të përmbajtjes së raportit të miratuar me urdhër të ministrit.

Neni 37
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që në zbatim të neneve 5, pika 1; 7, pika 5; 8, pika 2; 13, pikat 2, 4 e 8; 14, pika 2; 15, pika 2; 18, pika 4; 19, pika 2; 21, pika 1; 32, pika 5, dhe 33, pika 4, të miratojë aktet nënligjore brenda 4 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që në zbatim neneve 7, pika 4, dhe 27, pika 3, të miratojë aktet nënligjore brenda 4 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për mjedisin të rishikojë vendimin në fuqi për formatin për aplikimin dhe aktin e miratimit për leje mjedisi, sipas përcaktimeve në nenet 10, pika 2, e 11, pika 2, të këtij ligji, dhe ta propozojë atë për miratim në Këshillin e Ministrave brenda 6 muajve nga botimi i këtij ligji në Fletoren Zyrtare.

Neni 38
Akte nënligjore që mbeten në fuqi

1. Vendimi nr. 865, datë 10.12.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara" do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 17 të këtij ligji.

2. Vendimi nr. 762, datë 16.9.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumentit për përcaktimin e kontributit kombëtar të pikësynuar kundrejt arritjes së objektivit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike" do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 23 të këtij ligji.

3. Vendimi nr. 1553, datë 26.11.2008, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të Protokollit të Kiotos" do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të pikës 5 të nenit 32 të këtij ligji.

4.Urdhri nr. 155, datë 25.4.2014, i Kryeministrit, "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike" do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të këtij ligji.

Neni 39
Shfuqizime

Në shtojcën e vendimit nr. 1189, datë 18.11.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit", pika 1 e ndarjes "Ç", "Treguesit mjedisorë të trysnisë në mjedis", shfuqizohet.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11893, datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

SHTOJCA I
GAZET ME EFEKT SERRË, QË REFEROHEN NË NENIN 2, PARAGRAFI 11

1. Dyoksid karboni (CO2)
2. Metan (CH4)
3. Monoksid azoti (N2O)
4. Hegzafluorid i squfurit (SF6)
5. Trifuorid azoti (NF3)
6. Hidrofluorokarbone (HFCs) dhe
— HFC-23 CHF 3
— HFC-32 CH 2 F 2
— HFC-41 CH 3 F
— HFC-125 CHF 2 CF 3
— HFC-134 CHF 2 CHF 2
— HFC-134a CH 2 FCF 3
— HFC-143 CH 2 FCHF 2
— HFC-143a CH 3 CF 3
— HFC-152 CH 2 FCH 2 F
— HFC-152a CH 3 CHF 2
— HFC-161 CH 3 CH 2 F
— HFC-227ea CF 3 CHFCF 3
— HFC-236cb CF 3 CF 2 CH 2 F
— HFC-236ea CF 3 CHFCHF 2
— HFC-236fa CF 3 CH 2 CF 3
— HFC-245fa CHF 2 CH 2 CF 3
— HFC-245ca CH 2 FCF 2 CHF 2
— HFC-365mfc CH 3 CF 2 CH 2 CF 3
— HFC-43-10mee CF 3 CHFCHFCF 2 CF 3 or (C 5 H 2 F 10)
7. Perfluorokarbone (PFCs):
— PFC-14, Perfluoromethane, CF 4
— PFC-116, Perfluoroethane, C 2 F 6
— PFC-218, Perfluoropropane, C 3 F 8
— PFC-318, Perfluorocyclobutane, c-C 4 F 8
— Perfluorocyclopropane c-C 3 F 6
— PFC-3-1-10, Perfluorobutane, C 4 F 10
— PFC-4-1-12, Perfluoropentane, C 5 F 12
— PFC-5-1-14, Perfluorohexane, C 6 F 14
— PFC-9-1-18, C 10 F 18

SHTOJCA II

PJESA A
KATEGORITË E AKTIVITETEVE DHE GES-i QË U NËNSHTROHEN KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI QË PËRFSHIN GES-i

1. Instalimet apo pjesë të tyre, që përdoren për kërkim, zhvillim dhe testim të produkteve dhe proceseve të reja dhe instalimet që përdorin ekskluzivisht biomasën, përjashtohen nga ky ligj.

2. Vlerat-prag, që jepen më poshtë, përgjithësisht u referohen kapaciteteve prodhuese ose vëllimit të prodhimit. Për aktivitetet që bien nën të njëjtën kategori dhe kryhen në të njëjtin instalim, kapacitetet e tyre mblidhen së bashku.

3. Për llogaritjen e inputit termal nominal total të një instalimi ku digjen lëndë djegëse, mblidhen inputet termale nominale të të gjitha njësive teknike që janë pjesë e tij. Këto njësi mund të përfshijnë të gjitha tipat e bojlerëve, të pajisjeve për djegie, turbinave, pajisjeve ngrohëse, furrnaltave/ kaldajave, incineratorëve, kalcinatorëve, furrave të çimentos, furrave të pjekjes, pajisjeve tharëse, motorëve, qelizave të lëndës djegëse, njësive të djegies me fryrje kimike, flakëruesve dhe njësive termale apo katalitike pas djegies. Në këtë llogaritje nuk do të merren në konsideratë njësitë me input nominal termal nën 3 mw dhe njësitë që përdorin ekskluzivisht biomasën. "Njësitë që përdorin ekskluzivisht biomasën" janë njësitë që përdorin lëndë djegëse fosile gjatë ndezjes apo fikjes së njësisë.

4. Kur rezulton se në një instalim që ka një leje mjedisi, kapërcehet pragu i kapacitetit të një aktiviteti që listohet në këtë shtojcë, leja e mjedisit e të gjitha njësive ku digjet lëndë djegëse, përveç njësive për incinerimin e mbetjeve të rrezikshme ose bashkiake, do të ketë edhe kërkesa për shkarkimet e GES-it, sipas nenit 5 të këtij ligji.

Nr.	Aktivitetet	GES	Kodi i aktivitetit (sipas kolonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar*
1.	Djegia e lëndëve djegëse në instalime (përveç instalimeve për incinerimin e mbetjeve të rrezikshme apo bashkiake) me input termal nominal total mbi 20 MË	Dioksid karboni	1.1
2.	Rafinimi i vajrave minerale	Dioksid karboni	1.2 (Rafineritë e gazeve minerare përjashtohen)
3.	Prodhimi i koksit	Dioksid karboni	1.3
4.	Pjekja ose aglomerimi, përfshirë peletizimin, i xeherorëve metalikë, përfshirë xeherorët sulfidë	Dioksid karboni	2.1
5.	Prodhimi gizës ose çelikut (shkrirje primare dhe sekondare) përfshirë derdhjen e vazhdueshme me kapacitet prodhues më të madh se 2,5 ton/orë	Dioksid karboni	2.2
6.	Prodhimi apo përpunimi i metaleve ferroze, përfshirë aliazhet e tyre, me njësi djegieje që operojnë me *input* termal nominal total mbi 20 MW. Përpunimi i metaleve ferrozë përfshin mullinjtë me rula, ngrohësit e ndërmjetëm, furrnaltat, kovaçanat, fonderitë, veshjen me metal të shkrirë dhe fiksimin e ngjyrës/elektrolitik	Dioksid karboni	2.3 2.5.a 2.6
7.	Prodhimi i aluminit primar	Dioksid karboni dhe perfluorokarbone	2.4
8.	Prodhimi i aluminit sekondar me njësi djegieje që operojnë me *input* termal nominal total mbi 20 MW. (ID 2.4)	Dioksid karboni	2.4
9.	Prodhimi apo përpunimi i metaleve joferroze, përfshirë prodhimin e aliazheve, rafinimin, derdhjen në fonderi etj., me njësi djegie që operojnë me input termal nominal total mbi 20 MW (përfshirë lëndët djegëse që përdoren si agjentë reduktues)	Dioksid karboni	2.5.b
10.	Prodhimi i klinkerit të çimentos në furra rrotulluese me kapacitet prodhues mbi 500 tonë/ditë ose në furrnalta të tjera me kapacitet prodhues mbi 50 tonë/ditë	Dioksid karboni	3.1
11.	Prodhimi i gëlqeres ose kalcinimi i dolomiteve apo magnezitit në furra rrotulluese apo në furrnalta të tjera me kapacitet prodhues mbi 50 tonë/ditë	Dioksid karboni	3.1
12.	Prodhimi i qelqit dhe fibrave të qelqit me kapacitet shkrirje mbi 20 tonë/ditë	Dioksid karboni	3.3
13.	Prodhimi i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit me kapacitet prodhues mbi 75 tonë/ditë (ID 3.5)	Dioksid karboni	3.5
14.	Prodhimi i materialeve izoluese me bazë leshi mineral, duke përdorur qelq, gurë apo skorje me kapacitet	Dioksid karboni	*Vendoset rast pas rasti në varësi të instalimit*

	shkrirje e mbi 20 tonë/ditë		
15.	Tharja ose kalcinimi i gipsit apo prodhimi i fletëve/ pllakave/paneleve prej gipsi dhe produkteve të tjera prej gipsi, me njësi djegie që operojnë me input termal nominal total mbi 20 MW	Dioksid karboni	*Vendoset rast pas rasti në varësi të instalimit*
16.	Prodhimi i pulpës nga trungjet e drurit dhe materiale të tjera fibroze	Dioksid karboni	7.1.a
17.	Prodhimi i letrës dhe/ose i kartonit me kapacitet prodhues mbi 20 tonë/ ditë	Dioksid karboni	7.1.b
18.	Prodhimi i katranit nga karbonizimi i substancave, të tilla si vajra, zift, fishekzjarrë, pajisje krekingu dhe mbetje distilimi, me njësi djegie që operojnë me input termal nominal total mbi 20 MW	Dioksid karboni	7.3
19.	Prodhimi i acidit nitrik	Dioksid karboni dhe oksid azoti	4.2
20.	Prodhimi i acidit adipik	Dioksid karboni dhe oksid azoti	4.2
21.	Prodhimi i acidit glioksal dhe glioksilik	Dioksid karboni dhe oksid azoti	4.2
22.	Prodhimi i amoniakut	Dioksid karboni	4.2
23.	Prodhimi i shumicës së kimikateve organike përmes krekingut, reformimit, oksidimit të pjesshëm apo të plotë apo proceseve të ngjashme, me kapacitet prodhues mbi 100 tonë/ ditë	Dioksid karboni	4.1
24.	Prodhimi i hidrogjenit (H_2) dhe gazit të sintezës përmes reformimit apo oksidimit të pjesshëm me kapacitet prodhues mbi 25 tonë/ ditë	Dioksid karboni	4.2
25.	Prodhimi i hirit të sodës (Na_2CO_3) dhe bikarbonatit të sodës ($NaHCO_3$) (ID 4)	Dioksid karboni	4.2
26.	Kapja e rrymave të GES-it nga instalimet që mbulohen nga ky ligj për qëllime të transportimit dhe depozitimit gjeologjik në një vend depozitimi për të cilën AKM-ja ka lëshuar një leje mjedisi	Dioksid karboni	12.4
27.	Transportimi i GES-it përmes tubacioneve për depozitimin gjeologjike në një vend depozitimi për të cilën AKM-ja ka lëshuar një leje mjedisi	Dioksid karboni	12.4
28.	Depozitimi gjeologjik i GES-it në një vend depozitimi për të cilën AKM-ja ka lëshuar një leje mjedisi	Dioksid karboni	12.4

**Në raste të veçanta, për aplikim për leje mjedisi që përmban edhe kushte për GES-in, operatori mund t'i referohet edhe ndonjë kodi tjetër referuar kolonës 1 të shtojcës 1 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar, i cili nuk është përmendur në tabelën e mësipërme.*

PJESA B
LISTA E AKTIVITETEVE TË AVIACIONIT QË PËRJASHTOHEN NGA KY LIGJ, REFERUAR NENIT 13, PIKA 6

a) fluturimet që kryhen ekskluzivisht për transportin për misione zyrtare të një monarku në fuqi dhe familjes së ngushtë të tij, të kryetarëve të shteteve dhe ministrave të vendeve që nuk janë anëtarë të BE-së, kur një gjë e tillë është treguar në planin e fluturimit; b) fluturimet ushtarake që kryhen nga avionë ushtarakë dhe fluturimet e autoriteteve të doganave dhe të policisë; c) fluturimet për misione kërkimi dhe shpëtimi, për shuarje zjarresh, për ndihma humanitare dhe shërbime shëndetësore emergjente të autorizuara nga autoritetet kompetente përkatëse; ç) çdo fluturim që kryhet ekskluzivisht sipas rregullave të shikueshmërisë së fluturimit, sipas përcaktimit të bërë në shtojcën 2 të Konventës së Çikagos; d) fluturimet që përfundojnë në aerodromin e nisjes pa bërë asnjë ulje të ndërmjetme; dh) fluturimet për trajnim që kryhen ekskluzivisht për marrjen e licencës apo për vlerësim në rastin e ekuipazhit të fluturimit, kur kjo është përcaktuar me shënimin e duhur në planin e fluturimit, me kusht që ai fluturim të mos shërbejë për transportin e pasagjerëve dhe/ose kargove, apo për pozicionimin, apo transportimin e avionit; e) fluturimet që kryhen ekskluzivisht për qëllime të kërkimit shkencor apo për kontrollimin, testimin apo certifikimin e avionit apo pajisjeve qoftë në ajër apo në tokë; ë) fluturimet që kryhen nga një avion që ka masë maksimale ngritje të certifikuar prej më pak se 5,700 kg; f) fluturimet që kryhen mbi rrugët ajrore, kur kapaciteti i ofruar nuk është më i madh se 30 000 vende në	Dyoksid karboni

vit; g) fluturimet që, përveçse në këtë rast, do të binin në aktivitetin e kryer nga një operator tregtar transporti ajror që operon ose: - më pak se 243 fluturime në periudhë, për 3 periudha katërmujore konsekutive, - fluturimet me shkarkime totale vjetore më të ulëta se 10 000 tonë në vit. gj) fluturimet që kryhen ekskluzivisht për transportin, për misione zyrtare të një monarku në fuqi dhe familjes së ngushtë të tij, të kryetarëve të shteteve dhe ministrave të vendeve që nuk janë anëtare të BE-së, mund të mos përjashtohen sipas kësaj pike; h) fluturimet që, me përjashtim të kësaj pike, do të binin në këtë aktivitet, që kryhet nga një operator jotregtar avioni, që operon fluturime me shkarkime totale vjetore më të ulëta se 1 000 tonë në vit.	

SHTOJCA III-A
LISTA JOSHTERUESE E ÇËSHTJEVE QË DUHEN TRAJTUAR NË DOKUMENTIN STRATEGJIK PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Dokumenti Strategjik për Ndryshimet Klimatike do të përmbajë komponentët në vijim:

1. Pasqyrë të zhvillimit kombëtar dhe politika të ndryshimit të klimës.

2. Kuadri ligjor dhe institucional për zbatimin.

3. Objektivat dhe synimet e përgjithshme të strategjisë:

a) vlerësimi i ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe (dobësive) vulnerabilitetin, me synim formulimin e veprimeve prioritare;

b) zhvillimi i një strategjie afatgjatë për uljen e emetimit të gazit serrë në paragrafin 19, neni 4 i Marrëveshjes së Parisit;

c) plani i mitigimit;

ç) plani i përshtatjes;

d) plani i menaxhimit të riskut;

dh) burimet financiare;

e) ndërtim kapacitetesh;

ë) burimet financiare;

f) edukimi, trajnimi, ndërgjegjësimi.

4. Plani i mitigimit dhe plani i përshtatjes, parashikuar në paragrafin 3, shkronjat "c" dhe "ç" përkatësisht, duhet të përmbajë komponentët e mëposhtëm, sipas rastit:

a) përmbledhje:

aa) përshkrimi i objektivave dhe masave zbutëse ose adaptuese;

ab) përshtatja me planet kombëtare të zhvillimit, si dhe me qëllimet mbi mitigimin sektorial dhe adaptimin;

ac) përshkrimi i nismave dhe sinergjive ekzistuese mbi mitigimin ose adaptimin lehtësues ose përshtatjes.

b) përfitimet:

ba) përshkrimi i përfitimeve në aspektin e zhvillimit (ekonomik, social dhe mjedisor);

bb) kosto-efektivitet në arritjen e përfitimeve kombëtare.

c) ndikimet nga emetimi i gazit serrë:

ca) përshkrimi i skenarit *"business as usual"* (në tekstin e mëtejmë: BAU);

cb) përshkrimin e ndikimeve të vlerësuara mbi devijimin e emetimit të gazit serrë nga BAU;

cc) përshkrimin e impaktit transformues pas zbatimit;

cd) kosto-efektivitet në arritjen e ndikimeve të emetimit të gazit serrë.

ç) planveprimi:

ça) përshkrimi i aktiviteteve të detajuara për zbatimin e masave mitiguese ose adaptuese të përfshira në plan;

çb) plani i punës për aktivitetet e detajuara;

çc) plani për përfshirjen e palëve të interesuara, duke përfshirë edhe rolin e tyre në zbatimin e aktiviteteve dhe marrëveshjet institucionale.

d) monitorimi dhe matja e progresit:

da) përshkrimi i parametrave kryesorë për të vlerësuar progresin e zbatimit të planit;

db) përshkrimi i parametrave kryesorë për të vlerësuar përfitimet kombëtare dhe ndikimet e emetimit të gazit serrë;

dc) përshkrimi i metodologjisë për të vlerësuar ndikimet e emetimit të gazit serrë, si dhe marrëveshjet për matjen dhe raportimin.

5. Plani i menaxhimit të riskut i parashikuar në paragrafin 3, shkronja "d", duhet të përmbajë komponentët në vijim:

a) vlerësimin gjithëpërfshirës të humbjes ekonomike dhe joekonomike dhe dëmeve të lidhura me ndryshimin e klimës, duke përfshirë edhe ato të shkaktuar nga situatat emergjente, si dhe ato ngjarje me fillim të ngadalshëm *(as sell as slow onset events)*;

b) planin e veprimit për menaxhimin e riskut, duke përfshirë sistemet e paralajmërimit të hershëm, gatishmërisë emergjente dhe masave që synojnë përmirësimin e qëndrueshmërisë së komuniteteve, jetesën dhe ekosistemet;

c) masat e menaxhimit të riskut financiar, duke përfshirë edhe lehtësirat e sigurimit të riskut, bashkimit të risqeve të klimës *(climate risk pooling)* ose zgjidhje të tjera të sigurimit.

SHTOJCA III-B
LISTA JOSHTERUESE E ÇËSHTJEVE QË DUHEN TRAJTUAR NË DOKUMENTET STRATEGJIKE SEKTORIALE QË REFEROHEN NË NENIN 5

1. Përshkrimin e kontekstit socio-ekonomik, demografik dhe gjeografik për zhvillime me pak karbon.

2. Vlerësimin e shkarkimeve ekzistuese të GES-it, sipas sektorëve dhe shkarkimet e pritshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

3. Vlerësimin e opsioneve teknologjike në sektorë prioritarë.

4. Analizën e mundësive të zbatimit të opsioneve për zhvillime me pak karbon në sektorë të rëndësishëm.

5. Zgjedhjen e opsioneve të duhura për t'u zbatuar në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, në mënyrë që të plotësohen objektivat e përcaktuar në NDC, të referuara në nenin 5.

6. Koordinimin dhe sinergjinë me marrëveshje mjedisore ndërkombëtare/shumëpalëshe, proceset dhe mundësitë për financim.

DEKRET
Nr. 11893, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 156/2020

PËR FALJEN E DETYRIMEVE TË USHTARAKËVE NDAJ FONDIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, TË KRIJUARA SI DIFERENCË NGA RISHQYRTIMI I PENSIONEVE TË PARAKOHSHME PËR VJETËRSI SHËRBIMI, TË CAKTUARA SIPAS VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË, BAZUAR NË KRITERET E VENDIMIT UNIFIKUES TË KOLEGJEVE TË BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË NR. 3, DATË 24.11.2016

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Falen detyrimet e ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar në kriteret e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.11.2016.

2. Shumat e detyrimeve, të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni, falen sipas gjendjes së mbetur në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2

Instituti i Sigurimeve Shoqërore të ndjekë procedurat administrative e ligjore për tërheqjen e rekurseve/ankimeve pranë gjykatave përkatëse, me objekt zbatimin e nenit 1 të këtij ligji.

Neni 3

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.

Shpallur me dekretin nr.11894, datë 5.1.2021 , të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11894, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 156/2020, "Për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga shqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar në kriteret e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.11.2016".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 157/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI HUAMARRËS, BANKËS SË SHQIPËRISË, SI AGJENT PËR HUAMARRËSIN, DHE BASHKIMIT EVROPIAN, SI HUADHËNËS, PËR NDIHMËN MAKROFINANCIARE PËR SHQIPËRINË

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent për huamarrësin, dhe Bashkimit Evropian, si huadhënës, për ndihmën makrofinanciare për Shqipërinë, në shumën prej 180 000 000 (njëqind e tetëdhjetë milionë) eurosh, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11895, datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

NDIHMË MAKROFINANCIARE PËR SHQIPËRINË
MARRËVESHJE E SHUMËS SË HUAS NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN, SI HUADHËNËS, DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI HUAMARRËS, DHE BANKËS SË SHQIPËRISË, SI AGJENT PËR HUAMARRËSIN
2020

Kjo Marrëveshje e Shumës së Huas është lidhur nga dhe ndërmjet Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si Huadhënës, dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, si Huamarrës, dhe Bankës së Shqipërisë, duke vepruar si agjent për Huamarrësin, të përfaqësuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, të referuar bashkërisht si "Palët" dhe secili si "Palë".

PREAMBULË

Duke pasur parasysh se:

1. Në prill 2020, Republika e Shqipërisë kërkoi ndihmë makrofinanciare nga Bashkimi Evropian në kontekstin e pandemisë COVID-19;

2. Parlamenti Evropian dhe Këshilli, në bazë të vendimit (BE) 2020/701 të 25 maj 2020, që ofron ndihmë makrofinanciare për zgjerimin dhe vendet fqinje, në kontekstin e pandemisë[2] COVID-19, vendosi të ofronte ndihmë makrofinanciare për Republikën e Shqipërisë në një shumë maksimale prej 180 milionë eurosh në formën e huave;

3. Ndihma makrofinanciare është dhënë në lidhje me ndihmën nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, e cila, në muajin prill të vitit 2020, miratoi një Instrument Financimi të Shpejtë (RFI) për Republikën e Shqipërisë prej 174 milionë eurosh;

4. Kushtet e politikave ekonomike që do të përmbushen, nëse Republika e Shqipërisë do të ketë të drejtë për përfitimin e shumës, janë përcaktuar në memorandumin e mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë në ose rreth datës së kësaj marrëveshjeje dhe në vijim të memorandumeve të mirëkuptimit (plotësuese), nëse ka;

5. Kështet e huas do të financohen nga Komisioni Evropian për tregun e kapitalit. Komisioni do të lançojë, në kohën e duhur, në emër të BE-së dhe pas marrjes së kërkesës me shkrim nga Huamarrësi që përcakton kushtet kryesore të një kësti, siç përcaktohet më pas, çështje të obligacioneve ose të transaksione të tjera të përshtatshme financiare për financim, të ardhurat e të cilave do të jepen hua për Huamarrësin;

6. Masat e duhura të lidhura me parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit, korrupsionit dhe parregullsi të tjera që cenojnë huan, parashikohen nga autoritetet e Huamarrësit.

Si rrjedhojë, aktualisht, Palët e kësaj Marrëveshjeje kanë rënë dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIMET

Në këtë Marrëveshje (duke përfshirë pikat e saj), termat e mëposhtëm kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. "Marrëveshje" nënkupton këtë Marrëveshje të Shumës së Huas.

2. "Periudhë disponibiliteti" nënkupton periudhën 12-mujore, që fillon në ditën e parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. "Huamarrës" nënkupton Republikën e Shqipërisë.

4. "Kontratë huamarrjeje" nënkupton një marrëveshje që Huadhënësi lidh për financimin e një kësti. Kushtet e një kësti janë të njëjta si ato të përcaktuara në kontratën korresponduese të huamarrjes, me kusht që këto kushte të jenë të pajtueshme me ato të përcaktuara në kërkesën përkatëse për fonde.

5. "Ditë pune" nënkupton një ditë në të cilën sistemi i pagesës TARGET[2] është i hapur për biznes.

6. "Komision" nënkupton Komisionin Evropian.

7. "Njoftim konfirmimi" nënkupton njoftimin me shkrim të Huadhënësit ndaj Huamarrësit në formën e aneksit 2, që përcakton kushte përfundimtare të një kësti.

8. "Vendime" nënkupton vendimin (BE) 2020/701, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 25 maj 2020, që ofron ndihmë makrofinanciare për zgjerimin dhe vendet fqinje në kontekstin e pandemisë COVID-19.

9. "Datë disbursimi" nënkupton, në lidhje me ndonjë këst, datën e transferimit të shumës neto të disbursimit në llogarinë e Huamarrësit me Bankën e Shqipërisë.

10. "Datë e pagesës" nënkupton çdo ditë në të cilën një pagesë nga Huamarrësi ndaj Huadhënësit është e kërkueshme, sipas kësaj Marrëveshjeje.

11. "Rast i mospërmbushjes së detyrimeve" nënkupton një rast të përcaktuar në klauzolën 9(1).

12. "BE" nënkupton Bashkimin Evropian.

13. "Borxh i jashtëm" nënkupton të gjithë borxhin e Huamarrësit: i. që emërtohet ose është i pagueshëm në një monedhë të ndryshme nga monedha e ligjshme e Huamarrësit; dhe ii. që nuk është shkaktuar ose ndërmarrë fillimisht sipas një marrëveshjeje ose instrumenti të realizuar me ose të lëshuar kreditorëve, kryesisht të gjithë prej të cilëve janë rezidentë të [shënoni shtetin] ose subjekte me seli qendrore ose vend kryesor biznesi brenda territorit të Shqipërisë.

14. "Shumë" nënkupton shumën e kësteve që Huadhënësi vë në dispozicion të Huamarrësit në një shumë totale të përgjithshme principali deri në 180 milionë euro, sipas kësaj Marrëveshjeje.

[2] OJ I. 165, 27.5.2020, p. 31.

15. "Transaksion financiar" nënkupton një emetim bondi ose transaksion tjetër të përshtatshëm financiar për financimin e shumës së një Kësti.

16. "FMN" nënkupton Fondin Monetar Ndërkombëtar.

17. "Masë e FMN-së" nënkupton çdo marrëveshje, program, shumë ose masë tjetër financiare ndërmjet Huamarrësit dhe FMN-së.

18. "Këst" nënkupton një pjesë të Huas sipas klauzolës 2(2).

19. "Periudhë interesi" nënkupton, në lidhje me ndonjë këst, periudhën e parë të interesit dhe çdo periudhë të njëpasnjëshme dymbëdhjetëmujore më pas deri në datën e maturimit.

20. "Normë interesi" nënkupton normën vjetore të interesit që zbatohet për këstin gjatë një periudhe interesi.

21. "Huadhënës" nënkupton Bashkimin Evropian.

22. "Hua" nënkupton bashkërisht të gjitha disbursimet e kryera ose që do të kryhen për Huamarrësin, sipas shumës ose shumës së totalit të përgjithshëm të principalit të saj të papaguar.

23. "Datë maturimi" nënkupton datën e planifikuar për shlyerjen e plotë të principalit të një kësti që përcaktohet në një njoftim konfirmimi.

24. "MM" nënkupton memorandumin e mirëkuptimit të nënshkruar në ose rreth datës së kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, memorandume të mëtejshme (plotësuese) mirëkuptimi ose çdo shtojcë e tyre.

25. "Shumë neto disbursimi" nënkupton të ardhurat e transaksionit financiar minus shumën totale të përgjithshme të komisioneve, tarifave dhe kostove të lidhura me këtë transaksion financiar dhe përgatitjen dhe ekzekutimin e tij, siç përmendet në klauzolën 6(4), në lidhje me ndonjë instalim.

26. "Kërkesë për fonde" nënkupton kërkesën e Huamarrësit për fonde në formën e aneksit 1, e cila pranon në mënyrë të parevokueshme kushtet kryesore të përcaktuara në këtë mënyrë, sipas klauzolës 4(2).

2. SHUMA E HUAS

1. Huadhënësi vë në dispozicion të Huamarrësit një shumë huaje në euro, në një shumë totali të përgjithshëm deri në 180 milionë euro, në bazë të termave dhe kushteve të MM-së dhe të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shuma disbursohet në dy këste të barabarta. Disbursimi i këstit të dytë nuk duhet të zhvillohet më herët se sa tre muaj pas çlirimit të këstit të mëparshëm.

3. Huamarrësi përdor të gjitha shumat e huamarrjes, sipas shumës në pajtim me detyrimet e tij sipas MM-së.

4. Banka e Shqipërisë vepron si agjenti financiar i Huamarrësit dhe nuk është përgjegjëse për detyrimet financiare të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. MATURITETI

Maturiteti mesatar i Huas nuk tejkalon 15 vjet.

4. TRANSFERIMI I FONDEVE, KUSHTET PARARENDËSE DHE DISBURSIMI

1. Në bazë të termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe të MM-së, pas konsultimit me Huadhënësin, Huamarrësi mund të kërkojë disbursimin e një kësti huaje, me anë të dorëzimit ndaj Huadhënësit të një kërkese për fonde të plotësuar sipas rregullave. Huamarrësi është i detyruar, në mënyrë të parevokueshme, sipas kushteve të kërkesës për fonde, me përjashtim kur Huadhënësi ka dërguar një njoftim që përcakton se BE-ja nuk mund të lidhë transaksionin financiar sipas kushteve të përcaktuara në kërkesën përkatëse për fonde. Huadhënësi ka dërguar një njoftim që përcakton se BE-ja nuk mund të lidhë transaksionin financiar, sipas kushteve të caktuara në kërkesën përkatëse për fonde.

2. Një kërkesë për fonde nuk do të konsiderohet se është plotësuar sipas rregullave, nëse nuk specifikon të paktën informacionin e përcaktuar në aneksin 1.

3. Në vijim të paraqitjes së një kërkese për fonde nga Huamarrësi, në lidhje me një këst, detyrimi i Huadhënësit për të paguar shumën neto të disbursimit ndaj Huamarrësit, sipas kësaj Marrëveshjeje, i nënshtrohet:

a) asnjë rast që ka ndodhur që do ta bënte të pasaktë ndonjë deklaratë të bërë në opinionin ligjor të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë e Huamarrësit në formën e përcaktuar në aneksin 4;

b) Huamarrësit, pas marrjes nga ministri i Financave dhe Ekonomisë të Huamarrësit të një dokumenti zyrtar që përcakton personat e autorizuar për të nënshkruar kërkesat për fonde (dhe në këtë mënyrë angazhon Huamarrësin në mënyrë të vlefshme) dhe që përmban modelet e nënshkrimeve të këtyre personave;

c) Huamarrësit, pas marrjes nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, para kështit të parë, të një dokumenti zyrtar, që identifikon: i. llogarinë në euro të Bankës së Shqipërisë tek e cila Huadhënësi do të transferojë shumën neto të disbursimit të një kësti në datën e disbursimit dhe ii. llogarinë e Shërbimit të Thesarit të Shtetit të mbajtur në Bankën e Shqipërisë, tek e cila Huamarrësi do të transferojë shumën neto të disbursimit;

d) Huadhënësit, pas miratimit të një vendimi çlirimi/kalimi në lidhje me këstin që konfirmon pajtueshmërinë nga Huamarrësi të kushteve të MM-së;

e) Huadhënësit nga njëra anë dhe një banke ose sindikate bankash nga ana tjetër, që kanë nënshkruar kontrata huamarrjeje mbi bazën e një vendimi huamarrjeje komisioni dhe pas marrjes në datën e disbursimit të të ardhurave neto të transaksionit financiar nga banka ose sindikata e bankave;

f) asnjë ndryshim negativ material i ndodhur që prej datës së kësaj Marrëveshjeje, që sipas mendimit të Huadhënësit, pas konsultimit me Huamarrësin, mund të cenojë materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij të pagesës, sipas kësaj Marrëveshjeje, specifikisht për dërgimin e ndonjë prej kësteve që do të financohen dhe shlyerjen e tyre; dhe

h)asnjë rast i mospërmbushjes së detyrimeve që ka ndodhur, i cili nuk është korrigjuar sipas kërkesave të Huadhënësit.

4. Në bazë të kushteve të mësipërme, me diskrecionin e tij të vetëm, Huadhënësi duhet të ndërmarrë emetimin e një obligacioni ose çdo transaksion tjetër të përshtatshëm financiar për financimin e shumës së një kësti.

5. Pas lidhjes së transaksionit financiar, Huadhënësi i lëshon Huamarrësit një njoftim konfirmimi, që përcakton kushtet përfundimtare financiare të Kështit. Huamarrësi konsiderohet të ketë pranuar paraprakisht kushtet e kështit të përcaktuara në njoftimin e konfirmimit, me kusht që këto kushte të jenë të pajtueshme me kushtet e përcaktuara nga Huamarrësi në Kërkesën e zbatueshme për Fonde. Për shmangien e dyshimit, Huadhënësi nuk ka asnjë detyrim për të shqyrtuar në mënyrë të favorshme ndonjë kërkesë eventuale nga Huamarrësi në çdo kohë, për të ndryshuar ndonjë prej kushteve financiare të një kësti.

6. Huadhënësi transferon shumën neto të disbursimit të një kësti në datën e disbursimit në llogarinë në euro të Bankës së Shqipërisë të njoftuar sipas klauzolës 4(3)(c).

7. Disbursimi i një kësti nuk angazhon në asnjë rrethanë, ndonjë prej Palëve për të vijuar me huadhënien dhe huamarrjen e kësteve të mëtejshme.

8. E drejta e Huamarrësit për marrjen e kësteve, sipas kësaj Marrëveshjeje, mbaron në fund të periudhës së disponibilitetit, pas së cilës çdo shumë e padisbursuar e shumës do të konsiderohet menjëherë e anuluar, me përjashtim të ndonjë kësti për të cilin komisioni ka miratuar një vendim çlirimi/kalimi dhe një vendim huamarrjeje para asaj date dhe për të cilat disbursimi kryhet më pas.

5. PËRFAQËSIMET, GARANCITË DHE SIPËRMARRJET

1. Përfaqësimet

Huamarrësi përfaqëson dhe i garanton Huadhënësit në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe në secilën datë disbursimi, se:

a) secili këst përbën një detyrim të pasiguruar, të drejtpërdrejtë, të pakushtëzuar, të pavarur dhe të përgjithshëm të Huamarrësit dhe do të klasifikohet të paktën *pari passu* me të gjitha huat dhe detyrime aktuale dhe të ardhshme të tjera të pasiguruara, dhe të pavarura të Huamarrësit, që lindin nga borxhi i tij aktual ose i ardhshëm, megjithatë me kusht që Huamarrësi të mos ketë asnjë detyrim për të kryer pagesë: a) të barabartë/a ose proporcionale në çdo kohë, në lidhje me ndonjë borxh tjetër të jashtëm të tillë dhe, në veçanti, nuk duhet të ketë asnjë detyrim për të paguar ndonjë borxh tjetër të jashtëm në të njëjtën kohë ose si kusht i pagimit të shumave të kërkueshme për Huan dhe anasjelltas; dhe

b) opinioni ligjor i Ministrisë së Drejtësisë, i dhënë në pajtim me aneksin 4, është i saktë dhe i duhur.

2. Sipërmarrjet

Huamarrësi ndërmerr deri në kohën që i gjithë principali, sipas kësaj Marrëveshjeje, të jetë rimbursuar plotësisht dhe i gjithë interesi dhe shumat shtesë, nëse ka, të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, të jenë paguar plotësisht:

a) të shfrytëzojë shumën neto të disbursimit të secilit këst në pajtim me vendimet dhe me MM-në, të zbatueshme në kohën e lëshimit të kërkesës për fonde për këstin;

b) të marrë dhe mbajë në fuqi dhe efekt të plotë të gjitha autorizimet e nevojshme që të përmbushë detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) të respektojë në të gjitha aspektet, ligjet e zbatueshme që mund të cenojnë aftësinë e tij për të realizuar këtë Marrëveshje;

d) të paguajë tarifa, kosto dhe shpenzime, duke përfshirë nëse është e zbatueshme, kostot e penalitetit të paragimit dhe koston e pozicionit të investimit, që rezultojnë nga ndonjë transaksion financiar, që Huadhënësi mund të ketë ndërmarrë sipas kësaj Marrëveshjeje në vijim të marrjes së një kërkese për fonde, pavarësisht nëse disbursimi i kështit do të zhvillohet përfundimisht;

e) në lidhje me borxhin e jashtëm, për të pranuar që Huadhënësi duhet të ketë zotësi identike juridike, imunitete dhe privilegje, siç u jepen institucioneve financiare ndërkombëtare.

f) me përjashtim të atyre barrëve të renditura në nënparagrafët 1 deri 7 më poshtë:

i. jo për të siguruar me hipotekë, peng ose ndonjë barrë tjetër ndaj aseteve ose të ardhurave të veta, ndonjë borxh aktual ose të ardhshëm të jashtëm dhe çdo garanci ose dëmshpërblim të dhënë në lidhje me të, nëse Huaja në të njëjtën kohë nuk ndan *pari passu* dhe *pro rata* në këtë letër me vlerë; dhe

ii. jo për t'i dhënë ndonjë kreditori ose mbajtësi tjetër të borxhit të vet sovran, prioritet ndaj Huadhënësit.

Dhënia e barrëve të mëposhtme nuk përbën shkelje të kësaj klauzole:

1. Barra ndaj pronës, të shkaktuara për të siguruar financim për çmimin e blerjes ose ndërtimin e kësaj prone dhe çdo rinovim ose zgjerim të një barre të tillë, që kufizohet te prona fillestare e mbuluar në këtë mënyrë dhe që siguron çdo rinovim ose zgjerim të financimit të siguruar fillestar; dhe

2. Barra për mallra tregtare, që lindin gjatë transaksioneve të zakonshme tregtare (dhe që skadojnë maksimumi brenda një viti më pas), për të financuar importin ose eksportin e këtyre mallrave në ose nga shteti i Huamarrësit; dhe

3. Barra që sigurojnë ose parashikojnë pagesën e borxhit të jashtëm të shkaktuar ekskluzivisht, me qëllim ofrimin e financimit për një projektinvestimi specifik, me kusht që pronat për të cilat zbatohen këto barra, të jenë prona që i nënshtrohen një financimi projekti të tillë ose që të jenë të ardhura ose detyrime të lindura nga projekti; dhe

4. Barra të tjera që ekzistojnë në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që këto barra të kufizohen te pronat aktualisht të cenuara në këtë mënyrë dhe pronat që cenohen nga këto barra, sipas kontratave në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë, për shmangien e dyshimit, kristalizimin e ndonjë tarife të luhatshme që është regjistruar në datën e kësaj Marrëveshjeje) dhe, me kusht që, më tej, këto barra të sigurojnë ose të parashikojnë pagesën e vetëm atyre detyrimeve të siguruara ose të parashikuara në këtë mënyrë në datën e tyre ose ndonjë rifinancim të këtyre detyrimeve; dhe

5. Të gjitha barrët dhe privilegjet e tjera statutore, që funksionojnë vetëm në bazë të ligjit dhe, që në mënyrë të arsyeshme, nuk mund të shmangen nga Huamarrësi; dhe

6. Çdo barrë që siguron detyrimet e Huamarrësit me depozituesin qendror të letrave me vlerë të tillë si *Euroclear*, të dhënë në rrjedhën normale të biznesit; dhe

7. Çdo barrë që siguron një borxh prej më pak se 3 milionë eurosh, me kusht që shuma maksimale totale e përgjithshme e borxhit të siguruar nga këto barra, nuk tejkalon 50 milionë euro.

Siç përdoret në këtë klauzolë, "financimi për një projektinvestimi specifik" nënkupton çdo financim të blerjes, ndërtimit ose zhvillimit/ndërtimit të pronave, në lidhje me një projekt, nëse subjekti ofrues për këtë financim bie dakord shprehimisht që të kujdeset për pronat e financuara dhe të ardhurat që do të gjenerohen nga operimi ose humbja ose dëmtimi i këtyre pronave, si burimin kryesor të shlyerjes për shumat financiare të parapaguara.

6. INTERESI, KOSTOT DHE SHPENZIMET

1. Në lidhje me çdo këst të papaguar, Huamarrësi do të transferojë në llogarinë e përmendur në klauzolën 8(3), në secilën datë të kërkueshme të pagesës, shumën e interesit, që deri në fund të një periudhe interesi, do të jetë shtuar mbi shumën e principalit të papaguar të atij kësti dhe një shumë e tillë aplikohet për shlyerjen e interesit të kërkueshëm, sipas këtij kësti, në lidhje me një periudhë të tillë interesi në datën e kërkueshme të pagesës. Norma e interesit dhe data e kërkueshme të pagesës për secilin këst do t'i

komunikohen Huamarrësit në njoftimin e konfirmimit për atë këst.

2. Norma e interesit, periudha e interesit dhe datat e kërkueshme të interesit për pagesën e interesit janë të njëjta si ato të përcaktuara në kontratat korresponduese të Huamarrjes.

3. Pa cenuar kushtet e klauzolës 9, nëse Huamarrësi nuk mund të paguajë ndonjë shumë të pagueshme, sipas kësaj Marrëveshjeje në datën e saj të kërkueshme të pagesës, Huamarrësi do të paguajë përveç interesit të kamatëvonesës mbi këtë shumë (ose sipas rastit, shumën e saj për kohën që është e kërkueshme dhe e papaguar) për Huadhënësin nga data e kërkueshme e pagesës deri në datën e pagesës aktuale, të plotë, të llogaritur, duke iu referuar periudhave të mëpasshme të interesit (secila me atë kohëzgjatje që Huadhënësi mund të përzgjedhë herë pas here, ku periudha e parë fillon në datën përkatëse të Kërkueshme të pagesës dhe sa herë që është e mundur, kohëzgjatja e kësaj periudhe duhet të jetë ajo e një jave) mbi këtë shumë të vonuar në nivelin më të lartë të:

a) një norme vjetore që është totali i përgjithshëm i:

i. 200 pikëve bazë; dhe

ii. normës së *Euribor*-it periudhën përkatëse të përzgjedhur nga Huadhënësi; ose

b) 200 pikë bazë mbi normën e interesit, që do të kishte qenë e pagueshme, nëse shuma e vonuar, gjatë periudhës së mospagesës, do të përbënte një këst.

Për sa kohë që vazhdon mospagesa, kjo normë duhet të rivendoset në pajtim me dispozitat e kësaj klauzole 6(3) në ditën e fundit të secilës periudhë të tillë interesi dhe interesi i papaguar, sipas kësaj klauzole, në lidhje me periudhat e mëparshme të interesit, i shtohet shumës së interesit të kërkueshëm në fund të secilës periudhë të tillë interesi. Interesi i kamatëvonesës është menjëherë i kërkueshëm dhe i pagueshëm.

4. Huamarrësi ndërmerr të paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet e shkaktuara dhe të pagueshme nga Huadhënësi, në lidhje me transaksionin financiar dhe përgatitjen dhe zbatimin e kontratave të huamarrjes dhe kosto e shpenzime të tjera të shkaktuara dhe të pagueshme nga Huadhënësi, në lidhje me këto Kontrata Huadhënieje, dhe kosto e shpenzime të ngjashme gjatë kohëzgjatjes së kontratave të huamarrjes. Këto kosto dhe shpenzime që do të mbulohen nga Huamarrësi mund të përfshijnë, ndër të tjera, kostot ligjore (të tilla si kostot e shkaktuara për opinionet ligjore), kostot e klasifikimit dhe komisionet e lidhura me shërbimin financiar të Kontratave të Huamarrjes, taksat, tarifat e regjistrimit dhe kostot e publikimit.

5. Huamarrësi ndërmerr t'i paguajë Huadhënësit të gjithë interesin shtesë dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet, duke përfshirë tarifat ligjore të shkaktuara dhe të pagueshme nga Huadhënësi, si rezultat i një shkeljeje të ndonjë detyrimi, sipas kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi.

6. Nëse, për shkak të kushteve mbizotëruese të tregut, në kohën e fillimit të emetimit të bonove ose ndonjë transaksioni tjetër financiar, Huadhënësi nuk mund të sigurojë një financim në ose nën normën maksimale të interesit të përmendur në kërkesën përkatëse për fonde, atëherë Huadhënësi nuk ka asnjë detyrim për të vënë në dispozicion të Huamarrësit shumën neto të disbursimit të këstit. Megjithatë, me kërkesë të Huamarrësit, pas konsultimit me Huamarrësin, Huadhënësi mund të propozojë një normë të rishikuar interesi, duke pasur parasysh kushtet e atëhershme mbizotëruese të tregut. Në këtë rast, Huamarrësi mund të paraqesë një kërkesë të ndryshuar për fondet që pasqyrojnë normën e rishikuar të interesit.

7. SHLYERJA, PAGESA E HERSHME DHE ANULIMI

1. Huamarrësi do të shlyejë shumën e principalit të çdo kësti në datën/at dhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratat përkatëse të huamarrjes, dhe siç njoftohet nga Huadhënësi bazuar në njoftimin përkatës të konfirmimit.

Huamarrësi do të transferojë shumën e principalit të kërkueshëm në llogarinë e përmendur në klauzolën 8(3) në datën e kërkueshme të pagesës.

Çdo shumë e principalit, e cila transferohet, për qëllimin e një shlyerje, në llogarinë e përmendur në pikën 8(3) nga Huamarrësi nuk mund të merret hua.

2. Termat dhe kushtet e transaksionit financiar nuk përfshijnë një klauzolë të shlyerjes së hershme.

3. Huadhënësi mund të pezullojë ose të anulojë cilindo nga këstet e patërhequra të shumës, nëse:

a) nevojat e financimit të Huamarrësit zvogëlohen rrënjësisht në krahasim me parashikimet fillestare;

b) Huamarrësi nuk zbaton kushtet e MM-së dhe të vendimeve; ose

c) FMN-ja anulon Marrëveshjen e tij plotësisht ose pjesërisht pa arritur një marrëveshje me Huamarrësin për një Marrëveshje të re të FMN-së.

8. PAGESAT

1. Të gjitha pagesat që do të bëhen nga Huamarrësi do të paguhen pa kompensim ose kundërpretendim, pa detyrim për ndonjë dhe pa zbritje për dhe për llogari të, taksë, komision dhe ndonjë tarifë tjetër për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje.

2. Huamarrësi deklaron se të gjitha pagesat dhe transfertat, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, si dhe vetë Marrëveshja, nuk janë subjekt i ndonjë takse ose i ndonjë detyrimi tjetër në shtetin e Huamarrësit dhe nuk do të jenë subjekt për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, nëse Huamarrësi ose Banka [shënoni shtetin] detyrohen me ligj të bëjnë zbritje të tilla, Huamarrësi paguan shumat e nevojshme shtesë, në mënyrë që Huadhënësi të marrë plotësisht shumat e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

3. Të gjitha pagesat nga Huamarrësi do të bëhen në euro në datën e kërkueshme të pagesës, përpara orës 11:00 të paradites. Ora lokale e Luksemburgut në llogarinë euro të Huadhënësit, në: Banque et Caisse d'Epargne de l'Etat, Luksemburg; BICEL BICELULL, IBAN i llogarisë: LU90 0019 3455 9164 5000, lënda: "Ndihmë makrofinanciare e BE-së për [*shënoni shtetin*]" ose për ndonjë llogari tjetër që Huadhënësi mund të komunikojë, duke dhënë një njoftim me shkrim përpara datës së kërkueshme të pagesës.

4. Nëse Huamarrësi paguan një shumë në lidhje me cilindo nga këstet, që është më pak se sa shuma totale e kërkueshme dhe e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi heq dorë nga të gjitha të drejtat që mund të ketë, për të bërë çdo përvetësim të shumës së paguar lidhur me shumat e kërkueshme.

Shuma e paguar sipas një kësti do të aplikohet në ose pas përmbushjes së pagesave të kërkueshme sipas këtij kësti, sipas renditjes së mëposhtme:

c) së pari, ndaj çdo tarife, shpenzimi dhe zhdëmtimi;

d) së dyti, ndaj çdo interesi për pagesa të vonuara, siç përcaktohet në Klauzolën 6 (3);

a) së treti, ndaj interesit; dhe

b) së katërti, ndaj principalit,

me kusht që këto shuma të jenë të kërkueshme ose të vonuara për t'u paguar në atë datë.

5. Çdo llogaritje dhe përcaktim nga Huadhënësi, sipas kësaj Marrëveshjeje:

e) do të bëhet në një mënyrë të arsyeshme tregtare; dhe

c) do të jetë, pa gabim të dukshëm, detyrues për Huadhënësin dhe Huamarrësin.

7. Do të zbatohet Konventa e Ditës së Punës, siç njoftohet në njoftimin e konfirmimit.

9. RASTET E MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE

1. Huadhënësi, me një njoftim dërguar me shkrim Huamarrësit, mund ta anulojë Shumën dhe/ose të deklarojë që shuma e principalit të papaguar e Huas do të jetë menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme, së bashku me interesin e shtuar, nëse:

a) Huamarrësi nuk paguan asnjë shumë të principalit ose të interesit, sipas ndonjë kësti ose çfarëdo shume tjetër të kërkueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje, në datën e kërkueshme të pagesës, qoftë plotësisht ose pjesërisht, në mënyrën siç është rënë dakord në këtë Marrëveshje;

b) Huamarrësi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç asaj të përmendur në klauzolën 9(1)(a) (duke përfshirë detyrimin e përcaktuar në klauzolën 2(3) për të përdorur Huan, në përputhje me kushtet e MM-së, por duke përjashtuar ndonjë detyrim tjetër sipas MM-së) dhe një mospërmbushje e tillë e detyrimeve vazhdon për një periudhë prej një muaji pasi njoftimit me shkrim që Huadhënësi i ka dhënë Huamarrësit; ose

c) Huadhënësi i dërgon Huamarrësit një deklaratë të mospërmbushjes së detyrimeve në rrethanat, kur detyrimet e Huamarrësit, sipas kësaj Marrëveshjeje, deklarohen nga një gjykatë e juridiksionit kompetent se nuk janë detyruese ose të zbatueshme ndaj Huamarrësit ose deklarohen nga një gjykatë e juridiksionit kompetent si të paligjshme; ose

d) Huadhënësi i dërgon Huamarrësit një deklaratë të mospërmbushjes së detyrimeve në rrethanat, kur i. është vërtetuar se në lidhje me këtë Marrëveshje ose MM, Huamarrësi është angazhuar në ndonjë akt mashtrimi ose korrupsioni ose ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm të dëmshëm për interesat financiarë të Huadhënësit; ose ii. çdo përfaqësim ose garanci e bërë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje është i pasaktë, i pavërtetë ose

mashtrues dhe që, sipas mendimit të Huadhënësit, pas konsultimit me Huamarrësin, mund të ketë një ndikim negativ në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose te të drejtat e Huadhënësit sipas saj; ose

e) Çdo marrëveshje e mëparshme huaje ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit ose ndonjë institucioni të BE-së, pavarësisht nga shuma, është subjekt i një deklarate të mospërmbushjes së detyrimeve ose ekziston një mospërmbushje e detyrimeve për çdo detyrim pagese të çfarëdo lloji ndaj Huadhënësit ose ndonjë institucioni të BE-së nga Huamarrësi, i cili krijon një deklaratë të mospërmbushjes së detyrimit; ose

f) Borxhi i jashtëm i Huamarrësit, që ka një shumë të përgjithshme të principalit më të madhe se 50 milionë euro, është objekt i një deklarate të mospërmbushjes së detyrimeve, siç përcaktohet në çdo instrument që rregullon ose identifikon një borxh të tillë dhe si rezultat i një deklarate të tillë të mospërmbushjes së detyrimeve ekziston përshpejtimi i një borxhi të tillë ose një moratorium *de facto* mbi pagesa; ose

g) Huamarrësi nuk bën ndonjë riblerje në kohë nga FMN-ja, në lidhje me Marrëveshjen e FMN-së dhe është subjekt i një deklarate të mospërmbushjes së detyrimeve; ose

h) Huamarrësi nuk paguan një pjesë të konsiderueshme të borxhit të tij të jashtëm, që bëhet e kërkueshme ose deklaron, ose vendos një moratorium për pagesën e borxhit të tij të jashtëm ose të borxhit të jashtëm të supozuar ose të garantuar prej tij.

2. Huadhënësi mund, por nuk është i detyruar, të ushtrojë të drejtat e tij, sipas kësaj klauzole dhe, gjithashtu, mund t'i ushtrojë ato vetëm pjesërisht, pa cenuar ushtrimin e mëtejshëm të këtyre të drejtave.

3. Huamarrësi rimburson të gjitha kostot, shpenzimet dhe tarifat që duhet të paguhen nga Huadhënësi, si pasojë e një shlyerjeje të hershme të çdo kësti, sipas kësaj klauzole, duke përfshirë interesin deri në datën fillestare të maturimit. Gjithashtu, Huamarrësi do të paguajë interesin e mospërmbushjes së detyrimeve, siç parashikohet në klauzolën 6(3) më lart, i cili shtohet nga data kur shuma e papaguar e principalit të Huas është deklaruar menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme, deri në datën e kryerjes së plotë të pagesës aktuale.

10. SIPËRMARRJET PËR INFORMACION

1. Me paraqitjen e kërkesës së parë për fonde, Huamarrësi do t'i japë menjëherë Huadhënësit:

a) çdo informacion në lidhje me gjendjen e tij fiskale dhe ekonomike, siç mund të kërkojë Huadhënësi në mënyrë të arsyeshme, në përputhje me MM-në;

b) çdo informacion që ka të bëjë me ndonjë ngjarje, e cila në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të shkaktojë një ngjarje të mospërmbushjes së detyrimeve (dhe hapat, nëse ka, që janë marrë për ta korrigjuar atë).

2. Huamarrësi merr përsipër të informojë menjëherë Huadhënësin nëse ndodh ndonjë ngjarje që do ta bëjë të gabuar ndonjë deklaratë të dhënë në mendimin juridik të Huamarrësit, të përcaktuar në aneksin 4.

3. Huamarrësi merr përsipër të informojë Huadhënësin brenda një muaji nga çdo datë disbursimi, bazuar në deklaratën e paraqitur në aneksin 3, të transferimit të kësteve të huas në llogarinë e Shërbimit të Thesarit Shtetëror dhe për hyrjet përkatëse në llogaritë publike.

4. Huadhënësi ka të drejtë të ndalojë çlirimin e një kësti, në rast se Huamarrësi nuk e ka bërë deklaratën e aneksit 3, në lidhje me kështin e mëparshëm.

11. SIPËRMARRJET LIDHUR ME INSPEKTIMET, PARANDALIMIN E MASHTRIMIT DHE KONTROLLET

1. Gjatë zbatimit të ndihmës makrofinanciare të unionit, komisioni ka të drejtë të monitorojë qëndrueshmërinë e angazhimeve financiare të Huamarrësit, procedurat administrative dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm që kanë rëndësi për ndihmën.

2. Në përputhje me rregulloret e tij financiare, Huadhënësi, duke përfshirë Zyrën Evropiane të Antimashtrimit dhe Gjykata Evropiane e Auditorëve kanë të drejtë të dërgojnë agjentët e tyre ose përfaqësuesit e autorizuar, sipas rregullave për të kryer çdo kontroll teknik ose financiar, duke përfshirë kontrollet dhe inspektimet në vend (përfshirë operacionet digjitale ligjore dhe intervistat) dhe auditimet (përfshirë auditimet e dokumenteve dhe kontrollet në vend), që ata i konsiderojnë të domosdoshme në lidhje me menaxhimin e kësaj Huaje gjatë periudhës së

disponibilitetit ose më pas, për të mbrojtur interesat financiarë të Huadhënësit.

3. Huamarrësi siguron informacione dhe dokumente përkatëse, që mund të kërkohen për qëllime të këtyre vlerësimeve, kontrolleve ose auditimeve, dhe merr të gjitha masat e përshtatshme për të lehtësuar punën e personave të udhëzuar për t'i kryer ato, përfshirë edhe dhënien e aksesit personave të përmendur në paragrafin 2, në vendet dhe ambientet ku ruhen informacionet dhe dokumentet përkatëse.

4. Huamarrësi kontrollon rregullisht nëse financimi i siguruar nga Huadhënësi është përdorur siç duhet dhe siguron hetimin dhe trajtimin e kënaqshëm të rasteve të dyshuara dhe aktuale të mashtrimit, korrupsionit ose ndonjë aktiviteti tjetër të paligjshëm, në lidhje me menaxhimin e Huas, të dëmshme për interesat financiarë të BE-së. Të gjitha këto raste, si dhe masat e lidhura me to, të marra nga autoritetet kompetente kombëtare, përfshirë veprimet juridike për të rikuperuar fondet e parashikuara në këtë Marrëveshje, do t'i raportohen Huadhënësit pa vonesë.

12. NJOFTIMET

1. Të gjitha njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje do të jepen në mënyrë të vlefshme, nëse jepen me shkrim dhe u dërgohen marrësve të listuar në shtojcën 5. Secila Palë do të përditësojë listën e marrësve dhe do t'ia njoftojë Palës tjetër të Marrëveshjes, duke u ndryshuar herë pas here.

2. Njoftimet bëhen efektive në datën e marrjes së postës elektronike ose së letrës me të cilën ato dorëzohen.

3. Të gjitha dokumentet, informacionet dhe materialet që do të sigurohen në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të jenë në gjuhën angleze.

4. Secila Palë e kësaj Marrëveshjeje do t'i njoftojë Palës tjetër listën dhe nënshkrimet e ekzemplarëve të personave të autorizuar për të vepruar në emër të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Po kështu, secila Palë do të përditësojë këtë listë dhe do të njoftojë Palën tjetër për të njëjtën listë që ndryshohet, herë pas here.

13. TË TJERA

1. Nëse ndonjë ose më shumë nga dispozitat e përfshira në këtë Marrëveshje duhet të jetë ose të bëhet plotësisht ose pjesërisht e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme në çdo aspekt, sipas ndonjë ligji në fuqi, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të përfshira në këtë Marrëveshje, në asnjë mënyrë nuk do të preket ose dëmtohet. Dispozitat të cilat janë plotësisht ose pjesërisht të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme do të interpretohen dhe zbatohen sipas frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Preambula dhe anekset e kësaj Marrëveshjeje bëjnë dhe do të formojnë më tej një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje përfshin si referencë kushtet e MM-së.

3. Huadhënësi mund të vendosë në diskrecionin e tij të plotë për Transaksione Financiare, të cilat, gjithashtu, financojnë këste në bazë të marrëveshjeve të tjera të huas. Në këtë rast, kushtet financiare të këtyre Kontratave të Huamarrjes zbatohen për Huamarrësin vetëm proporcionalisht për kështet e tij.

4. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të përcaktojë kushtet mbi të cilat Huadhënësi i vë në dispozicion Huamarrësit të ardhurat e transaksioneve financiare përkatëse të rregulluara nga Huadhënësi për këtë qëllim. Prandaj, Huamarrësi dhe Huadhënësi pranojnë që të drejtat dhe detyrimet e tyre, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, përcaktohen dhe interpretohen duke iu referuar dokumentacionit përkatës të huamarrjes. Në veçanti, kushtet e kontratave të huamarrjes do të zbatohen për Marrëveshjen. Megjithatë, nëse ka ndonjë konflikt midis kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo kontrate huamarrjeje, kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojnë.

5. Huamarrësi nuk ka të drejtë të caktojë ose të transferojë ndonjë prej të drejtave ose detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

14. LIGJI RREGULLUES DHE JURIDIK-SIONI

1. Kjo Marrëveshje dhe çdo detyrim jokontraktues, që rrjedh nga ose në lidhje me të, do të rregullohet dhe do interpretohet në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, i cili plotësohet kur është e nevojshme me legjislacionin e Luksemburgut. Kontratat e huamarrjes do të rregullohen nga legjislacioni i Luksemburgut.

2. Palët marrin përsipër të parashtrojnë çdo mosmarrëveshje, që mund të lindë në lidhje me ligjshmërinë, vlefshmërinë, interpretimin ose performancën e kësaj Marrëveshjeje në

juridiksionin ekskluziv të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 272 të Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian.

3. Vendimet e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian janë plotësisht detyruese dhe të zbatueshme nga Palët.

4. Huadhënësi mund të zbatojë çdo vendim të marrë nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ose të drejta të tjera ndaj Huamarrësit në gjykatat e shtetit të Huamarrësit.

Huamarrësi, në këtë mënyrë, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar heq dorë nga çdo imunitet që i jepet ose mund t'i jepet, në lidhje me veten ose pasuritë e tij, nga procedurat ligjore në lidhje me këtë Marrëveshje, përfshirë, pa kufizim, imunitetin nga padi, vendim ose urdhër tjetër, konfiskim, arrestim apo vendim gjyqësor përpara gjykimit dhe nga ekzekutimi dhe zbatimi ndaj aseteve të tij, deri në masën që nuk ndalohet me ligj të detyrueshëm.

15. HYRJA NË FUQI

1. Pas nënshkrimit të saj nga të gjitha Palët, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën kur Huadhënësi ka marrë njoftimin zyrtar në formën e opinionit ligjor (aneksi 4 i kësaj Marrëveshjeje) nga Huamarrësi, se janë përmbushur të gjitha kërkesat kushtetuese dhe ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe angazhimin e vlefshëm dhe të parevokueshëm të Huamarrësit për të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Hyrja në fuqi nuk duhet të ndodhë më vonë se 6 muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes. Nëse Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi deri në atë datë, Palët në Marrëveshje nuk do të jenë më të detyruara nga Marrëveshja.

16. EKZEKUTIMI I MARRËVESHJES

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet nga secila Palë, në katër origjinale, në gjuhën angleze, secila prej të cilave do të përbëjë një instrument origjinal.

ANEKSET

Anekset e kësaj Marrëveshjeje do të përbëjnë një pjesë integrale të saj:

1. Forma e kërkesës për fonde;
2. Forma e njoftimit të konfirmimit;
3. Forma e deklaratës mbi përdorimin e kësteve të Huas;
4. Forma e opinionit ligjor;
5. Lista e kontakteve.

Bërë në Tiranë, më ____.____.2020, dhe në Bruksel, më 3.11.2020, në katër kopje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIMI EVROPIAN
si Huamarrëssi Huadhënës

Përfaqësuar nga: Përfaqësuar nga:
NënshkrimiNënshkrimi
Ministër i Financave dhe EkonomisëKomisioni Evropian

BANKA E SHQIPËRISË
Përfaqësuar nga
Nënshkrimi
Guvernatori

ANEKSI 1
FORMA E KËRKESËS PËR FONDE

[*në letrën me kokë të Huamarrësit*]
Komisioni Evropian
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit
Sektori E-3: Huamarrje dhe Huadhënie
Në vëmendje të: Përgjegjësit të njësisë
L-2920 Luxembourg

Lënda: **Ndihmë Makrofinanciare e Bashkimit Evropian**
Kërkesë për fonde për këstin [•]

Të nderuar Zotërinj,

Po i referohemi Marrëveshjes së Shumës së Huas së datës [•] ndërmjet Bashkimit Evropian si Huadhënës dhe Republikës së Shqipërisë si Huamarrës, dhe Bankës së Shqipërisë si agjenti financiar i Huamarrësit (Marrëveshja). Kushtet e përcaktuara në Marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim këtu.

1. Ne kërkojmë në mënyrë të parevokueshme që një këst i huas të disbursohet, sipas dhe në përputhje me Marrëveshjen, sipas kushteve të mëposhtme:

a) Shuma e principalit të këstit: 90 milionë euro.

b) Shuma neto e disbursimit të këstit të jetë të paktën [•]% të shumës së principalit.

c) Norma fikse nominale e interesit të këstit nuk duhet të jetë më e lartë se [•]% në vit.

d) Disbursimi sipas këtij kësti do të bëhet përpara: [•].

e) Shlyerja e principalit të çdo kësti do të kryhet në [viti].

2. Ne pranojmë dhe biem dakord se disbursimi i çdo kësti do të jetë në përputhje me dhe sipas:

a) Huadhënësi është i kënaqur në çdo kohë që fondet përkatëse janë në dispozicion të tij nga një palë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit për termat dhe kushtet që janë të pranueshëm për të dhe që janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kërkesë për fonde;

b) Huadhënësi, që kryen një ose disa transaksione financiare për të marrë të ardhurat e kërkuara në këtë kërkesë për fonde. Ne marrim përsipër në mënyrë të parevokueshme të paguajmë çdo tarifë, kosto dhe shpenzim, duke përfshirë nëse është e zbatueshme koston e penalitetit të parapagimit dhe koston e pozicionimit të investimit, që rezultojnë nga ndonjë transaksion financiar që Huadhënësi mund të ketë ndërmarrë, pavarësisht nëse përfundimisht do të kryhet disbursimi i një kësti.

c) Lëshimi nga Huadhënësi, në kohën e duhur, i një njoftimi konfirmimi.

3. Konfirmojmë se:

a) Lista e nënshkruesve të autorizuar të dërguar në emër të Huamarrësit nga ministri i Financave dhe Ekonomisë në [*datë*] mbetet e vlefshme dhe e zbatueshme.

b) Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që do të bënte të pasaktë ndonjë deklaratë të dhënë në mendimin juridik të lëshuar nga ministri i Drejtësisë i datës [*data*].

c) Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje e mospërmbushjes së detyrimeve.

[*nënshkrimi i autorizuar*]

Kopje për Bankën e Shqipërisë

[shënoni adresën]

ANEKSI 2

FORMA E NJOFTIMIT TË KONFIRMIMIT

KOMISIONI EVROPIAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHMEE BUXHETIT
Menaxhimi i aseteve dhe i riskut financiar
Huamarrje dhe Huadhënie

[*shënoni detajet e kontaktit të Huamarrësit*]

Lënda: **Ndihmë Makrofinanciare e Bashkimit Evropian**
Disbursim i kështit [•]

Të nderuar Zotërinj,

Po i referohemi Marrëveshjes së Shumës së Huas së datës [•] ndërmjet Bashkimit Evropian si Huadhënës dhe Republikës së Shqipërisë si Huamarrës, dhe Bankës së Shqipërisë si agjenti financiar i Huamarrësit, në një shumë maksimale prej 180 milionë eurosh (Marrëveshja). Kushtet e përcaktuara në Marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim këtu.

Në përputhje me kërkesën për fonde të datës [•], kushtet e transaksionit financiar që Bashkimi Evropian ka ndërmarrë për të financuar këstin [•] janë si më poshtë:

Shuma nominale	EUR [•]
Çmimi i emetimit	EUR [•]
Tarifat e bankës	EUR [•]
Të ardhurat neto	EUR [•]
Rikuperimi i kostos së transaksionit	EUR [•]
Shuma neto e disbursimit	EUR [•]
Data e disbursimit	[•]
Data e maturimit	[•]

Norma e interesit (kupon)	[•] % p.a.
Datat e pagesës së interesit	Çdo vit më [•]
Data e pagesës së interesit të parë	[•]
Pagesa e interesit të parë (afatshkurtër /afatgjatë)	EUR [•]

Konventa e zbatueshme për llogaritjen e ditëve është [•].
Ju lutem gjeni bashkëlidhur skedulin e pagesës së huas.

Sinqerisht Juaji,

BASHKIMI EVROPIAN
përfaqësuar nga
KOMISIONI EVROPIAN

[•][•]

Aneksi: Skeduli i pagesës së huas
Kopje për: Banka e Shqipërisë

ANEKSI 3
DEKLARATË MBI PËRDORIMIN E KËSTEVE TË HUAS

[*në letrën me kokë të Huamarrësit*]

Komisioni Evropian
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit
Sektori E-3: Huamarrje dhe Huadhënie
Në vëmendje të: Përgjegjësit të njësisë
L-2920 Luxembourg

Lënda: **Ndihma Makrofinanciare e Bashkimit Evropian**
Deklaratë lidhur me mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së

I nderuar Zotëri, Zonjë,

Po i referohemi Marrëveshjes së Shumës së Huas të datës [*shënoni datën*] ndërmjet Bashkimit Evropian si Huadhënës dhe Republikës së Shqipërisë si Huamarrës, dhe Bankës së Shqipërisë si agjenti financiar i Huamarrësit (Marrëveshja). Kushtet e përcaktuara në Marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim këtu.

Me anë të së cilës konfirmojmë se:

1. Kësti i parë/i dytë i huas [*fshini sipas rastit*] i disbursuar më [*shënoni datën*] është transferuar në llogarinë e Shërbimit të Thesarit të Shtetit në Bankën e Shqipërisë.

2. Kësti i parë/i dytë i huas [*fshini sipas rastit*] është llogaritur si "Financim i jashtëm" në llogaritë publike për vitin [*shënoni vitin*], bazuar në kursin e këmbimit Euro/[*shënoni monedhën vendëse*] të [*shënoni kursin e zbatueshëm të FX*] e zbatueshme më [*shënoni datën*], ekuivalenti i [*shënoni monedhën vendëse*] shumës neto të disbursimit, që është [shënoni monedhën vendëse] [*shënoni shumën*].

Dokumentet përkatëse të kontabilitetit të Bankës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë në dispozicion sipas kërkesës.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë

Kopje për Bankën e Shqipërisë.

ANEKSI 4
FORMA E OPINIONIT LIGJOR

MINISTRIA E DREJTËSISË
(Ministria e Drejtësisë duhet të lëshojë një letër zyrtare me kokë)

[*vendi, data*]
Komisioni Evropian
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit
Sektori E-3: Huamarrje dhe Huadhënie
L-2920 Luxembourg

Lënda: **Marrëveshja e Shumës së Huas ndërmjet Bashkimit Evropian (si Huadhënës) dhe Republikës së Shqipërisë (si Huamarrës), dhe Bankës së Shqipërisë (si agjent financiar ndaj Huamarrësit), për një shumë maksimale prej 180 milionë eurosh**

Të nderuar Zotërinj,

Në cilësinë time si ministër i Drejtësisë, i referohem Marrëveshjes së Shumës së Huas referuar sa më lart, të datës [*datë*] dhe anekseve të saj, të cilat përbëjnë një pjesë integrale të saj (referuar në vijim bashkërisht si "Marrëveshja") ndërmjet Bashkimit Evropian (në vijim i referuar si "Huadhënësi") dhe Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si "Huamarrësi"), dhe Bankës së Shqipërisë si agjenti financiar i Huamarrësit, për një shumë maksimale prej 180 milionë eurosh. Gjithashtu, i referohem Memorandumit të Mirëkuptimit të datës [*datë*] ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si "MM").

Unë garantoj se jam plotësisht kompetent për të dhënë këtë mendim juridik në lidhje me Marrëveshjen në emër të Huamarrësit.

Kam kontrolluar origjinalet ose kopjet e versioneve të nënshkrimit të Marrëveshjes dhe të MM-së. Gjithashtu, kam kontrolluar dispozitat përkatëse të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar të zbatueshëm për Huamarrësin dhe Bankën e Shqipërisë, kompetencat e nënshkruesve dhe dokumente të tjera, të cilat gjykoj se janë të domosdoshme ose të përshtatshme. Për më tepër, unë kam bërë kërkime të tjera dhe kam shqyrtuar çështje juridike, të cilat i konsideroj të rëndësishme për mendimin e shprehur në këtë dokument.

Pranoj: i. vërtetësinë e të gjitha nënshkrimeve (përveç Huamarrësit dhe Bankës se Shqipërisë) dhe konformitetin e të gjitha kopjeve me origjinalet; ii. kompetencën dhe tagrin për të lidhur këtë Marrëveshje, dhe autorizimin dhe nënshkrimin e tyre të vlefshëm nga secila Palë, përveç Huamarrësit dhe Bankës së Shqipërisë; dhe iii. vlefshmërinë, efektin detyrues dhe zbatueshmërinë e Marrëveshjes për secilën Palë, sipas legjislacionit të Unionit.

Shprehjet e përdorura dhe të papërcaktuara në këtë mendim do të kenë kuptimin e përcaktuar në Marrëveshje dhe në MM.

Ky mendim është i kufizuar në ligjin shqiptar, siç qëndron në datën e dhënies së këtij mendimi.

Sa më sipër, shpreh mendimin tim si më poshtë:

1. Në lidhje me ligjet, rregulloret dhe vendimet ligjërisht detyruese, që janë aktualisht në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me nënshkrimin e Marrëveshjes nga [*shënoni emrin*], Huamarrësi është i përkushtuar në mënyrë të vlefshme dhe të parevokueshme për të përmbushur të gjitha detyrimet e tij sipas Marrëveshjes.

2. Ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e Marrëveshjes dhe MM-së nga Huamarrësi: i. janë autorizuar rregullisht nga të gjitha pëlqimet, veprimet, miratimet dhe autorizimet e nevojshme; dhe ii. nuk shkelin ndonjë rregullore apo vendim të zbatueshëm të ndonjë autoriteti kompetent ose ndonjë marrëveshjeje ose traktat ndërkombëtar që është i detyrueshëm për të.

3. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk kundërshton ose kufizon të drejtat e Huamarrësit për të bërë pagesë të saktë dhe efektive të çdo shume të kërkueshme për principalin, interesin ose tarifat e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje.

4. Marrëveshja dhe MM-ja kanë formën e duhur juridike, sipas ligjit të Shqipërisë për zbatim ndaj Huamarrësit. Zbatimi i Marrëveshjes nuk do të ishte në kundërshtim me dispozitat e detyrueshme të ligjit [*shënoni shtetin*], rendit publik të Shqipërisë, traktateve ndërkombëtare ose parimeve të pranuara përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare që janë të detyrueshme për Huamarrësin.

5. Nuk është e nevojshme, për të siguruar ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e Marrëveshjes dhe të MM-së, që ato të dorëzohen, shënohen ose regjistrohen në ndonjë gjykatë ose autoritet në Shqipëri.

6. Asnjë taksë, tatim, tarifë ose detyrime të tjera të vendosura nga Shqipëria ose ndonjë autoriteti tatimor të saj ose këtu nuk janë të pagueshme në lidhje me ekzekutimin dhe dorëzimin e Marrëveshjes dhe me çdo pagesë ose transferim të principalit, interesit, komisioneve dhe të tjera shuma për shkak të Marrëveshjes.

7. Nuk kërkohet asnjë autorizim i kontrollit të këmbimit dhe nuk paguhet asnjë tarifë ose komision tjetër për transferimin e ndonjë shume të kërkueshme sipas Marrëveshjes.

8. Nënshkrimi i Marrëveshjes dhe i MM-së nga [*shënoni emrin*] Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, detyron ligjërisht dhe në mënyrë të vlefshme Bankën e Shqipërisë.

9. Zgjedhja e legjislacionit të unionit si legjislacioni rregullues për Marrëveshjen është një zgjedhje e vlefshme e legjislacionit, që detyron Huamarrësin dhe Bankën e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

10. Huamarrësi i është nënshtruar ligjërisht, në mënyrë efektive dhe të parevokueshme, juridiksionit ekskluziv të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, në lidhje me Marrëveshjen dhe çdo vendim i kësaj gjykate do të ishte përfundimtar dhe i zbatueshëm në Shqipëri.

11. As Huamarrësi dhe asnjë pronë e tij nuk janë imune mbi bazën e sovranitetit ose ndryshe nga juridiksioni, konfiskimi - qoftë përpara ose pas gjykimit - ose ekzekutimi për sa i përket ndonjë veprimi ose procedure në lidhje me Marrëveshjen.

12. Marrëveshja dhe MM-ja mbi ekzekutimin janë në përputhje me të gjitha kërkesat kushtetuese të brendshme për Marrëveshjen dhe për MM-në, për të qenë operative si çështje e legjislacionit shqiptar dhe detyruese për Shqipërinë dhe Bankën e Shqipërisë dhe janë bërë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

13. Marrëveshja dhe MM-ja janë plotësisht të vlefshme dhe nuk është e nevojshme të ratifikohen.

14. Si përfundim, Marrëveshja dhe MM-ja janë nënshkruar sipas rregullave në emër të Huamarrësit dhe të gjitha detyrimet e Huamarrësit në lidhje me Marrëveshjen dhe MM-në janë të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme, në përputhje me kushtet e tyre dhe nuk kërkohet asgjë më tej për t'i dhënë efekt së njëjtës.

Ministri i Drejtësisë

ANEKSI 5
LISTA E KONTAKTEVE

Për Huadhënësin:

Komisioni Evropian
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit
Sektori E-3: Huamarrje dhe Huadhënie
Në vëmendje të: Përgjegjësit të njësisë
L-2920 Luxembourg
Telefon: (+352) 4301 30070

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Zyra e Ministrit
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë, Shqipëri

Kopje për:

Bankën e Shqipërisë
Zyra e Guvernatorit
Sheshi "Skënderbej", nr. 1
Tiranë, Shqipëri

DEKRET
Nr. 11895, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 157/2020, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent për huamarrësin, dhe Bashkimit Evropian, si huadhënës, për ndihmën makrofinanciare për Shqipërinë".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 161/2020

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 33, DATË 11.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.5.1993, 'PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 33, datë 11.12.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, 'Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar.

Miratuar në datën 23.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11899, datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11899, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 161/2020, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 33, datë 11.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, 'Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 164/2020

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 90/2019, "PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në paragrafin e parë të nenit 1, fjalët "deri në datën 31 dhjetor 2020 " zëvendësohen me fjalët "deri në datën 31 dhjetor 2021".

Neni 2

Në nenin 5, fjalët "dhe i shtrin efektet deri në datën 31 dhjetor 2020" zëvendësohen me "dhe i shtrin efektet deri në datën 31 dhjetor 2021".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11900, datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11900, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 164/2020, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 90/2019, 'Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 165/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9179, DATË 29.1.2004, "PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË DISA NDËRMARRJE TË INDUSTRISË USHTARAKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4

Përfitojnë trajtim të veçantë punonjësit e ndërmarrjeve të sistemit të industrisë ushtarake, të cilët:

- në datën 31.12.2002 kanë qenë në marrëdhënie pune ose janë trajtuar në bazë të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 8.8.2002, dhe nr. 695, datë 27.12.2002, në Kombinatin Mekanik në Poliçan, në Uzinën e Lëndëve Plasëse në Mjekës, në Uzinën Mekanike dhe Uzinën e Pilave në Gramsh dhe në Uzinën e Riparimit të Avionëve në Kuçovë;
- kanë vazhduar të punojnë pas datës 30.9.2004 dhe ndërpresin marrëdhëniet e punës me ndërmarrjet e sistemit të industrisë ushtarake deri në datën 31.12.2020;
- kanë një periudhë pune ose gatishmërie jo më pak se 17 vjet dhe periudhë sigurimi jo më pak se 20 vjet për gratë, dhe periudhë pune ose gatishmërie jo më pak se 20 vjet dhe periudhë sigurimi jo më pak se 25 vjet për burrat;
- nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike.".

Neni 2

Në nenin 6 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"E drejta e kërkesës për përfitime për personat që përfitojnë sipas paragrafit të dytë të nenit 4 të ligjit, ushtrohet brenda datës 1.4.2021. E drejta për përfitime lind nga data e paraqitjes së kërkesës pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.12.2020

Shpallur me dekretin nr. 11901, datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11901, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 165/2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9179, datë 29.1.2004, 'Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 167/2020

PËR FALJEN E DETYRIMEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, QË ISH-PUNONJËSIT E NËNTOKËS KANË NDAJ INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, TË LLOGARITURA PËR PERIUDHËN QË KANË PËRFITUAR, SIPAS LIGJIT NR. 8685, DATË 9.11.2000, "PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË", TË NDRYSHUAR, TË CILËT NJËKOHËSISHT KANË ZHVILLUAR AKTIVITET EKONOMIK SI TË PUNËSUAR OSE VETËPUNËSUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj parashikon faljen e detyrimeve të papaguara që ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore për periudhën që ata janë trajtuar me përfitimet e caktuara, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar".

Neni 2
Personat përfitues

Përfitojnë nga ky ligj të gjithë ish-punonjësit e nëntokës, që janë debitorë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 3
Personat që nuk përfitojnë

Nuk përfitojnë nga fshirja e detyrimeve të parashikuara sipas këtij ligji, personat përfitues për detyrimet që krijojnë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 4
Falja e gjobave

1. Falen gjobat e përllogaritura nga sistemi i sigurimeve shoqërore, të llogaritura për periudhën që ata janë trajtuar me përfitimet e caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar", sipas gjendjes së papaguar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Falen detyrimet e vendosura, që janë evidentuar sipas pikës 1 të këtij neni, të cilat në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë ankimuar dhe janë në proces ankimi administrativ ose në proces gjyqësor.

3. Periudhat e mbuluara me kontribute të derdhura për të cilat është likuiduar detyrimi i llogaritur nga përfitimi i paguar, do të njihen si periudha sigurimi për efekt të pensionit të pleqërisë.

Neni 5
Procedura e shuarjes së detyrimeve të falura nga ky ligj

Brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Instituti i Sigurimeve Shoqërore fshin detyrimet e përllogaritura nga sistemi, të falura sipas këtij ligji, dhe bën pasqyrimet konkrete të fshirjes në regjistrat e tyre.

Lista e personave përfitues dhe vlera e detyrimit përkatës publikohen brenda 3 muajve në faqen zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Neni 6

Ngarkohet Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore që brenda 5 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të zbatojnë të gjitha procedurat administrative dhe dokumentare të evidentimit të detyrimeve të falura.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.12.2020.

Shpallur me dekretin nr.11902, datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11902, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 167/2020, "Për faljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, që ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfituar sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, 'Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë', të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose të vetëpunësuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 169/2020

PËR NJOHJEN SI PERIUDHË SIGURIMI PËR EFEKT PËRFITIMI NGA SIGURIMET SHOQËRORE TË KOHËS SË PUNËSIMIT NË ISH-KOOPERATIVAT BUJQËSORE

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ligji ka për qëllim njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore, për të cilat është djegur dokumentacioni arkivor i vjetërsisë në punë, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501 datë 19.7.1991, "Për tokën", të ndryshuar.

Neni 2
Periudha e sigurimit dhe kushtet e njohjes së saj për efekt përfitimi

1. Njihet si periudha e sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore, nga mosha për punë në kooperativat bujqësore e përcaktuar në legjislacionin e kohës, por jo më herët se viti i krijimit të kooperativës bujqësore,

deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën".

2. Njohja e periudhës së sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore sipas paragrafit të parë të këtij neni, në varësi të periudhës së deklaruar nga vetë personat kërkues, bëhet respektivisht me ditë, muaj ose vite të plota pune vetëm kur vërtetohet se gjatë periudhës së deklaruar:

a) nuk ka qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie;

b) nuk ka qenë përfitues i pensionit të invaliditetit të plotë;

c) ka qenë banor i territorit në të cilin ka shtrirë aktivitetin e saj ish-kooperativa bujqësore.

Neni 4
Deklarimi i rremë

Deklarimi i rremë i kohës së punësimit pranë ish-kooperativave bujqësore nga personat kërkues përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Periudhat e sigurimit të njohura në ish-kooperativat bujqësore sipas nenit 2, kanë efekt për përfitime që nuk janë caktuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë listën e ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11903, datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11903, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 169/2020, "Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 1103, datë 24.12.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "MUZEU HEBRAIK SHQIPTAR NË VLORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Muzeu Hebraik Shqiptar në Vlorë", në zbatim të vendimit nr. 218, datë 21.7.2020, të KKTKM-së, "Për miratimin e propozimit paraprak për zhvillimin e 'Muzeut Hebraik Shqiptar në Vlorë'", dhe të vendimit nr. 1, datë 23.7.2020, të

Këshillit Kombëtar të Muzeve, "Për miratimin e projektidesë së muzealizimit të 'Muzeut Hebraik Shqiptar në Vlorë"'.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "apartament", me një vlerë të përgjithshme prej 6 737 363 (gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 6 737 363 (gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh, do të përballohet nga buxheti i vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Kulturës, zëri "shpronësime".

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Ministria e Kulturës.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Drejtorisë Rajonale së Trashëgimisë Kulturore Vlorë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes se gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Drejtorisë Rajonale së Trashëgimisë Kulturore Vlorë, për pasurinë e shpronësuar.

9. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA PARAPRAKE ME EMRAT E PRONARËVE PËR PASURITË E PALUAJTSHME QË PREKEN NGA PROJEKTI "MUZEU HEBRAIK SHQIPTAR NË VLORË" (PROJEKTPROPOZIM PARAPRAK ENDE I PAMIRATUAR)

Zona kadastrale 8601 (pasuritë e paluajtshme dhe çmimi mesatar i shitblerjeve për tre muajt e fundit, sipas konfirmimit të dërguar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës me shkresën nr. 7730/1, prot. , datë 29.9.2020 dhe shkresën me nr. 8713/2 prot., datë 11.11.2020.

Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit, lek/m²	Çmimi i ndërtimit lek/m²	Vlera e Truallit, lek	Vlera e ndërtimit, lek	Vlera truall dhe ndërtesë	Shënime
8601	20/2+1-1	Vlorë	Ernest Sefedin Tozaj	-	58.8	-	55,133.9	-	3.241.873.3	-	Konfirmuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës
8601	20/2	Vlorë	Mariban Korabi	-		-	55,133.9	-	00	-	E pakonfirmuar sipërfaqja (referuar shkresës së ASHK-së nr. 7730/1 prot., datë 29.9.2020
8601	20/2	Vlorë	Gjergji Korabi	-	63.4	-	55,133.9	-	3.495.489.3	-	E pakonfirmuar sipërfaqja (referuar shkresës së ASHK-së nr. 7730/1 prot., datë 29.9.2020

VENDIM
Nr. 1119, datë 29.12.2020

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Gent Cakaj, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1124, datë 30.12.2020

PËR MONITORIMIN SHKENCOR PASVAKSINAL TË KAFSHËVE TË VAKSINUARA, NË KUADËR TË PROJEKTIT IPA 2017, "KONTROLLI DHE ÇRRËNJOSJA E SËMUNDJES SË TËRBIMIT – FAZA III"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 61/2016, "Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e gjuetisë së dhelprës së kuqe, për arsye të monitorimit shkencor pasvaksinal, që realizohet në kuadër të projektit IPA 2017, "Kontrolli dhe çrrënjosja e sëmundjes së tërbimit – faza III", të financuar nga Bashkimi Evropian.

2. Gjuetia e dhelprës së kuqe, me qëllim marrjen e kampioneve nga dhelprat, të kryhet në të gjithë territorin e vendit, me përjashtim të territorit të zonave të mbrojtura, në periudhën dhjetor 2020 – shkurt 2021, përgjatë 40 (dyzet) ditëve kalendarike, duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Brenda kësaj periudhe, gjuetia të kryhet në ditët e enjte, e premte dhe e shtunë.

3. Për vrasjen e dhelprave të kuqe, nëpërmjet gjuajtjes së tyre, të angazhohen në të gjithë vendin 39 (tridhjetë e nëntë) punonjës të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të pajisur me shenjë dalluese për këtë proces, që do të sigurojnë në total 324 (treqind e njëzet e katër) kampione të dhelprave të kuqe. Numri i personave që do të realizojnë vrasjen në çdo qark, si dhe numri i kampioneve të dhelprave që do të sigurohen për secilin qark jepen në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Detajimi i punonjësve përkatës që do të marrin pjesë në këtë proces të bëhet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Marrja e kampioneve nga dhelprat e kuqe bëhet nga Shërbimi Veterinar Rajonal i zonës përkatëse.

4. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pajis me autorizimin përkatës për marrjen e kampioneve të dhelprës së kuqe, për çdo qark punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, që do të marrin pjesë në këtë proces.

5. Gjatë të gjithë kohës së kryerjes së kësaj veprimtarie në zonat ku do të kryhet vrasja dhe marrja e kampioneve nga dhelprat, procesi do të kontrollohet nga strukturat vendore përgjegjëse për pyjet në njësitë e vetëqeverisjes vendore, shërbimet veterinare përkatëse dhe Policia e Shtetit.

6. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të bashkërendojë punën për marrjen e kampioneve të dhelprave të kuqe, dërgimin e tyre në laboratorët përkatës, analizimin dhe nxjerrjen e rezultateve, si dhe raportimin për përfundimin e kësaj faze të procesit të monitorimit pasvaksinal kundër sëmundjes së tërbimit të dhelprës së kuqe në Shqipëri.

7. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PËR MONITORIMIN SHKENCOR PASVAKSINAL TË KAFSHËVE TË VAKSINUARA, NË KUADËR TË PROJEKTIT IPA 2017, "KONTROLLI DHE Ç'RRËNJOSJA E SËMUNDJES SË TËRBIMIT – FAZA III"

NUMRI I GJUETARËVE PËR SIGURIMIN E KAMPIONEVE LABORATORIKE, NUMRI I KAMPIONEVE TË DHELPRAVE TË KUQE

Nr.	Qarku	Bashkia	Nr. i punonjësve në çdo qark	Nr. kampioneve të dhelprave të kuqe	
				Qark	Bashki
1	BERAT		5	21	
		Berat			12
		Kuçovë			2
		Skrapar			3
		Poliçan			2
		Ura Vajgurore			2
2	DIBËR		3	24	
		Dibër			10
		Bulqizë			7
		Mat			4
		Klos			3
3	DURRËS		3	10	
		Durrës			3
		Shijak			3
		Krujë			4
4	ELBASAN		3	37	
		Elbasan			8
		Belsh			4
		Cërrik			4
		Librazhd			5
		Përrenjas			4
		Peqin			4
		Gramsh			8
5	FIER		4	24	
		Fier			6
		Lushnjë			6
		Divjakë			3
		Roskovec			2
		Mallakastër			4
		Patos			3
6	GJIROKASTËR		2	38	
		Gjirokastër			12
		Libohovë			5
		Tepelenë			6
		Memaliaj			4
		Përmet			7

		Këlcyrë			2
		Dropull			2
7	KORÇË		4	53	
		Korçë			14
		Maliq			5
		Devoll			4
		Pustec			3
		Kolonjë			14
		Pogradec			13
8	KUKËS		1	20	
		Kukës			8
		Tropojë			11
		Has			1
9	LEZHË		5	12	
		Lezhë			3
		Kurbin			3
		Mirditë			6
10	SHKODËR		2	36	
		Shkodër			12
		Vau i Dejës			4
		Malësi e Madhe			14
		Pukë			4
		Fushë-Arrëz			2
11	TIRANË		5	13	
		Tiranë			4
		Vorë			2
		Kamzë			2
		Kavajë			3
		Rrogozhinë			2
12	VLORË		2	36	
		Vlorë			20
		Sarandë			2
		Konispol			2
		Finiq			4
		Delvinë			4
		Himarë			2
		Selenicë			2
	TOTALI		**39**		**324**

VENDIM
Nr. 1127, datë 30.12.2020

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, NGA FONDI REZERVË I BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e tij të miratuar për vitin 2020, në programin "Projekte zhvillimi", i shtohet fondi prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, që i transferohet Ndërmarrjes Industriale nr. 1 Tiranë, për kryerjen e pagesës pjesore të këstit të dytë të shitblerjes së godinës me numër pasurie nr. 1/645/ND, zona kadastrale 8210, Tiranë, sipas parashikimeve të nenit 2, të kontratës së shitjes nr. 180 rep., nr. 75 kol.

2. Efekti financiar, në masën 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekë, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Ndërmarrja Industriale nr. 1 Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1131, datë 24.12.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, të jetë në masën 5 130 260 797 (pesë miliardë e njëqind e tridhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH , nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 4 125 706 878 (katër miliardë e njëqind e njëzet e pesë milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH;

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 1 004 553 919 (një miliard e katër milionë e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh pa TVSH.".

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1142, datë 24.12.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË, TË MASËS SË PËRFITIMIT DHE MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDIT PËR SKEMËN E MBËSHTETJES ME NAFTË PËR BUJQËSINË, PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi prej 1 000 (një mijë) milion lekë, i miratuar në buxhetin e vitit 2021 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në programin buxhetor 04250 "Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun", për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë, do të përdoret për:

a) uljen e kostos së punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore;

b) rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore;

c) formalizimin e aktivitetit bujqësor.

2. Fondi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, detajohet, si më poshtë vijon:

a) 950 000 000 (nëntëqind e pesëdhjetë milionë) lekë (llogaria ekonomike 606) për sasinë e naftës dhe shpërndarjen e saj me kartë individuale drejtpërdrejt për subjektet përfituese;

b) 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë (llogaria ekonomike 231) për ngritjen e sistemit të shpërndarjes dhe monitorimit të naftës për bujqësinë (sistemi i menaxhimit të informacionit).

3. Subjekte përfituese nga skema e mbështetjes me naftë për bujqësinë do të jenë fermerët individualë, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, personat fizikë apo juridikë, të cilët kryejnë veprimtari bujqësore.

4. Subjektet përfituese mbështeten me sasi nafte falas, në barasvlerë të lehtësimit fiskal të naftës, që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kritereve dhe masës së përfitimit të përcaktuara në këtë vendim.

5. Kulturat bujqësore/grup-kulturat, normativat e konsumit të naftës dhe sasia respektive e naftës që përfitohet falas përcaktohen në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5.1. Si çmim referencë për naftën do të merret çmimi mesatar vjetor i botuar nga Agjencia e Prokurimit Publik në Buletinin e Njoftimeve Publike (rubrika "Të dhëna për karburantet", me burim informacioni Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave).

6. Subjektet përfituese duhet të plotësojnë këto kritere:

a) fermerët individualë të jenë të pajisur me NIPT-in e fermerit me status aktiv, ndërsa personat fizikë dhe juridikë të jenë të pajisur me NIPT-in/NUIS-in me status aktiv me aktivitet bujqësor;

b) të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe/ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës;

c) madhësia totale e fermës duhet të jetë me sipërfaqe jo më pak se 0.4 (zero pikë katër) ha, ndërsa madhësia e parcelave me sipërfaqe jo më pak se 0.1 (zero pikë një) ha.

7. Aplikimi, për të përfituar nga skema e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet *online* në portalin *e-Albania*, me vetëdeklarim.

8. Përfitimi i sasisë së naftës falas për sipërfaqen që kultivohet është, si më poshtë vijon:

a) 100% e sasisë për subjektet me sipërfaqe deri në 10 (dhjetë) ha, sipas përllogaritjeve të bëra, referuar aneksit 1 të këtij vendimi;

b) subjektet me sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha, për sipërfaqen deri në 10 (dhjetë) ha, përfitojnë sasitë sipas përcaktimit të shkronjës "a", të kësaj pike, ndërsa për pjesën tjetër mbi 10 (dhjetë) ha përfitojnë sasinë e naftës me normativë të reduktuar.

8.1. Normativa e reduktuar përllogaritet bazuar në nevojat për naftë të subjekteve me sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha, por jo më shumë se normativa e lejuar, si dhe në sasinë e mbetur të naftës në dispozicion, pasi janë plotësuar nevojat deri në 10 (dhjetë) ha të të gjitha subjekteve, që janë kualifikuar si përfituese.

9. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me akt të ministrit, caktohet një njësi e posaçme, ku mund të angazhohen edhe burime *ad hoc*, për të garantuar zbatimin, monitorimin dhe koordinimin e të gjithë procesit që lidhet me skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë.

10. Procesi i verifikimit/kontrollit administrativ të aplikimeve, kualifikimit, vlerësimit dhe përcaktimit të përfituesve nga skema e mbështetjes së naftës për bujqësinë do të kryhet nga agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor.

11. Procesi i kontrollit në terren, pas shpërndarjes së naftës te subjektet përfituese, kryhet nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

12. Për të menaxhuar procesin e shpërndarjes e të monitorimit të naftës për bujqësinë ngrihet sistemi i menaxhimit të informacionit, nën administrimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si një instrument që do të mundësojë:

a) menaxhimin e aplikimeve *online* të subjekteve, nëpërmjet grumbullimit dhe shqyrtimit administrativ të tyre nga agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor, si dhe vlerësimin e sasisë së naftës që përfitohet, mbështetur në vetëdeklarim dhe te sipërfaqet e tokës bujqësore e kulturat bujqësore të deklaruara;

b) menaxhimin e shpërndarjes së kartave individuale të naftës te subjektet përfituese, si dhe gjurmimin e tërheqjeve të naftës prej tyre;

c) përzgjedhjen e subjekteve përfituese që do t'i nënshtrohen kontrollit në terren nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe menaxhimin e këtij procesi, i cili do të vlerësojë përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale në terren;

ç) gjenerimin e raportimeve të ndryshme, në faza të caktuara të zbatimit të skemës, sipas kërkesave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

13. Nafta për prodhim bujqësor do të shpërndahet nga operatorët furnizues të kontraktuar në bazë të përzgjedhjes, sipas procedurave ligjore prokuruese kuadër, nëpërmjet pikave të tyre të shpërndarjes në të gjithë vendin, ku fermerët paraqiten me kartën individuale, në të cilën është hedhur sasia e naftës që ka të drejtë të tërheqë fermeri përkatës.

13.1 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural realizon procedurat e prokurimit për blerjen dhe shpërndarjen e naftës për përdorim nga fermerët në sektorin e bujqësisë, në zbatim të vendimit nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime", të ndryshuar, si dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 11, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", për nisjen e procedurave të prokurimit në vitin korrent, nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për vitin 2021.

13.2 Likuidimi i pagesave për furnizuesit e kontraktuar të naftës bëhet në bazë mujore në përputhje me sasinë e naftës së shpërndarë te përfituesit.

14. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural:

a) të vlerësojë përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale në terren dhe shmangien e lejuar e faktit të verifikuar të kulturave dhe sipërfaqes së kultivuar në raport me naftën e tërhequr, e cila të jetë jo më e madhe se 20%;

b) të kryejë kontrolle në terren për jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e të gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha.

15. Çdo subjekt, që përfiton nga skema e mbështetjes me naftë për bujqësinë, me shmangie më të madhe se 20%, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 14, të këtij vendimi, ose me deklarime/dokumente të pasakta, përjashtohet për 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

Referuar paragrafit të parë të kësaj pike, subjektet me status fizik dhe juridik shpallen edhe debitor për vlerën e përfituar në mënyrë të padrejtë.

16. Kriteret specifike, procedurat dhe mënyra e administrimit të skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë përcaktohen me udhëzim të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

17. Të gjitha përcaktimet në lidhje me punimet e mekanizuara në bujqësi të vendimit nr. 703, datë 16.11.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për furnizimin me karburant, pa akcizë, për mekanikën bujqësore, serrat me ngrohje dhe subjektet që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit", si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

18. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI 1
KULTURAT BUJQËSORE/GRUP-KULTURAT, NORMATIVAT E KONSUMIT TË NAFTËS DHE SASIA E NAFTËS QË PËRFITOHET FALAS

Nr./kodi	Kultura bujqësore/grup kulturash	Normativa e konsumit të naftës të punimeve të mekanizuara	Sasia e naftës që përfitohet falas*	Specifikime
		L/ha	L/ha	
A	**Bimë arash**			
A.1	*Grupi 1*	190	***106***	Pranverore (misër, fasule, luledielli, sojë, sorgum)
A.2	*Grupi 2*	130	***73***	Të lashta (grurë, tërshërë, thekër, elb), Foragjere njëvjeçare, industriale (patate, duhan, panxhar, pambuk)
A.3	*Grupi 3*	90	***50***	Foragjere shumëvjeçare, Bimë aromatiko-mjekësore
B	**Dru frutor**			
B.1	Mollë	190	***106***	
B.2	Drurë frutorë të tjerë	160	***90***	Të gjitha llojet e frutave, agrume dhe vreshta
B.3	Arrore	140	***78***	Arra, bajame, lajthi dhe gështenja
B.4	Prodhim i fidanëve frutorë, agrume e arrore	170	***95***	Për të gjithë fidanët e bimëve farore, bërthamore dhe arrore
C	**Perime**			
C.1	Perime fushe sezoni 1	150	***84***	Të gjitha llojet e perimeve përfshirë shalqi, pjepër, luleshtrydhe
C.2	Perime fushe sezoni 2	120	***67***	Të gjitha llojet e perimeve
C.3	Perime serre Sezoni 1	170	***95***	Të gjitha llojet e perimeve
C.4	Perime serre Sezoni 2	140	***78***	Të gjitha llojet e perimeve

**** Nga çmimi mesatar vjetor i naftës zbriten:***
- Akciza 37 lekë/L
- Taksa e qarkullimit 27 lekë/L
- Taksa e karbonit 3 lekë/L

Nëntotal 67 lekë/L
TVSH respektive (20%)13,4 lekë/L

TOTAL 80,4 lekë/L

***** Koeficienti i përfitimit të naftës falas mbi normativë = 80,4 lekë/144.2[3] *100 = 56%***

[3] Çmimi mesatar vjetor i naftës është përllogaritur mbi të dhënat e publikuara nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP), për periudhën janar–tetor 2020.

VENDIM
Nr. 1146, datë 24.12.2020

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT PËR PASURINË NR. 109, ME EMËRTIM "SHA RIPARIM ARTILERIE", E PËRBËRË NGA DISA SIPËRFAQE, TRUALL FUNKSIONAL DHE OBJEKTE, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 43 169 m², DHËNË ME KONTRATË ME ÇMIMIN 1 EURO/KONTRATA FONDACIONIT "FUNDJAVË NDRYSHE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve", të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008; të pikës 32, kreu III, të vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për fillimin e procedurave të privatizimit për pasurinë nr. 109, me emërtim "Sh.a. riparim artilerie", e përbërë nga disa sipërfaqe, truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43 169 m², dhënë me qira me kontratën me çmimin 1 euro/kontrata dhe miratuar me vendimin nr. 113, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe fondacionit 'Fundjavë ndryshe', si qiramarrës, për pasurinë nr. 109, me emërtim 'Sh.a. riparim artilerie', e përbërë nga disa sipërfaqe, truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43 169 m²".

2. Me nënshkrimin e kontratës së shitjes së pasurive shtetërore të sipërcituara, vendimi nr. 113, datë 13.3.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe Fondacionit 'Fundjavë ndryshe', si qiramarrës, për pasurinë nr. 109, me emërtim 'Sh.a. riparim artilerie', e përbërë nga disa sipërfaqe, truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43 169 m²", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 210, datë 15.12.2020

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENERGIJA DOO VETERNIK" SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "d", nenit 5, pika 1, germa "d" dhe të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k., si dhe relacionin nr. 132/1 prot., datë 10.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "*Energija*

DOO Veternik" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1086/2 prot., datë 26.10.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në datën 6.1.2015 është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

- Aplikimi i shoqërisë "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c"). Plotësuar tërësisht.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d" dhe "e"). Plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c" dhe "d"). Plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacionin teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat: "a", "b", "c", "e", "d", "f"). Plotësuar pjesërisht.

- Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4.7, germat: "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g", "h", "i"). Plotësuar pjesërisht.

- Në mbledhjen e Bordit të ERE-s, të datës 2.12.2020, në vijim të relatimit të relacionit nr. 125/2 prot., datë 1.12.2020, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë '*Energija DOO Veternik*' në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike" dhe relacionit nr. 125/3 prot., datë 1.12.2020, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë '*Energija DOO Veternik*' në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike", Bordi gjykoi që vendimi i fillimit të procedurave për këto aplikime të shtyhej, në mënyrë që shoqëria të kryejë diferencën e pagesës së aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, duke qenë se rezultoi se kjo pagesë nuk ishte kryer e plotë.

- Në vijim të sa më sipër, ERE iu drejtua shoqërisë me *email*-in e datës 2.12.2020, protokolluar në po të njëjtën datë me nr. 1086/3 prot., duke i bërë me dije se në kuptim të nenit 8, pika 2, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", aplikuesi do të kryej pagesën e aplikimit në momentin e paraqitjes së aplikimit, siç përcaktohet në aneksin A të saj. Po në kuptim të këtij neni një aplikim duhet të jetë i shoqëruar me pagesën e aplikimit e më tej të vijohet me trajtimin e tij. Po ashtu iu kërkua shoqërisë kryerja e pagesave respektive në llogarinë e ERE-s me qëllim trajtimin e kërkesës për licencim në mbledhjen më të afërt të Bordit të ERE-s, dhe iu shpjegua se kryerja e pagesës së aplikimit përbën një nga kushtet thelbësore për fillimin e një procedure.

- Shoqërisë i janë dhënë edhe më herët sqarimet përkatëse për aplikimin e ri për licencim me *email*-in e datës 26.10.2020.

- Nga rakordimi me Drejtorinë e Financës dhe IT nuk rezulton që deri më sot shoqëria të ketë kryer pagesat respektive, si më sipër kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 211, datë 15.12.2020

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "*ENERGIJA DOO VETERNIK*" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e"; të nenit 5, pika 1, germa "e"; të nenit 10, pika 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "*Energija Doo Veternik*" sh.p.k., si dhe relacionin nr. 132/1 prot., datë 10.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1086/2 prot., datë 26.10.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në datën 6.01.2015 është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

- Aplikimi i shoqërisë "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c") është plotësuar tërësisht;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d" "e", "f" dhe "g") është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8; germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c"), është plotësuar pjesërisht.

- Në mbledhjen e Bordit të ERE-s, të datës 2.12.2020, në vijim të relatimit të relacionit nr. 125/2 prot., datë 1.12.2020, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "'*Energija DOO Veternik*' në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike" dhe relacionit nr. 125/3 prot., datë 1.12.2020, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë '*Energija DOO Veternik'* në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike", Bordi gjykoi që vendimi i fillimit të procedurave për këto aplikime të shtyhej, në mënyrë që shoqëria të kryejë diferencën e pagesës së aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, duke qenë se rezultoi që kjo pagesë nuk ishte kryer e plotë.

- Në vijim të sa me sipër, ERE iu drejtua shoqërisë me *email*-in e datës 2.12.2020, protokolluar në po të njëjtën datë me nr. 1086/3 prot., duke i bërë me dije se në kuptim të nenit 8, pika 2 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", aplikuesi do të kryej pagesën e aplikimit në momentin e paraqitjes së aplikimit, siç përcaktohet në aneksin A të saj. Po në kuptim të këtij neni një aplikim duhet të jetë i shoqëruar me pagesën e aplikimit e më tej të vijohet me trajtimin e tij. Po ashtu iu kërkua shoqërisë kryeja e pagesave respektive në llogarinë e ERE-s me qëllim trajtimin e kërkesës për licencim në mbledhjen më të afërt të Bordit të ERE-s, dhe iu shpjegua se kryerja e pagesës së aplikimit përbën një nga kushtet thelbësore për fillimin e një procedure.

- Shoqërisë i janë dhënë edhe më herët sqarimet përkatëse për aplikimin e ri për licencim me *email*-in e datës 26.10.2020.

- Nga rakordimi me Drejtorinë e Financës dhe IT nuk rezulton që deri më sot shoqëria të ketë kryer pagesat respektive, si më sipër kërkuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 212, datë 15.12.2020

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR. 266, DATË 21.12.2018

Në mbështetje të: i. nenit 16; ii. nenit 19, germa "c", pika "i"; iii. nenit 20, germa "c"; iv. nenit 21; dhe v. nenit 55, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Enti Rregullator i Energjisë (ERE) nr. 180, datë 8.11.2017, si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "c", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 132/8 prot., datë 11.12.2020, të Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, konstatoi se:

- Shoqëria "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST sh.a.) me shkresën nr. 5686 prot., datë 24.9.2020, ka paraqitur kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021, sipas materialit që OST sh.a. i ka bashkëngjitur kësaj shkrese.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 163, datë 22.10.2020, ka vendosur mosfillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021.

- Në vijim, shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 6731, datë 9.11.2020, ka paraqitur një kërkesë për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 163, datë 22.10.2020, "Mbi aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 206, datë 11.12.2020, ka miratuar rrëzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 163, datë 22.10.2020, "Mbi mosfillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., lidhur me miratimin e tarifës së kërkuar prej 1.31 lekë/kwh, për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021".

- Në vijim të sa më sipër evidentuar, dhe në kushtet kur:

- aplikimi i paraqitur nga shoqëria OST sh.a., për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021, është refuzuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 163, datë 22.10.2020;

- kërkesa për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 163, datë 22.10.2020, "Mbi mosfillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., lidhur me miratimin e tarifës së kërkuar prej 1.31 lekë/kwh, për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021", është refuzuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 206, datë 11.12.2020;

- në mënyrë që shoqëria OST sh.a. të mund të vijojë realizimin e aktivitetit të saj dhe përgjatë vitit 2021, sipas kushteve të licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, të lëshuar në përputhje me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, bëhet e domosdoshme që shoqëria të vijojë faturimin

bazuar në tarifën e transmetimit të miratuar nga ERE;

- në vlerësimet e ERE-s, llogaritet se tarifa aktuale e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike i ka krijuar shoqërisë OST sh.a rezerva të ardhurash të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative, ku përfshihet dhe prokurimi i shërbimeve ndihmëse në tregun e lirë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, deri në aplikimin për përcaktimin e tarifave të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a., në përputhje me kërkesat e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë OST sh.a., tarifa mesatare e transmetimit do të axhustohet/korrigjohet në zbatim të përcaktimeve të pikës 7, të nenit 11, të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike" të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga data 1.1.2021.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 213, datë 15.12.2020

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR. 199, DATË 12.12.2019

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, nenit 20, germa "c", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "c", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve nr. 132/8 prot., datë 11.12.2020, në lidhje me lënien në fuqi të vendimit nr. 199, datë 12.12.2019,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 10.1.2020, ka miratuar fillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit të OSSH sh.a., për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit, për vitin 2020.

- ERE, me shkresën me nr. 201, datë 27.1.2020, ka kërkuar opinion lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 2, datë 10.1.2020, palëve të interesuara si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti i Konkurrencës, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Shoqata e Furnizuesve të Energjisë Elektrike.

- ERE, në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, ka pasur një sërë korrespondencash lidhur me plotësimet e dokumentacionit të nevojshëm nga ana e shoqërive OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a., si dhe dhënien e argumenteve plotësuese mbi komponentët e përcaktimit të tarifave të rrjetit të shpërndarjes, si dhe çmimeve të shitjes me pakicë.

- Në vijim të situatës së paprecedentë të krijuar nga pandemia COVID-19, për shkak të pamundësisë për zbatimin e parashikimeve të

legjislacionit në fuqi sa i përket diskutimit publik e organizimit të seancave dëgjimore me palët e interesit, masave kufizuese të marra nga Qeveria Shqiptare për kufizimin e përhapjes së virusit COVID-19, si dhe në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "c", nenit 85, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të VKM-së nr. 243, datë 24.3.2020, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore"; nenit 67 dhe 91, pika 4, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë"; nenit 15 dhe 22, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s"; Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 67, datë 8.4.2020, vendosi pezullimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, OSSH sh.a., për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit, për vitin 2020, deri jo më vonë se 3 muaj nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë.

- Në kushtet e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike dhe të tëdrejtës së klientëve fundorë për të zgjedhur lirisht furnizuesin e tyre të energjisë elektrike, me përjashtim të klientëve fundorë të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, për të cilët ERE ka miratuar tarifën e shpërndarjes prej 1.5 lekë/kwh, dhe klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 20 kV, për të cilët ERE ka miratuar tarifën e shpërndarjes prej 3.9 leke/kwh; për të gjithë klientët e tjerë fundorë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tjera të tensionit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të faturojë energjinë e lëvruar bazuar në tarifën mesatare të shpërndarjes së energjisë elektrike prej 4.79 lekë/kWh, të miratuar nga ERE.

- Shoqëria OSSH sh.a. nuk ka mundur të paraqesë informacionin e kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, me anë të një sërë korrespondencash nga ana e ERE lidhur me realizimin e treguesve tekniko-ekonomik dhe financiar të shoqërive, përgjatë vitit 2020.

- Parashikimet e shoqërisë OSSH sh.a., të paraqitura në kërkesën për shqyrtimin e aplikimit për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit, për të cilën tashmë me vendimin nr. 2, datë 10.1.2020, Bordi i ERE-s ka miratuar fillimin e procedurës, nuk mund të merren për bazë për arsye se tashmë jemi në muajin e fundit të vitit 2020, ndaj çdo e dhënë e depozituar më herët ka humbur aktualitetin dhe nuk paraqet një pasqyrë reale të rrethanave të faktit.

- Në aplikimin e paraqitur dhe korrespondencat e mëtejshme me shoqërinë OSSH sh.a, mungojnë të dhëna mbi ndarjen e bazës së rregulluar të aseteve dhe nivelin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për nivelet e ndryshme të tensionit ku operon Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (35/20/10/6/0.4 kV).

- Nga vlerësimet e kryera, mbi të dhënat e vëna në dispozicion në kuadër të raportimeve periodike, llogaritet se tarifat aktuale të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, i mundësojnë shoqërisë OSSH sh.a. të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve nga aktiviteti i licencuar.

- Metodologjia për llogaritjen e tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, të miratuara nga ERE, bëjnë të mundur korrigjimin e të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar, për të ardhurat, për vitin paraardhës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së nisur me anë të vendimit nr. 2, datë 10.1.2020, për shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike, për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit, për vitin 2020.

2. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2021, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Drejtoria Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga 1.1.2021.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 214, datë 15.12.2020

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR. 200, DATË 12.12.2019

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, nenit 20, germa "c", nenit 83 dhe nenit 85, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "c", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve nr. 132/8 prot., datë 11.12.2020, në lidhje me lënien në fuqi të vendimit nr. 200, datë 12.12.2019,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 10.1.2020, ka miratuar fillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë, për klientët që shërbehen nga FSHU sh.a., për vitin 2020.

- Me shkresën e ERE-s nr. 201, datë 27.1.2020, u është kërkuar opinioni lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 2, datë 10.1.2020, palëve të interesuara si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti i Konkurrencës, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Shoqata e Furnizuesve të Energjisë Elektrike.

- ERE, në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, ka pasur një sërë korrespondencash lidhur me plotësimet e dokumentacionit të nevojshëm nga ana e shoqërive OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a., si dhe dhënien e argumenteve plotësues mbi komponentët e përcaktimit të tarifave të rrjetit të shpërndarjes, si dhe çmimeve të shitjes me pakicë.

- Në vijim të situatës së paprecedentë të krijuar nga pandemia COVID-19, për shkak të pamundësisë për zbatimin e parashikimeve të legjislacionit në fuqi sa i përket diskutimit publik e organizimit të seancave dëgjimore me palët e interesit, masave kufizuese të marra nga Qeveria Shqiptare për kufizimin e përhapjes së virusit COVID-19, si dhe në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "c", nenit 85, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të VKM-së nr. 243, datë 24.3.2020, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore"; nenit 67 dhe 91, pika 4, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", neneve 15 dhe 22, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s"; Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 67, datë 8.4.2020, vendosi pezullimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a., për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë, për klientët që shërbehen nga ky i fundit, për vitin 2020, dhe shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit, për vitin 2020, deri jo më vonë se 3 muaj nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë.

- Shoqëria FSHU sh.a. nuk ka mundur të paraqesë informacionin e kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, me anë të një sërë korrespondencash nga ana e ERE-s, lidhur me realizimin e treguesve tekniko-ekonomik dhe financiar të shoqërive, përgjatë vitit 2020.

- Parashikimet e shoqërisë FSHU sh.a., të paraqitura në kërkesën për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë, për vitin 2020, për të cilën me vendimin nr. 2, datë 10.1.2020, Bordi i ERE-s ka miratuar fillimin e procedurës, nuk mund të merren për bazë për arsye se tashmë jemi në muajin e fundit të vitit 2020, ndaj çdo e dhënë e depozituar më herët ka humbur aktualitetin dhe nuk paraqet një pasqyrë reale të rrethanave të faktit.

- Nga vlerësimet e kryera mbi të dhënat e vëna në dispozicion, në kuadër të raportimeve periodike, llogaritet se tarifat aktuale të çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike i mundësojnë shoqërisë FSHU sh.a. të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve nga aktiviteti i licencuar.

- Metodologjitë për llogaritjen e tarifave për përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU), të miratuara nga ERE, bëjnë të mundur korrigjimin e të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar, për të ardhura për vitin paraardhës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së nisur me anë të vendimit nr. 2, datë 10.1.2020, për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a., për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë, për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, për vitin 2020.

2. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 200, datë 12.12.2019, deri në miratimin e një vendimi, mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a., për vitin 2021, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë FSHU sh.a., korrigjimi i tyre do të bëhet mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës, sipas përcaktimeve të germës "g", të pikës 1, të nenit 7, të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)" të miratuar me vendimin nr. 189, datë 23.11.2017.

4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga data 1.1.2021.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 215, datë 15.12.2020

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË 16.12.2019, "MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ALBGAZ SHA", PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 13, pika 1; nenit 16, pika 2; neni 17, germa "e" dhe nenit 33, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; si dhe nenit 21, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve nr. 132/9 prot., datë 11.12.2020, në lidhje me lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 60, datë 15.4.2019, "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a., për vitin 2021",

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 60, datë 15.4.2019, Bordi i ERE-s vendosi: "Miratimin e përkohshëm të tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. prej 28 lek/m^3 ose 2.6457 lek/kwh, deri më 31.12.2019".

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, është miratuar lënia në fuqi e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 60, datë 15.4.2019, "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a., për vitin 2020".

- Në kushtet kur shoqëria ALBGAZ sh.a.:

- nuk ka paraqitur ende aplikim për rishikimin e tarifës së transmetimit, për periudhën e ardhshme rregullatorë, në zbatim të pikës 1, të nenit 21, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s";

- në vijim të paraqitjes së planit të zhvillimit të rrjetit, për periudhën 2019–2028, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, nga ana e ERE-s është kërkuar qëndrimi i shoqërisë Albgaz sh.a. në lidhje me zbatueshmërinë e planit 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit, si pasojë e konstatimeve të ERE-s mbi

planin dhe situatën e krijuar nga gjendja e pandemisë në Republikën e Shqipërisë;

- tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria Albgaz sh.a., i cili ushtrohet konform ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe direktivave të Komunitetit të Energjisë, ku aksesi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t'i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE;

- nuk ka paraqitur ende pasqyrat financiare për vitin 2019, si rrjedhojë edhe e shtyrjes së afatit nga qeveria shqiptare për pasojë të situatës së krijuar nga gjendja e jashtëzakonshme, shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s, për vitin 2021, deri në miratimin e një tarife mbështetur në aplikimin e shoqërisë Albgaz sh.a.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë Albgaz sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika "e", të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga data 1.1.2021.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 216, datë 15.12.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST SHA PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 169, DATË 3.11.2020, "PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2020 DHE ATË TË PËRDITËSUAR, DHJETËVJEÇAR, 2015–2025, TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT, TË SHOQËRISË OST SHA"

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar,; nenit 91 dhe 92, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative"; nenit 16, pika 2, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016;, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 132/6 prot., datë 11.12.2020, të Drejtorive Teknike, mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 169, datë 3.11.2020, u shpreh në lidhje me kërkesën e OST sh.a. për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

- Vendimi i sipërcituar, i është dërguar për dijeni OST sh.a. në mënyre elektronike, më datë 11.11.2020, nëpërmjet komunikimit me *email*, me qëllim njohjen me përmbajtjen përfundimtare të këtij dokumenti.

- OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 6567 prot., datë 18.11.2020, ka parashtruar në ERE kërkesën për rishikim të vendimit nr. 169, datë 3.11.2020, "Mbi kërkesën e OST sh.a. për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.", ku ndër të tjera parashtron:

- OST sh.a. shpreh gatishmërinë e saj të plotë për të plotësuar, në kohë dhe në koordinim me stafin e ERE-s, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të arritur në një

vendimmarrje nga ana juaj, në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit (të parashikuara në nenet 12 dhe 14, të Kodit të Procedurave Administrative).

- ERE kërkoi nga OST sh.a. informacionin shtesë dhe dokumentacionin e pretenduar në shkresën e sipërcituar. Në të njëjtën kohë është përgatitur shkresa përkatëse për OST sh.a. ku ndër të tjera i kërkohet, si më poshtë vijon:

- të bëj me dije fazën aktuale në të cilën është përgatitja e këtij udhëzuesi, i cili do të përfshijë të gjithë komponentët e nevojshëm të llogaritjes kosto – përfitim; nëse është përgatitur ndonjë draft konkret i udhëzuesit dhe nëse ka një draft konkret të këtij udhëzuesi, ky draft të përcillet në ERE;

- për të evidentuar nëse janë zbatuar përcaktimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 194, datë 3.12.2019, dhe ato të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, kërkohet të bëhet me dije nëse janë hapur llogari të ndara për aktivitetin komercial të fibrës optike. Nëse këto llogari janë hapur, periudhën kur janë hapur, si dhe gjendjen e tyre;

- OST sh.a. parashtron se janë realizuar analiza për planin e investimeve për vitin 2020. Analizat e përmendura nuk janë përcjell nga OST sh.a. në ERE në momentin e paraqitjes për miratim, si dhe në periudhën në vijim gjatë shqyrtimit të këtij plani. Në këto kushte kërkohet që OST sh.a. të përcjellë në ERE analizat e përmendura në shkresën e sipërcituar, për elementët të cilët përfshihen në planin e investimeve të OST sh.a., për vitin 2020;

- të bëjë me dije nëse detyrimet ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhen me aktivizimin e mekanizmit të garancisë sovrane për pagesat e kredive të marra nga institucionet ndërkombëtare apo janë detyrime të tjera. Në këtë kontekst, përcaktimet e VKM-së nr. 253, datë 24.4.2019, "Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjitik", duhet të vlerësohen se cilat janë arsyet e aktivizimit të mekanizmit të garancisë sovrane për të paguar kreditë në institucionet ndërkombëtare nëpërmjet fondeve të buxhetit të shtetit dhe jo nëpërmjet fondeve të vetë OST sh.a.;

- lidhur me sa parashtruar nga OST sh.a., mbi hartimin e masterplanit të zhvillimit, aktualisht jemi në muajin dhjetor 2020, kërkohet të bëhet me dije statusi i masterplanit nëse është hartuar një draft i tillë nga konsulenca dhe nëse OST sh.a. e disponon një draft të tillë mund ta përcjellë në ERE si një draft paraprak të masterplanit të zhvillimit të rrjetit;

- duke marrë në konsideratë faktin se OST sh.a., me shkresën nr. 6567 prot., datë 18.11.2020, shprehet e gatshme të përcjellë informacionin në ERE dhe për sa kërkuar me tonën nr. 993/3 prot., datë 24.9.2020, në këto kushte kërkohet të përcillet në ERE informacioni i kërkuar me tonën nr. 993/3 prot., datë 24.9.2020;

- në përfundim, i gjithë dokumentacioni i kërkuar në shkresën e ERE-s, si dhe çdo informacion ose analizë që OST sh.a. disponon për këtë qëllim, të përcillet në ERE, brenda 7 (shtatë) ditëve, në mënyrë që ERE të mund të vlerësojë sa kërkuar nga OST sh.a. me shkresën nr. 6567 prot., datë 18.11.2020.

- Për të analizuar të gjithë elementët e cituar më sipër, në mënyrë që të jepet një gjykim dhe argumentim i drejtë, i saktë dhe shterues i kërkesës së parashtruar nga OST sh.a., ERE-s i duhet më tepër kohë për të gjykuar dhe vlerësuar gjithë parashtrimet e bëra dhe të kërkuara nga OST sh.a., me qëllim ezaurimin e procedurës administrative dhe marrjen e një vendimi mbi këtë çështje, si dhe është përcaktuar përkatësisht në nenet 91 dhe 92, të Kodit të Procedurave Administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga shoqëria OST sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, "Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.", deri në 30 ditë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palën e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 217, datë 15.12.2020

MBI RISHIKIMIN E "PLANIT TË MASAVE PËR OPERATORIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE 'OSHEE' SHA, PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË KLIENTËVE TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE", TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 201, DATË 3.9.2018

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; Detyrave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, për Veprimtarinë e Entit Rregullator të Energjisë, si dhe nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve nr. 132/3 prot., datë 10.12.2020, mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 3.9.2018, për miratimin e "Planit të masave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike 'OSHEE' sh.a. për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike",

konstatoi se:

- Me qëllim ndjekjen e detyrave të rezolutës, ERE, me vendimin nr. 123, datë 17.7.2020, ka miratuar kalendarin e masave për fillimin e zbatimit dhe ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë, për vitin 2019, miratuar nga ana e Kuvendit, e mbi këtë kalendar ka vijuar ndjekjen e detyrave të lëna nga rezoluta nga strukturat e ngarkuara për ndjekje.

- Konkretisht, në pikën 7, të rezolutës së Kuvendit, është parashikuar që: "ERE të vijojë punën për monitorimin dhe përditësimin e planit të masave në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, sipas fushës së veprimtarisë së shoqërive të ndara tashmë, si dhe të ndjekë zbatimin me rigorozitet të gjetjeve dhe vërejtjeve të bëra gjatë monitorimit duke u fokusuar në zgjidhjen e ankesave të klientëve me përgjegjësi dhe në kohë sa më të shkurtër". Gjithashtu, t'i kushtojë vëmendje procedurës se si merr dijeni klienti për trajtimin e ankesës, për të bërë të mundur dokumentimin e informimit të çdo klienti ankues për rezultatin e trajtimit të ankesës nga OSHEE-ja, si një aspekt shumë i rëndësishëm i transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 201, datë 3.9.2018, për miratimin e "Planit të masave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike".

- ERE, me qëllim respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike, ka miratuar këtë paketë me rregulla e të drejta, e detyrime të palëve me qëllim mbrojtjen e klientit të energjisë elektrike dhe përcaktimit të mjeteve të domosdoshme të mbikëqyrjes nga ana e ERE-s, me qëllim garantimin e tyre nga ana e FSHU sh.a. Në këtë plan masash identifikohen qartësisht përgjegjësitë e furnizuesit, në kuadër të detyrimit të shërbimit publik të tilla si: e drejta e informimit, aksesit të konsumatorit ndaj shërbimeve, e drejta për të paraqitur ankesë ndaj shërbimit të ofruar, e drejta e zgjedhjes, e drejta e zgjedhjes së modaliteteve të pagesave, e drejta e zgjedhjes së furnizuesit, e drejta për t'u informuar për çmimet.

- Për sa më sipër, duke u mbështetur në detyrat e lëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, gjendja e faktit që lidhet me ndarjen efektive të Furnizuesit të Shërbimit Universal nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, lind nevoja e përditësimit të këtij plani masash me qëllim reflektimin e sa më sipër, si dhe përmirësimin e përditësimin e atyre dispozitave që lidhen me detyra të lëna në këtë plan e për të cilat ERE ka dijeni se kanë ndryshuar për shkak të monitorimeve të ushtruara ndaj shoqërisë përgjatë vitit 2019 e 2020.

Konkretisht këto ndryshime janë reflektuar, si në vijim:

- Kudo në tekst, OSHEE sh.a. zëvendësohet me FSHU sh.a. (Furnizuesi i Shërbimit Universal).

- Në "Ushtrimi i përgjegjësive nga ERE realizohet kryesisht përmes aktiviteteve të mëposhtme" ndryshohet, Sektori i Mbrojtjes së konsumatorit me Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit Performancës dhe Standardeve.

- Në dispozitat e "Veprimet në kuadër të detyrimit për informim", shtohen:

"1. Furnizuesi ka detyrimin të njoftojë në çdo rast klientin që ka paraqitur një ankesë për

zgjidhjen e dhënë zyrtarisht, dhe jo vetëm ta zgjidhë.

2. Furnizuesi ka detyrimin të njoftojë klientin mbi të drejtën e ushtrimit të ankesës te Furnizuesi dhe në ERE.".

- Në dispozitat: "Veprimet në kuadër të detyrimit për trajtim të barabartë të klientëve të energjisë elektrike" shtohet:

"1. Të masë nivelin e kënaqësisë së klientëve nëpërmjet organizimit të anketave që adresojnë në mënyrë të posaçme, kohën e kthimit të përgjigjeve dhe zgjidhjeve për problematikat e adresuara prej tyre.

2. Të administrojë dhe të bëjë vlerësimet përkatëse në analizë të gjetjeve nga komentet e klientëve dhe të publikojë këto rezultate në faqen zyrtare.".

- Në dispozitat e: "Veprimet në kuadër të detyrimit për akses në shërbime", shtohet:

"1. Furnizuesi të mbajë një database të opinioneve/propozimeve të stafit apo klientëve me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe mënyrës së adresimit të tyre.".

- Në dispozitën: "Veprimet në kuadër të detyrimit për trajtimin e ankesave", shtohet:

"1. Të sigurohet se stafi është në gjendje të adresojë në çast problematikat që lidhen me marrjen e informacionit të kërkuar nga klienti.".

- Në dispozitat: "Monitorimi dhe raportimi", shtohet:

"1. Kodi i etikës dhe i sjelljes i punonjësve të qendrave të kujdesit të klientit duhet t'i bëhet me dije stafit.

2. Pas mbledhjes dhe analizimit të rezultateve të anketimit, furnizuesi, brenda 12 muajve nga marrja e rezultatit të anketës, do të hartojë një plan veprimi të ri, i cili do të përqendrohet në fushat për përmirësim të theksuar në rezultate dhe progres kundrejt standardeve të vendosura. Ky plan veprimi do të paraqitet për miratim në ERE.".

- Në dispozitat: "ERE do të kryejë monitorime specifike në lidhje me.." shtohet:

"1. Statusin e ankesave të përsëritura.".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë disa shtesa dhe ndryshime në "Planin e masave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike 'OSHEE' sh.a. për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 3.9.2018.

2. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

PLANI I MASAVE
PËR FURNIZUESIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL "PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË KLIENTËVE TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE"

Neni 1
Hyrje

Në zbatim të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ERE ka të drejtën dhe detyrën për të monitoruar, kontrolluar dhe inspektuar shërbimet e operatorëve të licencuar në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore, kushteve të shërbimit publik, kushteve të kontratës, si dhe zbatimin e vendimeve dhe urdhrave të ERE-s. Misioni i ERE-s, ndër të tjera, përfshin një treg energjie që reflekton një shërbim të mirë për klientët familjarë dhe jofamiljarë të shërbyer nga Furnizuesi i Shërbimit Universal dhe furnizuesit e tjerë.

Vizioni i ERE-s është për një treg të hapur dhe konkurrues ku klientët mbrohen dhe marrin shërbim të sigurt dhe brenda cilësisë së miratuar sipas ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

Neni 2
Qëllimi i ERE-s për mbrojtjen e klientit

1. Autoriteti i ERE-s, për mbrojtjen e klientit ka si qëllim:

a) mbrojtjen e interesave të klientëve në tërësi, bazuar në një trajtim të barabartë dhe

jodiskriminues, përmes procedurave ligjore e transparente;

b) monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve që ofron i licencuari ndaj klientëve të energjisë elektrike;

c) të promovojë përfitimet e konkurrencës dhe të mbrojtjes së klientit përmes ndërgjegjësimit publik;

d) të informojë klientët për të bërë zgjedhje mbi bazën e informacionit të siguruar si pjesë e shërbimit publik, për të mbështetur kështu të drejtat e tyre përfshirë të drejtën e zgjedhjes së furnizuesit të energjisë elektrike.

2. Ushtrimi i përgjegjësive nga ERE realizohet kryesisht përmes aktiviteteve të mëposhtme:

Zbatimi i ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.

a) ERE është autoriteti përgjegjës për zbatimin e ligjit për sektorin e energjisë elektrike nga të licencuarit;

b) ERE kryen monitorime, dhe kërkon nga të licencuarit zbatimin e ligjit dhe korrigjimin e efekteve kur konstaton mosrespektim të legjislacionit në fuqi;

c) aktet rregullatore që ERE miraton reflektojnë jo vetëm kërkesat që lidhen me zbatimin e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", por edhe kërkesat që lindin nga zbatimi i ligjit për mbrojtjen e klientit, të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

d) në çdo rast, kuadri rregullator përfshin, gjithashtu, edhe detyrimet që lidhen me angazhimin e vendit tonë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, direktivat e BE-së për mbrojtjen e klientit në të gjitha fazat e një procesi që lidhet me shërbimin e furnizimit me energji elektrike;

e) për të trajtuar shkeljet e legjislacionit të mbrojtjes së klientit, ERE ka në strukturën e saj, Drejtorinë e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve që trajton çdo rast ku konstatohet sjellje të padrejta ose që dëmtojnë klientët në shkelje të legjislacionit në fuqi.

3. Zbatimi i rregullave që lidhen me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit.

a) Për respektimin e treguesve dhe kërkesave të operimit dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, si dhe performancën në lidhje me sigurinë e rrjetit të shpërndarjes, sipas kërkesave të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, është miratuar "Rregullorja për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së energjisë elektrike", e cila për qëllime të informimit të klientëve është publikuar në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të ERE-s. Qëllimi i kësaj rregullore dhe akteve të tjera, që lidhen me kushtet e ofrimit të shërbimit publik është, të krijojë, gjithashtu, siguri më të madhe dhe transparencë në marrëdhëniet ndërmjet furnizuesve dhe klientëve. ERE është institucioni përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me kuadrin rregullator në fuqi, hetimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe marrjen e masave zbatuese.

4. Furnizuesi i Shërbimit Universal ka detyrën të ofrojë shërbimin në përputhje me:

a) ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar;

b) rregullore "Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017;

c) rregullat për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik siç është miratuar nga ERE, me vendimin nr. 112, datë 8.7.2016;

d) kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike për klientët që furnizohen nga shërbimi universal, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.1.2018;

e) aktet e tjera rregullatore.

5. Operatori i sistemit të shpërndarjes ka detyrën të ofrojë shërbimin në përputhje me:

a) ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar;

b) rregullore "Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike" miratuar me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017;

c) kushteve të përcaktuara në licencën e shpërndarjes, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 216, datë 11.10.2018;

d) Rregullore "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes".

6. Shërbimi Universal i Furnizimit është një detyrim i shërbimit publik i vendosur nga ERE për Furnizuesin e Shërbimit Universal, i cili siguron të drejtën e furnizimit me energji elektrike për klientët që përfitojnë nga shërbimi universal në Republikën

e Shqipërisë, me një cilësi të caktuar të furnizimit, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese, me qëllim mbrojtjen e tyre nga rritjet e paarsyetuara të çmimit duke arritur hapjen e plotë të tregut të energjisë elektrike, siç është parashikuar në nenin 109, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

7. Duke qenë i ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, si pjesë e detyrimit të shërbimit publik, FSHU sh.a., në funksionin e furnizuesit, është i detyruar të furnizojë klientët fundorë sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar.

8. Përgjegjësitë e furnizuesit, sipas kuadrit rregullator:

a. Informimi i klientëve për të drejtat e tyre

ERE, në përputhje me autoritetin sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike, në çdo kohë do të kontrollojë mbi nivelin e informimit të klientëve për të drejtat e tyre. Është përgjegjësi e operatorit t'u ofrojë klientëve qasje në informacionin që lidhet me shërbimin e ofruar nga i licencuari.

Sa më sipër, detyrimi i Furnizuesit të Shërbimit Universal, konsiston në:

1. Të informojë klientët për të drejtat dhe kushtet, që të furnizohet sipas shërbimeve universale;

2. Të informojë klientët për termat dhe kushtet e furnizimit dhe çmimit të energjisë elektrike dhe që kanë të drejtën të zgjedhin një furnizues tjetër;

3. Të informojë klientët për furnizimin me energji elektrike; sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

4. Të informojë klientët mbi masat për të shlyer detyrimet e papaguara;

5. Të informojë klientët për kriteret e ndërprerjes së furnizimin të "klientëve në nevojë", sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe legjislacionit përkatës në vend;

6. Të publikojë në faqen zyrtare të internetit çmimet e furnizimit të miratuara nga ERE.

b. Veprimet në kuadër të detyrimit për informim

Veprimet në kuadër të detyrimit të furnizuesit për informim, përfshijnë dhënien e informacionit përmes shërbimeve telefonike, të kujdesit për klientët dhe internetit, kryerjen e njoftimeve publike për të ofruar një shërbim të dobishëm, të sjellshëm dhe efektiv për të gjithë klientët.

1. Në çdo rast i licencuari do të sigurojë vënien në dispozicion në faqen e tij të internetit, si dhe në çdo qendër të kujdesit ndaj klientit (KNK), dhe në kopje të shtypura sipas kërkesës së klientit, informacionin mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit.

2. Furnizuesi ka detyrimin të njoftojë në çdo rast klientit që ka paraqitur një ankesë për zgjidhjen e dhënë zyrtarisht, dhe jo vetëm ta zgjidhë atë.

3. Furnizuesi ka detyrimin të njoftojë klientin mbi të drejtën e ushtrimit të ankesës te furnizuesi dhe në ERE.

4. Për qëllime të vlerësimit të nivelit të zbatimit të detyrimit që lidhet me të drejtën për informim të klientit, furnizuesi do të sigurojë, përmes procedurave të tij të brendshme, sa vijon:

a) njohjen e stafit me përgjegjësitë e shoqërisë duke siguruar që i gjithë stafi të jetë i vetëdijshëm dhe t'i përmbahet detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi;

b) të sigurojë auditim të brendshëm të shërbimit të klientit;

c. barazia: i licencuari ka përgjegjësinë për të ofruar një shërbim që është në dispozicion për të gjithë klientët, për të siguruar që askush nuk është i diskriminuar në ndërveprimet dhe procedurat që lidhen me sigurimin e shërbimit universal të furnizimit, që të gjithë klientët trajtohen në mënyrë të barabartë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d. veprimet në kuadër të detyrimit për trajtim të barabartë të klientëve të energjisë elektrike.

Për qëllime të vlerësimit të nivelit të zbatimit të detyrimit, që lidhet me trajtimin në mënyrë të barabartë të klientëve në përputhje me legjislacionin, furnizuesi do të sigurojë përmes procedurave të brendshme, sa vijon:

1. Të mundësojë marrjen e komenteve nga klientët për shërbimin e ofruar (anketa periodike dhe forma të tjera të përshtatshme sipas furnizuesit);

2. Të masë nivelin e kënaqësisë së klientëve nëpërmjet organizimit të anketave që adresojnë në mënyrë të posaçme kohën e kthimit të përgjigjeve

dhe zgjidhjeve për problematikat e adresuara prej tyre;

3. Të administrojë dhe të bëjë vlerësimet përkatëse në analizë të gjetjeve nga komentet e klientëve dhe të publikojë këto rezultate në faqen zyrtare.

9. Aksesi në shërbime

Ofrimi i zyrave të shërbimit, që përputhen me standardet e punës dhe të sigurisë, dhe si pjesë të kësaj, lehtësojnë aksesin për personat me aftësi të kufizuara dhe të tjerët me nevoja specifike, të tilla si:

a) furnizuesi duhet të sigurojë çdo ndihmë që mund të jetë e nevojshme për personat që kanë aftësi të kufizuara;

b) furnizuesi duhet të sigurohet që qendrat e kujdesit të klientit janë të disponueshme për vizitat e klientëve në përputhje me orarin e njoftuar të shërbimeve;

c) furnizuesi duhet të sigurojë dhënien e informacioni të qartë, në kohë, të saktë, e që është në dispozicion në të gjitha pikat e kontaktit;

d) furnizuesi duhet të sigurojë që potencialet e ofruara nga teknologjia e informacionit të jenë të shfrytëzueshme plotësisht e të disponueshëm në faqet e internetit;

e) furnizuesi duhet të përgatisë formularë, fletëpalosje që përmbajnë informacion mbi shërbimin e furnizimit universal, duke siguruar informacion në gjuhë të thjeshtë që kuptohet lehtë. Linja telefonike pa pagesë e klientit është një tjetër rrugë kryesore për sigurimin e informacionit. Funksioni i saj është të informojë klientët duke iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me të drejtat e përgjithshme të klientit, si dhe shërbimet e ofruara.

10. Veprimet në kuadër të detyrimit për akses në shërbime

Për qëllime të vlerësimit të nivelit të zbatimit të detyrimit, që lidhet me aksesin në shërbime të klientëve në përputhje me legjislacionin, furnizuesi do të sigurojë, përmes procedurave të brendshme, sa vijon:

a) të mundësojë marrjen e komenteve nga klientët për shërbimin e ofruar (anketa dhe forma të tjera të përshtatshme sipas furnizuesit);

b) të vendosë një sistem regjistrimi të telefonatave që administrohen nga qendrat e kujdesit të klientit;

c) të administrojë dhe të bëjë vlerësimet përkatëse në analizë të gjetjeve nga komentet e klientëve;

d) të përgatisë, përmes strukturave të brendshme, raporte periodike mbi sigurimin e dhënies së informacionit përmes linjave telefonike apo internetit/komunikimit në adresën elektronike të *email*-it, dhe sipas rastit të kryejë auditime për shërbimin e klientit, nivelin e informacionit të ofruar në qendrat e kujdesit ndaj klientit (KNK);

e) të vlerësojë opinionin e stafit lidhur me disponueshmërinë dhe lehtësinë e qasjes në informacion nga klientët. Furnizuesi të mbajë një database të opinioneve/propozimeve të stafit apo klientëve me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe mënyrës së adresimit të tyre.

11. Ankesat

Mbajtja e një sistemi të qasshëm, transparent dhe të thjeshtë për t'u përdorur për t'u marrë me ankesat për cilësinë e shërbimit të ofruar. Furnizuesi duhet të ofrojë një shërbim me cilësi të lartë për të gjithë, duke siguruar që të gjitha ankesat të adresohen menjëherë, në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të qëndrueshme:

a) i licencuari do të mbajë klientët të përditësuar duke siguruar informacion në lidhje me ankesën e tyre në baza të vazhdueshme;

b) i licencuari do të mbajë një sistem zyrtar të ankimit/rishikimit të formalizuar, transparent dhe të thjeshtë për përdorim, për të gjithë klientët, të cilët janë të pakënaqur në lidhje me shërbimet;

c) nëse parashtruesi i ankesës nuk është i kënaqur me rezultatin e ankesës së tyre fillestare, klienti duhet të informohet për të drejtën e tij për të ankimuar qëndrimin e furnizuesit në institucionet e ngarkuara me ligj për mbrojtjen e klientit, të tillë si: ERE, Zyra e Avokatit të Popullit, Komisioni për Mbrojtjen e Klientit.

12. Veprimet në kuadër të detyrimit për trajtimin e ankesave

Për qëllime të vlerësimit të nivelit të zbatimit të detyrimit, që lidhet me trajtimin në mënyrë të barabartë të klientëve në përputhje me legjislacionin, furnizuesi do të sigurojë përmes procedurave të brendshme sa vijon:

a) të sigurohet se stafi është i vetëdijshëm për procesin e ankesave, pranon ankesën dhe merr të gjitha masat për ta zgjidhur atë brenda afateve;

b) të sigurohet se stafi është në gjendje të adresojë në çast problematika që lidhen me marrjen e informacionit të kërkuar nga klienti.

13. E drejta e zgjedhjes së shërbimit nga klienti

Ofrimi i zgjedhjes, aty ku është e mundur, në ofrimin e shërbimeve duhet të përfshijë metodat e pagesës, vendndodhjen e pikave të kontaktit të furnizuesit, orët e hapjes dhe afatet e dorëzimit të kërkesave. Furnizuesi bën çdo përpjekje për të ofruar mënyra të shumta për klientët për të gjetur informacion rreth furnizuesit dhe për të kontaktuar atë.

14. Veprimet në kuadër të detyrimit për të drejtën e zgjedhjes së shërbimit nga klienti

Për të siguruar këtë të drejtë, furnizuesi jep një sërë kanalesh kontaktesh, përfshirë dokumente shkresorë, *email*, forma *online*, media dhe telefon pa pagesë, për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe hetimin efektiv të mbrojtjes së klientit.

15. Monitorimi dhe raportimi

a) ERE do të monitorojë punën e Furnizuesit të Shërbimit Universal kundrejt standardeve të vendosura në aktet rregullatore dhe në përputhje me detyrat sipas këtij plani masash. ERE do të monitorojë punën e Furnizuesit të Shërbimit Universal kundrejt standardeve të vendosura në aktet rregullatore dhe në përputhje me detyrat sipas këtij plani masash.

b) "Kodi i etikës dhe i sjelljes" i punonjësve të qendrave të kujdesit të klientit duhet t'i bëhet me dije stafit. Gjithashtu, Furnizuesi i Shërbimit Universal do të marrë masat për të vendosur një marrëdhënie bashkëpunimi me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për trajtimin e ankesave që lidhen me problematikat që mund të shfaqen.

c) Në fillim të çdo viti, furnizuesi do të zhvillojë një anketë të shërbimit të klientit, si një tregues i performancës. Lloji dhe numri i klientëve që do të anketohen do të përcaktohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal. Rezultatet e kësaj ankete do të publikohen në faqen zyrtare të furnizuesit , si dhe do të raportohen në ERE jo më vonë se data 31 mars e çdo viti.

d) Pas mbledhjes dhe analizimit të rezultateve të anketimit, furnizuesi, brenda 12 muajve nga marrja e rezultatit të anketës, do të hartojë një plan veprimi të ri, i cili do të përqendrohet në fushat për përmirësim të theksuar në rezultate, dhe progresi kundrejt standardeve të vendosura. Ky plan veprimi do të paraqitet për miratim në ERE.

e) ERE do të kryejë monitorime specifike në lidhje me:

i. trajtimin dhe statusin ie ankesave (ankesat e dërguara nga ERE; Avokati i Popullit; Zyra për Mbrojtjen e Klientit, zyrat qendrore të FSHU-së etj.);

ii. statusin e ankesave të përsëritura;

iii. procedurën e ndjekur nga qendrat e kujdesit ndaj klientit, për trajtimin e ankesave të klientëve të energjisë elektrike;

iv. afatet dhe procedurat për trajtimin e kërkesave dhe ankesave për "Lidhjet e reja" konform rregullores për "Lidhjet e reja me sistemin e shpërndarjes";

v. zbatimin e afateve lidhur me lëshimin e faturës së korrektuar dhe kompensimet përkatëse sipas "Kushteve të përgjithshme të Shërbimit Universal të Furnizimit për klientët fundorë" dhe "Kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit për klientët fundorë";

vi. treguesit e cilësisë së shërbimit, konform "Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017.

- Zbatimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 104, datë 23.6.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 181, të Bordit të ERE-s, datë 23.11.2016, "Mbi përcaktimin e vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 21.12.2013;

- Zbatimin e vendimit të ERE-s, lidhur me anulimin e faturave të klientëve të energjisë elektrike, nën emërtimin "dëm ekonomik" dhe "energji e pamatur" për periudhën 2008–2011;

- Kushtet e punës së qendrave të ngritura rishtazi apo atyre ekzistuese;

- Eficienca në dhënien e shërbimeve.

- Transparenca në dhënien e informacionit të domosdoshëm për klientët në kanalet zyrtare të komunikimit por edhe në çdo rast që kërkohet.

- Afishimi dhe publikimi i të dhënave të domosdoshme për klientët si detyrim i furnizuesit edhe në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e

shërbimit universal apo/edhe furnizues i alternativës së fundit;

- Plotësimi i kushtit që i licencuari t'i bëjë të dukshme afatet dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet e tij me klientët në të gjitha zyrat e tij, publikojë në faqen e tij të internetit, dhe t'ua japë klientëve mundësinë të marrin një kopje të dokumentit;

- Marrja e informacionit të detajuar mbi çmimet dhe tarifat e energjisë elektrike për kategori të ndryshme klientësh;

- Lëshimi i faturave të detajuara sipas kërkesës dhe mbajtja e dokumentacionit të mjaftueshëm për të mbështetur shumat e faturuara;

- Ngritja dhe menaxhimi i njësive të dedikuara për marrëdhëniet me klientët dhe punësimi i një numri të mjaftueshëm personeli të kualifikuar;

- Publikimi i të dhënave mbi organizimin e njësisë së dedikuar, përfshirë vendndodhjen, orët e punës, orët për takimet me klientët, numrin e telefonit të kontaktit, afatet dhe kushtet për lidhjen e klientëve me Rrjetin e Shpërndarjes, aplikimet për hetimin e kushteve dhe procedurave për lidhjen e klientëve me Rrjetin e Shpërndarjes;

- Funksionimi i sistemit për regjistrimin dhe trajtimin e ankesave, aplikimeve dhe propozimeve të klientëve;

FSHU do të përgatisë informacione periodike çdo tre muaj për të informuar ERE-n mbi nivelin e sigurimit të shërbimeve siç përcaktuar në këtë plan masash. Informacioni periodik do të përfshijë, ndër të tjera, raportim mbi:

Njohjen e stafit me përgjegjësitë e kompanisë duke siguruar që i gjithë stafi të jetë i vetëdijshëm dhe t'u përmbahet detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi;

- Të sigurojë auditim të shërbimit të klientit;

- Të mundësojë marrjen e komenteve nga klientët për shërbimin e ofruar (anketa dhe forma të tjera të përtashme sipas furnizuesit);

- Të administrojë dhe të bëjë vlerësimet përkatëse në analizë të gjetjeve nga komentet e klientëve;

- Të përgatisë përmes strukturave të brendshme, raporte periodike mbi sigurimin e dhënies së informacionit përmes linjave telefonike apo internetit dhe, sipas rastit, të kryejë auditime për shërbimin e klientit, nivelin e informacionit të ofruar në qendrat e kujdesit;

- Të vlerësojë opinionin e stafit lidhur me disponueshmërinë dhe lehtësinë e qasjes në informacion nga klientët;

- Të sigurohet se stafi është i vetëdijshëm për procesin e ankesave, pranon ankesën dhe merr të gjitha masat për ta zgjidhur atë brenda afateve;

- Çështje të tjera në gjykimin e furnizuesit që lidhen me respektimin e të drejtave të klientëve.

Informacioni periodik i dërguar nga FSHU-ja, siç është përcaktuar në këtë plan masash, dhe gjetjet e evidentuara në informacionin e përgatitur nga stafi teknik i ERE-s, nga monitorimet specifike siç është cituar më lart, do të shërbejë për vlerësimin nga ERE të ofrimit të shërbimeve dhe sigurimin e respektimit të të drejtave të klientëve.

VENDIM
Nr. 218, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË TRAJTIMIT TË ANKESAVE TË KLIENTËVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR NGA TË LICENCUARIT NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT

Në mbështetje të neneve 20, germa "ë"; 81, pika 3, germa "ç"; 94, pika 2, germa "b" dhe "ë", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 16, pika 16 dhe 20; 17, pika 1, germa "ë"; 96, pika 11; 98, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; të neneve 52/2 dhe 56, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar; të nenit 28, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar; të "Rregullores mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundor", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 203, datë 18.12.2017; "Rregullave mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 9.7.2018; "Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundor", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.1.2018, "Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe

performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017; të neneve 15 dhe 26m të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 132/5 prot., datë 11.12.2020, të Drejtorisë Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve,

konstatoi se:

- Qëllimi i standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (në vijim standardet) është sigurimi i një procesi të drejtë dhe efektiv të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e shërbimit të furnizimit me energji dhe gaz dhe të rritet besimi dhe pëlqimi i klientëve për këtë shërbim të ofruar nga të licencuarit.

- Objekti i standardeve është përcaktimi i kushteve të përgjithshme për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit, për aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike dhe të furnizimit me gaz natyror.

- Në kuadër të parimit të informimit, standardet përcaktojnë detyrimin e furnizuesit për t'i vënë në dispozicion klientit, ankuesit apo palëve të tjera të interesuara në mënyrë sa më lehtësisht të disponueshme informacionin minimal të nevojshëm për procedurat e trajtimit të ankesave, i cili duhet të pasqyrohet dukshëm në faturën e konsumit të energjisë elektrike.

- Standardet përcaktojnë se, ankesa do të regjistrohet në format elektronik apo të shkruar menjëherë pas pranimit të saj, si dhe parashikon elementët të cilët do të përfshihen në të, si: kodi unik identifikues, mënyra e paraqitjes së ankesës, vendndodhja e objektit dhe data e paraqitjes së ankesës, identiteti i parashtruesit të ankesës dhe detajet e kontaktit të tij, një përmbledhje të ankesës, kategorizimi i llojit të klientit apo klientit sipas nivelit të tensionit dhe tarifave, lloji i ankesës, si dhe informacioni nëse klienti është ankuar më parë apo jo për të njëjtin objekt ankimi për të cilin bëhet ankesa.

- Në këto standarde parashikohen gjithashtu elementë si: pajisja e klientit me kodin unik të identifikimit, procedurat që ndiqen në rastin e marrjes së ankesës personalisht ose me anë të telefonit nga ana e personit të ngarkuar nga i licencuari, si dhe rastin kur ankesa është pranuar me postë. Në të tria këto raste klienti do të informohet sa i përket veprimit të propozuar për zgjidhjen e ankesës, datën e parashikuar për zgjidhjen e saj, si dhe mënyrën e komunikimit që do të ndiqet në vazhdimësi me ankuesin.

- Në lidhje me detyrimet që rrjedhin ndaj të licencuarit për zgjidhjen e ankesës, standardet parashikojnë hetimin dhe verifikimin e të gjithë rrethanave dhe të dhënave lidhur me ankesën e regjistruar, si dhe kërkimin e informacionit shtesë tek ankuesi, brenda 5 ditëve punë pas miratimit të ankesës, dhe më pas informimin e ankuesit për veprimet e ndërmarra për të zgjidhur ankesën, si dhe në rastin kur ankesa rezulton e drejtë, kryeja e veprimeve korrigjuese apo kompensimit të klientit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Lidhur me paraqitjen e ankesës në ERE nga ana e çdo klienti, standardet përcaktojnë se një hap i tillë mund të ndërmerret në dy raste, kur: a) ka përfunduar procedurën e trajtimit të ankesave pranë të licencuarit dhe nuk mbetet i kënaqur nga përgjigja e dhënë prej tij; si dhe b) në rast se ankuesi nuk merr një përgjigje nga i licencuari brenda afatit të parashikuar.

- Standardet parashikojnë gjithashtu detyrimin e të licencuarit për rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të procedurave të brendshme të trajtimit të ankesave, me qëllim që të përmirësohet efektiviteti i procesit të trajtimit të tyre. Gjithashtu, i licencuari duhet të ndërmarrë veprimet e duhura për të eliminuar shkaqet e problemeve ekzistuese të cilat kanë ndikuar ose në të ardhmen mund të vazhdojnë të ndikojnë në paraqitjen e ankesave.

- Parimi i konfidencialitetit parashikohet në detyrimet që këto standarde vendosin mbi të licencuarit për të respektuar çdo informacion apo dokument të vënë në dispozicion nga klienti, në lidhje me ankesat e paraqitura nga ky i fundit.

- Të licencuarit kanë gjithashtu detyrimin për paraqitjen në ERE, çdo tre muaj, të një raporti të detajuar me shkrim i cili do të duhet të përmbajë një sërë të dhënash, si: numri i ankesave të marra në tremujorin për të cilin po raportohet, numrin e ankesave për secilën kategori, të cilat janë zgjidhur

në përputhje me pritshmërinë e kërkesave të klientit dhe të atyre që nuk janë zgjidhur.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit.

2. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 220, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 93, SERIA PV10K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "POWER-ELEKTRIK-SLABINJE" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 10, DATË 8.2.2010, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", dhe të nenit 6 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; pikës 3.6, pikës 4.4 dhe pikës 6.1, germa "ç" të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot., datë 7.12.2020, të përgatitur nga Grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit",

konstatoi se:

- Shoqëria "Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 93, seria PV10K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010, për një afat 30-vjeçar dhe modifikuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 95, datë 16.7.2012.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2018 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 1.2.2019. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim, edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 55/27 prot., datë 15.1.2019.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2019, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/84 prot., datë 6.2.2020.

- Me vendimin nr. 103, datë 24.6.2020, "Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore", Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk

kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- I licencuari "Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k. është njoftuar për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 960/20 prot., datë 9.7.2020. Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në vendimin sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 125/2020, "Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE-s", u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.

- Shoqërisë "Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/3 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6 të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Për sa më sipër rezulton se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon:

1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitin 2018 dhe vitin 2019

- Shoqëria e licencuar rezulton debitore për dy vite të njëpasnjëshme për mosshlyerjen në afat të pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonese në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon, se ERE heq një licencë, kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Neni 6 i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

- Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast, subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, i cili përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

- Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari, të pikës 3.6 të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike.

- Në nenin 4.4 të kushteve të licencës së prodhimit parashikohet, se: "I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin".

- Në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, "Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike", është përcaktuar, si efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimeve për pagesat e rregullimit ndër vite, por edhe të njoftimeve të përsëritura të

dërguara për dijeni të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 93, seria PV10K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Power-Elektrik-Slabinje", me vendimin e bordit të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010, të ndryshuar.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarit dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 221, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 265, SERIA T15P, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "POWER-ELEKTRIK-SLABINJE" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 17, DATË 11.2.2015

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", dhe nenit 6 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; pikës 3.8, pikës 4.5 dhe pikës 5.1, germa "ç" të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot., datë 7.12.2020, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit,

konstatoi se:

- Shoqëria "Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 265, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 11.2.2015, për një afat 25-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2018 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 1.2.2019. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim, edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 55/27 prot., datë 15.1.2019.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2019 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/84 prot., datë 6.2.2020.

- Me vendimin nr. 103, datë 24.6.2020, "Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore", Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit,

të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- I licencuari "Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k. është njoftuar për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 960/20 prot., datë 9.7.2020. Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në vendimin sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 125/2020, "Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE", u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori, me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.

- Shoqërisë "Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/3 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6 të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Për sa më sipër rezulton se grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari:

1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitin 2018 dhe vitin 2019

- Shoqëria e licencuar rezulton debitore për dy vite të njëpasnjëshme për mosshlyerjen në afat të pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107 parashikon, se për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore, për çdo ditë vonesë në pagesën e saj, dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Neni 6 i rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

- Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, i cili përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

- Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari të pikës 3.8 të Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike.

- Në nenin 4.5 të Kushteve të licencës së për tregtimin e energjisë elektrike parashikohet, se: "I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të Licencuarin".

- Në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, "Mbi miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike", është përcaktuar, si efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimeve për pagesat e rregullimit ndër vite, por edhe të njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 265, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Power-Elektrik-Slabinje", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 11.2.2015.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 222, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 130, SERIA PV11K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "HIDROPOWER ELEKTRIK" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 59, DATË 22.6.2011, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", dhe nenit 6 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; pikës 3.6, pikës 4,4 dhe pikës 6.1, të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot., datë 7.12.2020, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit",

konstatoi se:

- Shoqëria "Hidropower Elektrik" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 130, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011, për një afat 30-vjeçar, modifikuar me vendimin e bordit nr. 194, datë 30.8.2018.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2018, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 1.2.2019. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 55/27 prot., datë 15.1.2019.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2019 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/97 prot., datë 6.2.2020.

- Me vendimin nr. 103, datë 24.6.2020, "Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore", Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr.

43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- I licencuari "Hidropower Elektrik" sh.p.k. është njoftuar për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 960/22 prot., datë 9.7.2020. Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në vendimin sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 125/2020, "Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE-s", u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori, me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.

- Shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/6 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Hidropower Elektrik" sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkohet.

- Për sa më sipër rezulton se grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari:

1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitin 2018 dhe vitin 2019.

- Shoqëria e licencuar rezulton debitore për dy vite të njëpasnjëshme për mosshlyerjen në afat të pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në nenin 107, parashikon se për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Neni 6 i Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

- Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konfrom nenit 107, të ligjit 43/2015, i cili përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

- Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari, të pikës 3.6 të Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike.

- Në nenin 4.4 të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike parashikohet, se: "I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin".

- Në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, "Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike", është përcaktuar, si efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale, ndaj të gjitha

subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimeve për pagesat e rregullimit ndër vite, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 130, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011, të ndryshuar.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarin palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 223, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 267, SERIA T15P, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "HIDROPOWER ELEKTRIK" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 19, DATË 11.2.2015

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", dhe nenit 6 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; pikave 3.8, 4.5 dhe pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot., datë 7.12.2020, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit",

konstatoi se:

- Shoqëria "Hidropower Elektrik" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 267, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 19, datë 11.2.2015, për një afat 26-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2018, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 1.2.2019. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 55/40 prot., datë 20.12.2018.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2019 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/97 prot., datë 6.2.2020.

- Me vendimin nr. 103, datë 24.6.2020, "Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore", Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të

parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- I licencuari "Hidropower Elektrik" sh.p.k. është njoftuar për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 960/22 prot., datë 9.7.2020. Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në vendimin sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 125/2020, "Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE-s", u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe të rrethanave të çdo debitori, me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.

- Shoqërisë "Hidropower eleKtrik" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/6 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije, që në zbatim të nenit 6 të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Hidropower Elektrik" sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkohet.

- Për sa më sipër rezulton se grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari:

1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitin 2018 dhe për vitin 2019

- Shoqëria e licencuar rezulton debitore për dy vite të njëpasnjëshme për mosshlyerjen në afat të pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon, se për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se ERE heq një licencë, kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 të këtij ligji.

- Neni 6 i rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

- Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet, që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, i cili përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

- Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari, të pikës 3.8 të Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike.

- Në nenin 4.5 të kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike, parashikohet se: "I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin, siç parashikohet edhe në nenin 4.5 të kushteve të licencës së tregtimit".

- Në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, "Mbi miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike", është përcaktuar, si efektet e kësaj licence, për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës

së parashikuar në licencën aktuale, ndaj, të gjitha subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence janë të detyruara të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimeve për pagesat e rregullimit ndër vite, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 265, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Hidropower Elektrik", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 11.2.2015.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 224, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 348, SERIA T16, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "NORDIC INVEST GROUP" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 121, DATË 21.7.2016

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", dhe nenit 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; pikës 3.6.4, germa "a", pikës 3.8, pikës 4.5 dhe pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot., datë 7.12.2020, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit",

konstatoi se:

- Shoqëria "Nordic Invest Group" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 348, seria T16, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 21.7.2016, për një afat 5-vjeçar.

-. Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2019 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/52 prot., datë 6.2.2020.

- Me vendimin nr. 103, datë 24.6.2020, "Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore", Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk

- Me urdhrin e kryetarit nr. 125/2020, "Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE-s", u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori, me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.

- Shoqërisë "Blac Energy" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/19 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin e sipërcituar, ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që

brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ, të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Blac Energy" sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari:

1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitin 2018 dhe për vitin 2019.

Shoqëria e licencuar rezulton debitore për dy vite të njëpasnjëshme, për mosshlyerjen në afat të pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Neni 6 i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

- Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës, duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

- Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari, të pikës 3.6, të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike".

- Në nenin 4.4, të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", parashikohet se: "I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.".

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit, është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimeve për pagesat e rregullimit ndër vite, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Blac Energy", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 231, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 398, SERIA T18, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "WIND POWER ALBANIA" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 58, DATË 12.3.2018

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", dhe nenit 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 3.8, 4.5 dhe pikës 5.1, germa "ç" të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot., datë 7.12.2020, të përgatitur nga Grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës, për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s, për pagesat e rregullimit",

konstatoi se:

- Shoqëria "Wind Power Albania" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 398, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 12.3.2018, për një afat 5-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit, për vitin 2019, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s, sipërcituar, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/21 prot., datë 6.2.2020.

- Me vendimin nr. 103, datë 24.6.2020, "Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore", Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- I licencuari "Wind Power Albania" sh.p.k. është njoftuar për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 960/51 prot., datë 9.7.2020. Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në vendimin sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 125/2020, "Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE", u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.

-Shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/17 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin e sipërcituar, ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që, brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Wind Power Albania" sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari:

1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitin 2019.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Neni 6 i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

"- Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konfrom nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.".

- Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari, të pikës 3.8, të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike".

- Në nenin 4.5, të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike", parashikohet se: "I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.".

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë, nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimeve, për pagesat e rregullimit ndër vite, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 398 seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Wind Power Albania", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 12.3.2018.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për fillimin e procedurave, për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 232, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 413, SERIA F18, PËR VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "WIND POWER ALBANIA" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 126, DATË 4.6.2018

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", dhe nenit 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; pikës, pikës 7.5 dhe pikës 91, germa "b", të "Kushteve të licencës për furnizimin e energjisë elektrike"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin,

funksionimin dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot., datë 7.12.2020, të përgatitur nga Grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit",

konstatoi se:

- Shoqëria "Wind Power Albania" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 413, seria F18, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 4.6.2018, për një afat 5-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit, për vitin 2019, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s, sipërcituar, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/21 prot., datë 6.2.2020.

- Me vendimin nr. 103, datë 24.6.2020, "Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore", Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- I licencuari "Wind Power Albania" sh.p.k. është njoftuar për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 960/51 prot., datë 9.7.2020. Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në vendimin sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 125/2020, "Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE", u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori, me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.

- Shoqërisë "Wind Power Albania" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/17 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që, brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Wind Power Albania" sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari:

1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitin 2019.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Neni 6, i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të

gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

"- Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.".

- Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari, të pikës 9.1, germa "b", të "Kushteve të licencës për furnizimin e energjisë elektrike".

- Në nenin 7.5, të "Kushteve të licencës për furnizimin e energjisë elektrike", parashikohet se: "I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve punë nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit, është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimeve, për pagesat e rregullimit ndër vite, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 413, seria F18, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Wind Power Albania", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 4.6.2018.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për fillimin e procedurave, për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 233, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 359, SERIA T17, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "ENPI" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 36, DATË 6.3.2017

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", dhe nenit 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; pikës 3.6.4, germa "a", pikës 3.8, pikës 4.5 dhe pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot. datë 7.12.2020, të përgatitur nga Grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit",

konstatoi se:

- Shoqëria "ENPI" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 359, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 6.3.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2018, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s, sipërcituar, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë

1.2.2019. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim, edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 55/185 prot., datë 15.1.2019.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2019, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s, sipërcituar, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/55 prot., datë 6.2.2020.

- Me vendimin nr. 103, datë 24.6.2020, "Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore", Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- I licencuari "ENPI" sh.p.k. është njoftuar për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 960/58 prot., datë 9.7.2020. Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në vendimin sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 125/2020, "Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE", u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.

- Shoqërisë "ENPI" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/20 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "ENPI" sh.p.k, nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Po ashtu, ka rezultuar se shkresat dërguar subjektit "ENPI" sh.p.k. janë kthyer mbrapsht nga posta, çka e vendos këtë subjekte në shkelje të pikës 3.6.4, germa "a", të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ku është parashikuar detyrimi i të licencuarve për të njoftuar ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të adresës.

- Për sa më sipër rezulton se grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari:

1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitin 2018 dhe vitin 2019.

2. Mosnjoftimin në afat të ndryshimit të adresës.

- Shoqëria e licencuar rezulton debitore për dy vite të njëpasnjëshme për mos shlyerjen në afat të pagesave të Rregullimit ndaj ERE-s.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në nenin 107, parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të

vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Neni 6, i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

"- Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konfrom nenit 107, të ligjit 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.".

- Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari, të pikës 3.8, të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike".

- Në nenin 4.5, të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike" parashikohet se: "I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.".

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit, është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimeve për pagesat e rregullimit ndër vite, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 359, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "ENPI", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 6.3.2017.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për fillimin e procedurave, për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 234, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 384, SERIA T17, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "ENERGY TO ENERGY" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 144, DATË 6.9.2017

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", dhe nenit 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; pikës 3.8, 4.5 dhe pikës 5.1, germa "ç" të "Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot., datë 15.12.2020, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit",

konstatoi se:

- Shoqëria "Energy to Energy" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.9.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 208, datë 18.12.2017, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2017 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 237, datë 31.12.2017. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 53/16 prot., datë 11.1.2018.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2018 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 1.2.2019. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim, edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 55/189 prot., datë 15.1.2019.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2019 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/37 prot., datë 6.2.2020.

- Me vendimin nr. 103, datë 24.6.2020, "Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore", Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- I licencuari "Energy to Energy" sh.p.k. është njoftuar për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 960/60 prot., datë 9.7.2020. Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në vendimin sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 125/2020, "Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE-s", u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.

- Shoqërisë "Energy to Energy" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/12 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6 të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "Energy to Energy" sh.p.k, nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

Për sa më sipër rezulton se grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari:

1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitet 2017, 2018 dhe 2019;

- Shoqëria e licencuar rezulton debitore për tri vite të njëpasnjëshme për mosshlyerjen në afat të pagesave të rregullimit ndaj ERE-s:

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në nenin 107 parashikon se për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE

ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se ERE heq një licencë, kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Neni 6 i rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

- Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast, subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015, i cili përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

- Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari, të pikës 3.8 të kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike.

- Në nenin 4.5 të kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike parashikohet, se: "I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin".

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimeve për pagesat e rregullimit ndër vite, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Energy to Energy", me vendimin e bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.9.2017.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 235, datë 15.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 369, SERIA TGN17, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR, DHËNË SHOQËRISË "CGC" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 73, DATË 16.5.2017

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 22 dhe 27, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", dhe nenit 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 4, pika 8, germa "a", nenit 6, nenit 7, pika 5, dhe nenit 9, pika 1, germa "d" dhe të "Kushteve të licencës për tregtimin e gazit natyror"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot., datë 7.12.2020, të përgatitur nga Grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për

heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit ",

konstatoi se:

- Shoqëria "CGC" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit, për vitin 2018, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s, sipërcituar, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 1.2.2019. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim, edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 55/191 prot., datë 15.1.2019.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit, për vitin 2019, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s, sipërcituar, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/39 prot., datë 6.2.2020.

- Me vendimin nr. 103, datë 24.6.2020, "Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore", Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020, të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- I licencuari "CGC" sh.p.k. është njoftuar për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 960/61 prot., datë 9.7.2020. Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në vendimin sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 125/2020, "Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE", u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluara.

- Shoqërisë "CGC" sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/11 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave", me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që, brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit.

- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti "CGC" sh.p.k, nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

- Po ashtu, ka rezultuar se shkresat dërguar subjektit "CGC" sh.p.k, janë kthyer mbrapsht nga posta, çka e vendos këtë subjekt në shkelje të nenit, 4, pika 8, germa "a", të licencës për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, ku është parashikuar detyrimi i të licencuarve për të njoftuar ERE-n, brenda 10 ditëve, për çdo ndryshim të adresës.

- Për sa më sipër, rezulton se grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari:

1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitin 2018 dhe 2019.

2. Mosnjoftimin në afat të ndryshimit të adresës.

- Shoqëria e licencuar rezulton debitore për dy vite të njëpasnjëshme për mosshlyerjen në afat të pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Neni 6, i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se:

"- Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit nr. 43/2015 e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.".

- Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari, të nenit 6, të "Kushteve të licencës për tregtimin e gazit natyror".

- Në nenin 7, pika 5, të "Kushteve të licencës për tregtimin e gazit natyror", parashikohet se: "Licencuari do ta informojë dhe sqarojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo më vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.".

- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit, është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijeni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare, të vendimeve për pagesat e rregullimit ndër vite, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijeni të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë "CGC", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 45 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për fillimin e procedurave, për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasja Dajana Rucaj kërkon pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të vdekur dhe të zhdukur të babait të saj, shtetasit Muharem Rucaj.

KËRKUESE
Dajana Rucaj

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 3
Datë: 2021/01/08 14:33:10
6531eb82-4b24-4ea3-9d84-081dac73b9c4

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë